Republika e Kosovës
Komuna e Kaçanikut

# VJETARI 2012

Janar 2013

Boton:
Komuna e Kaçanikut

Përmbajtja:
Zyra e Informimit
http://kk.rks-gov.net/kacanik/

Retushimi profesional:
Klubi i Gazetarëve të Kaçanikut

Shtypi: Shtypshkronja “ERA” Ferizaj

Shpërndarja falas

*Të nderuar bashkëqytetarë,*

*Në cilësinë e kryetarit të ri të Komunës kam vendosur ta vazhdoj praktikën e botimit të Vjetarit. Kjo për shkak se nga të gjithë, përfshirë edhe qytetarët, është vlerësuar projekt i qëlluar. Çdo punë në funksion të transparencës së Komunës në raport me publikun edhe unë e vlerësoj shumë.*
*Duke e lexuar këtë Vjetar, besoj se do të pajtoheni me mua se edhe 2012-ta ishte vit i angazhimeve dhe i arritjeve. Nuk kanë munguar investimet në infrastrukturën rrugore e shkollore, rrjete kanalizimesh etj. Administrata komunale ka qenë e efektshme në ofrimin e shërbimeve qytetarëve, ndërsa funksional ka qenë edhe legjislativi komunal. Ka vazhduar mbështetja e donatorëve për projektet e Komunës. Arritje që unë i veçoj janë edhe miratimi i Planit rregullues urban për zonën I të qytetit dhe i atij rregullues për zonën turistike te Livadhet e Shtrazës.*
*Sivjet është viti i pestë i botimit të Vjetarit. Edhe Vjetari 2012 në mënyrë kronologjike pasqyron vetëm punët dhe aktivitetet më me peshë të realizuara në vitin që e lamë pas.*
*Zyra e Informimit mbetet e hapur për vërejtjet dhe sugjerimet tuaja lidhur me Vjetarit të ardhshëm.*

*Me respekt,*
*Besim Ilazi*
*Kryetar i Komunës*

# JANAR 2012

## Kryetari zotohet për përmbushjen e objektivave për 2012

**4 Janar -** Ekzekutivi i Komunës së Kaçanikut ka mbajtur takimin e parë për vitin 2012, takim në të cilin është premtuar përmbushja e objektivave të paraparë për sivjet. Kryetari i komunës, z. Xhabir Zharku, i cili e ka udhëhequr këtë takim, fillimisht ka uruar stafin e tij për një vit të mbarë, ndërsa ka thënë se do të mobilizohemi dhe përkushtohemi maksimalisht, në mënyrë që objektivat e planifikuara të realizohen me sukses. Kryetari Zharku, duke folur për projektet e planifikuara për këtë vit, ka kërkuar që, për të pasur një ecuri normale të realizimit , të gjitha procedurat e tenderimit të përfundojnë brenda tre mujorit të parë. Drejtuesit e qeverisë komunale e kanë shqyrtuar edhe draftin e parë të Raportit të shpenzimeve të buxhetit 2011, realizimi i të cilit është vlerësuar pozitivisht.



# KKSB mban takimin e parë për sivjet

**9 janar** - Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi ka mbajtur takimin e parë për vitin 2012, takim në të cilin është vlerësuar se muaji dhjetor ka qenë i qetë dhe gjendja e sigurisë ka qenë nën kontroll. Ndër aktivitetet policore, u.d. i komandantit të Stacionit Policor në Kaçanik, togeri Jaser Jaha, ka përmendur tri raste të posedimit të armëve pa leje dhe një tjetër të gjetjes të një sasie të lëndëve narkotike. Togeri Jaha ka thënë se gjatë festës së fundvitit janë angazhuar forca shtesë të sigurisë, ndërsa është shënuar vetëm një rast, në të cilin një person është lënduar me mjete piroteknike. Ndërkaq, lidhur me gjendjen e rrugëve nga bora, nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, i cili e ka udhëhequr takimin, ka thënë të gjitha rrugët janë të kalueshme. Anëtari i KKSB-së nga shoqëria civile, z. Kjani Sallahu, ka artikuluar shqetësimin e qytetarëve për mbingarkesa ekstreme të autobusëve me nxënës. Ai ka thënë se mos zbatimi i Rregullores së transportit publik nga organet kompetente, respektivisht lënia e udhëtarëve në mëshirën e kompanive transportuese, është rrezik për qytetarët.



# Nis gjysmëvjetori i dytë i vitit shkollor 2011-2012

**10 Janar** - Gjysmëvjetori i dytë i vitit shkollor 2011-2012 ka filluar mbarë. Të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit u janë rikthyer angazhimeve që i lanë me përfundimin e gjysmëvjetorit të parë. Me këtë rast kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, gjatë vizitës që u ka bërë disa shkollave, u ka uruar nxënësve suksese në mësime dhe mësimdhënësve punë të mbarë, ndërsa ka shprehur përkushtimin e institucioneve komunale për ngritjen e cilësisë, edukimin dhe arsimimin e brezave të rinj.



# Kryetari Zharku priti ministrin e MAPL-së

**16 Janar -** Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka pritur sot në një takim pune ministrin e Administrimit të Pushtetit Lokal z. Sllobodan Petroviq, i cili njëkohësisht është edhe njëri nga zëvendëskryeministrat e Qeverisë së Kosovës. Duke iu referuar përkrahjes së MAPL-së, kryetari Zharku ka përkujtuar me këtë rast ndërtimin e shkollës në fshatin Vataj, e cila është mbështetur financiarisht nga kjo ministri me 91.000 euro.
Kryetari Zharku është shprehur se Komuna edhe më tej do të mbështetet nga MAPL-ja, për realizimin e projekteve të tjera me interes për qytetarët e komunës tonë. Zëvendëskryeministri Petroviq dhe kryetari Zharku janë pajtuar që Komuna e Kaçanikut t'ia përcjellë MAPL-së propozimet konkrete për financimin e ndonjë projekti. Në anën tjetër, ministri z. Petroviq ka shprehur kënaqësinë tij që vizitat nëpër komuna po e nis me Komunën e Kaçanikut. "MAPL-ja sivjet do ta mbështes edhe Komunën e Kaçanikut, varësisht nga kostoja financiare e projektit të propozuar nga komuna, ndërsa për faktin se vitin e kaluar Kaçaniku nuk ka përfituar nga ndihmat e MAPL-së, sivjet do të ketë një përkrahje më të madhe.



# Komuna aplikon në fondin shtesë të LOGOS-it

**16 Janar –** Qeveria lokale e Kaçanikut ka marrë vendim për të aplikuar në fondin fondin shtesë të LOGOS-it, fond i cili ka vlerën 150.000 euro. Ekzekutivi, në takimin e rregullt, ka siguruar se do të respektoj të gjitha afatet dhe kriteret e LOGOS-it dhe se do t'ia propozojë një ose dy projekte për financim. Në takim u tha se afati për aplikim është më së voni deri më 1 shkurt 2012, ndërsa projektet e propozuara duhet të jetë në funksion të përmirësimit të qasjes dhe cilësisë së shërbimeve publike në komunë. Në përputhje me kriteret e LOGOS-it, Komuna do të marr pjesë me 20 për qind të kostos së projekteve.



# Zyrtarët financiar informohen për rrjedhën e parasë së gatshme

**20 Janar** - Zyrtarët financiar të organizatës buxhetore dhe udhëheqësi i personelit, janë informuar për rrjedhën e parasë së gatshme, përkatësisht menaxhimin e punësimit, pagave dhe mëditjeve.

Z. Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, e ka shpalosur letrën e pranuar nga ministri i Ministrisë së Financave, z. Bedri Hamza, me të cilën iu është drejtuar komunave të Kosovës rreth menaxhimit të parasë së gatshme për vitin 2012. Drejtori Vërbani ka veçuar ndryshimet e reja që kanë të bëjnë me procedurat e ekzekutimit të pagave, për çdo muaj të vitit 2012. Ai tha se nga ky vit, në secilin muaj, varësisht nga ndryshimet e mundshme, jemi të obliguar t'i dorëzojmë edhe listat e pagave, të cilat do të verifikohen nga Ministria e Financave dhe ajo e Administratës Publike.



# Kryetari Zharku vizitoi Haraçinën

**20 Janar –** Kreu i Komunës së Kaçanikut, z. Xhabir Zharku dhe zëvendësi i tij z. Heset Loku, kanë realizuar një vizitë miqësore në Komunën e Haraçinës, në Maqedoni, ndërsa janë takuar me kreun e Haraçinës, z. Bastri Bajrami dhe zëvendëskryetarin  Naser Ajdini. Kjo vizitë ka rrjedhur nga premtimi që kryetari Zharku ia pat dhënë më herët kryetarit Bajrami, gjatë një vizite të këtij të fundit në Kaçanik.
Krerët e dy komunave mike kanë trajtuar mundësinë e krijimit të partneritetit të ndërsjellë, për hapjen e rrugëve për tërheqjen e donacioneve të cilat BE-ja i ka paraparë për financimin e projekteve të bashkëpunimit të komunave ndërkufitare.
Në kuadër të vizitës së komunës së Haraçinës, është vizituar edhe kompleksi memorial i varrezave të dëshmorëve në Haraçinë.



# DAK-ja nënshkruan marrëveshje me MASHT-në dhe GIZ-në

**23 Janar –** Në një takim të përbashkët është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Zyrës së GIZ-it dhe Drejtorisë së Arsimit e Kulturës (DAK), për përkrahjen dhe ngritjen e cilësisë së arsimit fillor përmes programit: "Zhvillimi i kapaciteteve në sektorin e arsimit fillor në Kosovë". Marrëveshjen në emër të DAK-së e ka nënshkruar z. Azem Guri, drejtor i kësaj drejtorie, në emër të programit CDBE të GIZ-së, drejtoresha Gagmar Fuchs dhe për MASHT-në, Xhavit Dakaj, sekretar i përgjithshëm.
Programi CDBE parasheh organizimin dhe implementimin e kurseve kompensuese të arsimit joformal dhe ka për qëllim përmirësimin e cilësisë të nxënësve nga klasat I – IX, që kanë braktisur arsimin fillor. Programi ka për qëllim edhe zvogëlimin e numrit të nxënësve braktisësh të shkollimit përmes masave parandaluese. Arsimi joformal në komunën tonë ka filluar në tetorin e vitit të kaluar, ndërsa aktualisht rreth 35 nxënës po e vijojnë kursin në shkollën e Doganajve.



# Largohet bora nga oborret e institucioneve

**25 Janar -** Të prirë nga kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, zyrtarë komunalë kanë ndërmarrë një aksion për largimin e borës nga oborri i Administratës komunale dhe nga oborri i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare. Kryetari Zharku ka vlerësuar se ky është oborr yni dhe na takon ta mirëmbajmë. Ai është shprehur se përmes këtij aktiviteti u përcjellim mesazh të gjithë qytetarëve, e sidomos bizneseve, që ta heqin borën para objekteve të tyre.



# FSK në aksion për zhbllokimin e rrugëve të Kaçanikut

**27 Janar** - Forca e Sigurisë së Kosovës u ka dalë në ndihmë qytetarëve të komunës së Kaçanikut, duke organizuar aksion për largimin e borës nga rrugët e komunës tonë. Heqjen e borës nga rrugët e ka ndihmuar Batalioni i Xhenios i Brigadës Mbështetëse Operative (BXhBMO) të FSK-së. Sipas z. Rushan Ceka, drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjente, gjatë këtij aksioni janë pastruar rrugët në fshatin Dubravë, në segmentin nga varrezat e dëshmorëve deri në Sepetin, pastaj rrugët e fshatit Stagovë dhe në fshatin Kaçanik i Vjetër, ndërkohë që kompania e kontraktuar nga Komuna për mirëmbajtjen e rrugëve, ka hapur rrugën e fshatit Ivajë, atë rrugën Semajë-Bajnicë- Rakaj, ndërsa po vazhdon me hapjen e rrugës së fshatit Drenogllavë, e cila edhe më tej është e pakalueshme.



# Kryetari fton qytetarët për mobilizim të përgjithshëm

**27 janar** - Nisur nga situata e krijuar pas reshjeve të dendura të borës, gjendjen e rrugëve, trotuareve dhe hapësirave para objekteve të banimit dhe afariste, kryetari i Komunës ka ftuar qytetarët për mobilizim të përgjithshëm për daljen nga kjo situatë.

"Apelojmë te të gjithë qytetarët, e në veçanti te pronarët e bizneseve, për mobilizim të përgjithshëm për largimin e borës nga rrugët dhe mirëmbajtjen e hapësirave para dhe në afërsi të objekteve të banimit dhe atyre afariste.

Ju njoftojmë se kompania e kontraktuar për heqjen e borës është duke bërë pastrimin e rrugëve kryesore të vendbanimeve, ndërsa rrugët dytësore, trotuaret dhe hapësirat para objekteve afariste mbeten përgjegjësi e qytetarëve dhe pronarëve të bizneseve.

Po ashtu, ju njoftojmë se nëse nuk merren hapa konkret për heqjen e borës, jemi të detyruar që ndaj pronarëve të papërgjegjshëm të marrim masa ndëshkuese, duke mos përjashtuar as mbylljen e lokaleve të tyre afariste", thuhet në apelin e kryetarit Xhabir Zharku.

# Rihapen shkollat e komunës tonë

**30 Janar** – Pas ndërprerjes së procesit mësimor për shkak të bllokimit të rrugëve nga bora dhe temperaturave të ulëta, sot janë rihapur shkollat në komunën tonë. Drejtori i Arsimit dhe Kulturës, z. Azem Guri, ka thënë se ndryshe nga shkollat e tjera në të cilat ka rifilluar mësimi, në dy zona të thella rurale ku është vlerësuar se ende nuk ekzistojnë kushtet për zhvillimin normal të procesit edukativo arsimor. Ai ka bërë të ditur se në shkollën e fshatit Kërbliq ende nuk kanë rifilluar mësimin 18 nxënës,  sikurse edhe tre nxënës në shkollën e Drenogllavës. Drejtori Guri ka njoftua gjithashtu se për shkak të një defekti të rrymës elektrike, mësimi nuk ka rifilluar edhe në shkollën e fshatit Vatë. Ai ka sqaruar se orët e humbura të mësimit do të kompensohen.

# Mbledhja e parë e KK-së nis me laptopë dhe kamera

**31 Janar** - Kuvendit Komunal i Kaçanikut ka mbajtur mbledhjen e parë për këtë vit, në të cilën ka shqyrtuar dhe miratuar Planin e punës së legjislativit lokal për vitin 2012, pastaj Raportin e punës së ekzekutivit për vitin 2011, Planin e veprimit për përmirësimin e shërbimeve të shënjimit rrugor, ndërsa ka marrë vendim për transferimin e mjeteve financiare në buxhetin e vitit 2012, mjete këto nga të hyrat vetjake, të cilat nuk kanë arritur të shpenzohen gjatë viteve 2010 dhe 2011.

Në seancën e sotme 131.225 euro të mjeteve të pashpenzuara janë bartur në kategori të caktuara të buxhetit të sivjetmë, mjete nga të cilat sipas drejtorit të Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit, z. Fikri Vërbani, 20.377 euro do të shpërndahen për paga, 10.026 euro për mallra e shërbime, 9.695 euro për subvencione dhe 91.126 euro për investime kapitale.

Në fund të kësaj seance kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i ka njoftuar këshilltarët komunalë për pajisjen me nga një laptop të anëtarëve të KK-së. Mbledhja e sotme është përcjellur drejtpërdrejt përmes kamerave të cilat u mundësojnë qytetarëve teleprezencë në seancë nëpërmjet internetit.

Në fillim të mbledhjes, këshilltari i AAK-së njëherësh edhe anëtar i KPF-së z. Shukri Luta, e ka njoftuar kryesuesin e KK-së, z. Xhelal Gashi dhe këshilltarët komunalë se nga sot e tutje nuk e përfaqëson këtë subjekt politik në KK. Nisur nga ky fakt Grupi Parlamentar i AAK-së e ka propozuar këshilltarin Rami Çaka në vend të z. Luta për anëtar të KPF-së nga radhët e AAK-së.



# Kryetari Zharku viziton zonat e izoluara nga bora

31 Janar - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i shoqëruar edhe nga drejtorë komunalë, ka vizituar fshatrat Kërbliq, Gjurgjedell dhe Ivajë, për të parë nga afër gjendjen e rrugëve dhe për të vlerësuar kushtet për rifillimin e procesit mësimor. Përveç nxënësve dhe mësimdhënësve, Kryetari Zharku ka kontaktuar edhe banorë të këtyre fshatrave, nga të cilët ka pranuar falënderime për interesimin e tij për gjendjen e banorëve të këtyre zonave të thella rurale. Kryetari Zharku u ka thënë atyre se Komuna do të bëjë çmos për të krijuar të pamundurën për zhbllokimin e të gjitha rrugëve nga bora, ndërsa i ka ftuar banorët e këtyre zonave për mobilizim maksimal për largimin e borës në segmentet ku nuk mund të arrijë makineria e kompanisë së kontraktuar për pastrimin e borës. Në fshatrat Gjurgjedell dhe Ivajë ka rifilluar procesi mësimor, ndërsa në Kërbliq ende nuk janë krijuar kushte normale për rifillimin e procesit mësimor.



# SHKURT 2012

## Gjendje emergjente në komunën tonë, ndërpritet mësimi

**2 Shkurt** – Si pasojë e gjendjes së rëndë nga reshjet e pandërprera të borës dhe erërave të fuqishme, dhe me qëllim të evitimit të situatave më të rënda, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku fton qytetarët për mobilizim të përgjithshëm. Kryetari u ka bërë apel qytetarëve të Komunës së Kaçanikut që të ndërmarrin veprime konkrete në përputhje me gjendjen emergjente të krijuar në komunën tonë. Kryetari Zharku i ka ftuar qytetarët që të kufizojnë lëvizjet e panevojshme, ndërsa i ka inkurajuar për heqjen e borës dhe mirëmbajtjen e hapësirave para dhe në afërsi të objekteve të banimit dhe atyre afariste.
Në takimin e sotëm Ekzekutivi i komunës tonë ka vlerësuar se si pasojë e kushteve të rënda atmosferike nuk ka kushte për zhvillimin e procesit mësimor, ndërsa ka vendosur që mësimi të ndërpritet për dy ditët e ardhshme (e enjte dhe e premte). Për shkak të situatës së papërmirësuar atmosferike, një ditë më vonë qeveria lokale ka marrë vendim që procesi mësimor të mbetet i ndërprerë edhe për dy ditët e para të javës që vjen (e hënë dhe e martë). Ekzekutivi i komunës mori vendim për shpalljen e gjendjes emergjente në tërë territorin e Komunës së Kaçanikut si pasojë e reshjeve të mëdha të borës e përcjell me erë të fuqishme.

## KKSB apelon për solidaritet ndërqytetarë

**6 shkurt** - Edhe Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi, në takimin e sotëm u ka bërë apel qytetarëve që në këtë situatë të vështirë, të krijuar nga reshjet e mëdha të borës e acarit, të jenë solidar me njëri-tjetrin. “Kërkojmë nga qytetarët që të solidarizohen me familjet skamnore dhe atyre që kanë nevojë për ushqime, veshmbathje e dru zjarri në mënyrë që të tejkalohet situata e rëndë e krijuar këto ditë”, ishte apeli i përgjithshëm i këtij organi konsultativ për çështje të sigurisë në komunën tonë. KKSB-ja e ka paraqitur gjendjen e

rëndë sidomos në fshatrat Kërbliq e Drenogllavë, të cilat edhe më tej janë të bllokuar nga bora e madhe.

Z. Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, ka thënë se kompania e kontraktuar po operon me tërë kapacitetet në terren pandërprerë. A ka bërë të ditur ndërkaq se, gjatë fundjavës janë zhbllokuar fshatrat: Elezaj, Bajnicë, Strazhë, Glloboçicë, Dubravë, Sllatinë, Semajë dhe Koxhaj.



## Kryetari i kursen nga të ftohtit shërbyeset civile

**6 shkurt 2012** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, në takimin e sotëm të ekzekutivit lokal ka marrë vendim për t'i liruar nga puna përkohësisht të gjitha femrat, zyrtare në administratën komunale. Kryetari ka thënë se këtë vendim, sipas të cilit shërbyeset civile janë të liruara të qëndrojnë në shtëpi një javë, e ka marr për arsye të kushteve të jashtëzakonshme të cilat janë krijuar si pasoj e reshjeve të mëdha të borës dhe të ftohtit që po mbretëron këto ditë.

# Administratorët zotohen për tejkalimin e situatë

**7 shkurt 2012** - Kreu i Komunës, z. Xhabir Zharku ka zhvilluar një takim me administratorët e fshatrave dhe ata të lagjeve të qytetit të Kaçanikut, me ç'rast kanë diskutuar për gjendjen e rëndë nga të reshurat e borës në tërë territorin e komunës tonë. Kryetari Zharku ka kërkuar nga paritë e fshatrave ndihmë për tejkalimin bashkërisht të kësaj situate. Ai ka apeluar përmes administratorëve lokal për mobilizim të shtuar të gjithë qytetarëve jo vetëm për hapjen e rrugëve, por edhe për solidaritet qytetarë, për t'i ndihmuar familjet të cilat nuk kanë ushqime, veshmbathje dhe dru zjarri. Apeli i kryetarit Zharku është pranuar fuqishëm nga administratorët e lokaliteteve, të cilët janë zotuar se do t'i koordinojnë aktivitetet dhe veprimet e përbashkëta me komunën me qëllim të tejkalimit të situatës së rënduar. Në takim është thënë se nuk ka munguar kontributi i qytetarëve dhe i disa kompanive private, të cilat kanë vënë në dispozicion makinerinë e tyre për hapjen e rrugëve. Një ditë më pas, qytetarë të shumë lokaliteteve dhe tri kompani private i janë përgjigj thirrjes për mobilizim të përgjithshme për hapjen e rrugëve, ndërsa sipas z. Rushan Ceka, drejtor i DESHP-së, janë hapur për qarkullim rrugët në fshatin Stagovë, rruga Kaçanik i Vjetër - Begracë, Varrezat e dëshmorëve – Kaçanik i Vjetër, Gajre – Ivajë, rrugët e fshatrave Dubravë, Kotlinë, Elezaj, Gabrricë, Duraj, Doganaj, Biçec, Nikaj, Bajnicë, Semajë dhe rruga Bob-Doganaj. Drejtori Ceka ka thënë se aktualisht mbeten të bllokuara rrugët e fshatrave Drenogllavë, Gjurgjedell, Strazhë dhe Sllatinë.



# Qytetarët debatojnë për shpenzimin e buxhetit të vitit 2011

**10 shkurt 2012** - Komuna e Kaçanikut dhe Projekti zviceran-kosovar për qeverisje lokale dhe decentralizim (LOGOS), kanë organizuar debatin me qytetarë me temë: "Ekzekutimi i buxhetit komunal për vitin 2011".
Me këtë rast kryetari i komunës, z. Xhabir Zharku ka kërkuar nga qytetarët e pranishëm që të bëjnë vlerësimin, si dhe të japin vërejtjet dhe sugjerime për shpenzimin e parasë publike për vitin që e lamë pas. Ndërkaq z. Norbert Pijls, koordinator i projektit LOGOS, është shprehur se përmes këtij debati synojmë ngritjen e transparencës se çfarë po bënë komuna me parat tuaja, si dhe ngritjen e llogaridhënies. Prezantimin e ekzekutimit t buxhetit komunal për vitin 2011 e ka bërë z. Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit. Ai ka përkujtuar se buxheti i vitit 2011 ka arritur shumën 5.816,049 euro, nga i cili janë shpenzuar 5.592,558 euro (96.2 %) . Drejtori Vërbani tha se gjysmën e buxhetit e ka shpenzuar sektori i arsimit



2.824,344 euro (50,5 %), pastaj administrata komunale 2.115,817 euro (37.8 %), ndërsa shëndetësia e mirëqenia sociale 652.427 euro ose (11,7 %). Në vazhdim të debatit, qytetarët janë ndarë në dy grupe punuese kanë analizua të hyrat vetjake komunale dhe investimet kapitale.

Grupi për të hyrat vetjake ka nxjerrë këto konkluzione: taksat nga pasuria pyjore të shfrytëzohen në proporcion 50 % me 50 % me nivelin qendror, komuna të vjelë taksat nga resurset natyrore si nga rëra, zhavorri e gurët, të aplikohen taksa për veprimtaritë e turizmit dhe nga qiraja, të ngritët vetëdija e qytetarëve për kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, të lirohen bizneset nga pagesa e tarifave dhe ngarkesave, Qeveria t'ua kthen komunave në menaxhim fondin për emergjenca dhe të rishikohen kriteret për përcaktimin e tatimit në pronë. Ndërkaq grupi për investime kapitale ka renditur këto prioritete: Rritjen e fondit për bashkëfinancim të projekteve, rritjen e transparencës gjatë implementimit të projekteve, garanci nga operatorët ekonomikë për qëndrueshmërinë e projekteve të realizuara si dhe t'u jepet përparësi projekteve të degëve bujqësore.

## Kryeministri Thaçi vizitoi Komunën e Kaçanikut

**14 shkurt 2012** - Kryeministri i Republikës së Kosovës, z. Hashim Thaçi, i shoqëruar nga ministrat Bajram Rexhepi e Agim Çeku, ka vizituar Komunë e Kaçanikut, ndërsa janë pritur nga kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku. Kryeministri Thaçi ka thënë se qëllimi i vizitës është harmonizimi i angazhimeve të përbashkëta të mekanizmave të dy niveleve shtetërore në këto ditë të vështira dimri, ndërsa ka falënderuar kryetarin Zharku dhe të gjithë qytetarët e komunës së



Kaçanikut, për angazhimin dhe solidaritetin e treguar për tejkalimin e situatës së vështirë të krijuar nga reshjet e mëdha të borës. “Edhe pse ende ka vështirësi, situata është duke u normalizuar dhe se do të fillojë edhe mësimi në shkolla”, ka thënë kreu i ekzekutivit kosovar. Ai ka nënvizuar se çdo kërkesë të Komunës së Kaçanikut, Qeveria e Kosovës brenda mundësive do t'i përgjigjet pozitivisht. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka falënderuar kryeministrin Thaçi për mbështetjen e vazhdueshme që i ka dhënë komunës tonë, ndërsa e ka njoftuar atë me gjendjen e përgjithshme në komunë, pas reshjeve të mëdha dhe temperaturave të ulëta.

## Komuna ndan pako ushqimore për familjet e izoluara në Kërbliq

**16 shkurt 2012** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku u ka dhuruar nga një pako ushqimore 5 familjeve të izoluara në fshatin Kërbliq. Kryetari Zharku i cili, në këtë fshat të thellë rural, shoqërohej edhe nga drejtorë të drejtorive komunale, ka thënë se këto pako sa do pak do t’i plotësojnë nevojat më elementare të këtyre familjeve të cilat kanë mbetur të bllokuara tash e dy javë. Kryefamiljarët e pesë familjeve: Isak Samakova (12 anëtarë), Ismajl Samakova ( 8 anëtarë), Arif Dardhishta (8 anëtarë), Dalip Reka (3 anëtarë) dhe Kosum Reka (4 anëtarë) e kanë falënderuar kryetarin Zharku për ndihmat e ofruara dhe kujdesin e treguar. Pako të ngjashme ushqimore me artikuj ushqimor në vlerë 50 euro, ditë më parë u janë shpërndarë edhe pesë familjeve në fshatin Sllatinë.



## Kryetari uron qytetarët për Ditën e Pavarësisë

**16 shkurt 2012** - Qytetarë të nderuar të komunës së Kaçanikut!
Kam kënaqësinë që, me rastin 17 shkurtit - Katërvjetorit të shpalljes së vendit tonë të pavarur, t'ju uroj: Gëzuar Pavarësia e Kosovës.
Sa herë që vjen kjo ditë ne me të drejtë kujtojmë historinë sa të lavdishme aq edhe të dhimbshme. Kjo ditë na përkujton sakrificat dhe vuajtjet tona, na kujton breza të tërë që luftuan nëpër kohë, na kujton dëshmorët e rënë për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës, ata që dhanë më të shtrenjtën, jetën e tyre. Gjaku i tyre u bë themel i së sotmes dhe i shtetit të bashkuar shqiptarë.

Gëzuar përgjithmonë!
Përzemërsisht,
Kryetari i Komunës
Xhabir Zharku

## Kryqi i Kuq Komunal dhuron 30 pako ushqimore

**16 shkurt 2012** - Dega e Kryqit te Kuq të Kosovës në Kaçanik, në bashkëpunim me Komitetin Komunal të Emergjencës, ka ndarë 30 pako ushqimore për 30 familje në lokalitete të ndryshme të komunës tonë. Secila nga 30 familjet kanë përfituar nga 50 kilogram miell dhe nga një pako ushqimore me artikujt më elementarë. Z. Zekrja Loku, sekretar i degës së KKK-së, ka thënë se nga një pako kanë përfituar 8 familje në fshatin Semajë, 6 familje në Gjurgjedell, 4 familje në Kotlinë, 3 në Ivajë, 1 në Kovaçec dhe 8 familje dhe në strehimoren kolektive. Rushan Ceka, koordinator i Komitetin Komunal për Emergjencë ka thënë se pakot ushqimore u janë shpërndarë kryesisht familjeve të izoluara nga bora dhe me nevojë më të theksuar. Ai ka shtuar se pako të



ngjashme ushqimore, Komuna u ka shpërndarë edhe 10 familjeve të bllokuara në fshatrat Kërbliq e Sllatinë. Kryqi i Kuq Komunal në bashkëpunim me Komitetin Komunal të Emergjencës, u ka shpërndarë pako ushqimore edhe 60 familjeve skamnore në lokalitetet të ndryshme të komunës tonë. Këto të fundit janë pako donacion i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë.

## Homazhe të rënëve në Ditën e shtetësisë së Kosovës

**17 shkurt 2012** - Në katërvjetorin e pavarësimit të vendit tonëve janë nderuar dëshmorët e rënë për liri, me ç'rast pranë Kopleksit të Varrezave të Dëshmorëve të komunës së Kaçanikut janë vendosur kurora lulesh. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku me stafin e tij komunal dhe shumë veteranë të luftës së UÇK-së dhe qytetarë të tjerë, kanë bërë homazhe dhe kanë parakaluar përpara pllakave përkujtimore të dëshmorëve. Kryetari Zharku është shprehur me këtë rast i nderojmë dëshmorët që sakrifikuan jetën e tyre për liri. “Gjaku i tyre u bë themel i së sotmes dhe i shtetit të bashkuar shqiptar”, tha në fund të fjalës së tij kryetari Zharku.



# Komuna dhe USAID-i për Raportin e vlerësimit të QSHQ-së

**23 shkurt 2012** - Zyrtarë të USAID-it - përkatësisht të Programit të Iniciativave për Komuna Efektive e Demokratike (DEMI) dhe zyrtarë komunalë kanë debatuar për përmbajtjen e Raportit të vlerësimit për qendrën e shërbimit të qytetarëve të Komunës së Kaçanikut (QSHQ). Z. Lachezar Rossenov, shef i njësisë për administratë komunal, i cili shoqërohej edhe nga z. Sali Salihu e z. Besnik Hoxha, ka thënë se ky raport ka identifikuar mundësitë në mënyrë që Komuna t'i merr përgjegjësitë për avancimin e shërbimeve më të mira për qytetarët përmes E-Qeverisjes. Ai ka thënë se E-Qeverisja në komuna, veç tjerash, krijon efikasitet të lartë të administratës dhe për zbatimin e demokracisë në nivel lokal. Ndërkaq, pas shqyrtimit të këtij raporti, nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, ka thënë se si Komunë jemi të gatshëm të marrim përgjegjësi dhe të shfrytëzojmë tërë kapacitetet tona për përmirësimin, përkatësisht avancimin e shërbimeve në fushat e identifikuara. Z. Rossenov ka premtuar se USAID-i do t'i financojë këto projekte me 80 %, ndërsa Komuna do të participojë me 20 të vlerës së projekteve.



## Komuna dhe USAID bashkëfinancojnë projektin e sinjalizimit

**27 shkurt 2012** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, e ka nënshkruar formën e buxhetit për fondin mbështetës të USAID-it, për realizimin e projektit "Sinjalizimi vertikal dhe horizontal" në disa lokalitete të komunës tonë. Sipas paramasës dhe parallogarisë projekti kap vlerën e përgjithshme 30 mijë euro, prej të cilave 23.360 euro (80 %) do t'i dhurojë USAID-i, ndërsa Komuna e Kaçanikut do të participojë me 6.640 euro ose 20 % të vlerës së projektit.

## Institucionet nderojnë veprën e dëshmorit Hetem Hasaj

**28 shkurt 2012** – Udhëheqës të Komunës kanë nderuar në 13-vjetorin e rënies dëshmorin e UÇK-së, Hetem Hasajn. Në vendin e rënies së dëshmorit, kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, nënkryetari z. Heset Loku, zyrtarë komunalë, përfaqësues dhe anëtarë të OVL UÇK-së dhe qytetarë të tjerë kanë bërë homazhe dhe më pas kanë vendosur kurora lulesh edhe në Kompleksin Memorial të Dëshmorëve. Në betejën Gajres, më 28 Shkurt të vitit 1999, forcat armike serbe pësuan humbje të mëdha në makineri dhe njerëz, ne mesin e tyre edhe Komandantin e dhunshëm të Stacionit të Policisë në Kaçanik, Bogoljub Staletoviq.



# KK merr vendim për lirimin e bizneseve nga taksat komunale

**29 shkurt 2012** – Kuvendi i Komunës së Kaçanikut ka marrë vendim për t'i liruar nga taksat vjetore të bizneset e komunës tonë. Sipas vendimit i cili u mor në seancën e rregullt të KK-së, bizneset janë liruar nga taksat vjetore për periudhën tre vjeçare 2012-2014, ndërsa pronarët e bizneseve të cilët vijnë nga kategoritë e dala nga lufta e UÇK-së (familjeve të dëshmorëve, invalidëve të luftës dhe veteranëve të luftës) janë liruar nga kjo taksë komunale për periudhën 2012-2016. Lidhur me këtë, Grupi Parlamentar i AAK-së e ka cilësuar si të panevojshëm kategorizimin, duke propozuar që sikurse bizneset tjera edhe ato të kategorive të luftës të trajtohen njësoj. Por propozimi i AAK-së nuk e ka marrë mbështetjen e KK-së.
Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, duke arsyetuar propozimin për heqjen e ngarkesës vjetore për bizneset, ka thënë se ne po u krijojmë lehtësira bizneseve me qëllim që të nxitet hapja e bizneseve të reja. Kryetari Zharku është shprehur i vetëdijshëm se me këtë vendim do të zvogëlohen të hyrat komunale, por ka sqaruar se në konsultim me partnerët ndërkombëtar këto të hyra do të plotësohen me donacionet e jashtme.



# MARS 2012

## SHFMU “Emin Duraku” finaliste e kuizit “Evropa 2012”

**1 mars 2012** - Shkolla Fillore e Mesme e Ulët “Emin Duraku”, nga Kaçaniku, është kualifikuar për finale në kuizin e diturisë “Evropa 2012”. Dy ekipet finaliste, ai i nxënësve të shkollës “Emin Duraku” dhe shkollës “Thimi Mitko” nga Gjilani, do të garojnë në finalen, që mbahet më 6 mars 2012 në Teatrin ODA. Ekipi fitues do të shpërblehet me 10 ditë vizitë vendeve të Bashkimit Evropian.

Drejtori i kësaj shkolle, Lulzim Krasniqi, tha se kuizi është pjesë e projektit evropian: "Perspektivë Evropiane në Kosovë ", projekt i cili implementohet nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë. Ekipi garues i nxënësve të kësaj shkolle nëntëvjeçare (grupmosha 11–14 vjeç) ishte zgjedhur në mesin e 32 shkollave të Kosovës. Në garat regjionale të mbajtura në Ferizaj, më 29 nëntor 2011, ekipi i shkollës “Emin Duraku” është kualifikuar për gjysmëfinale e cila garë u zhvillua më 29 shkurt 2012. Kuizi “Evropa 2012 mbështetet edhe nga Ministria e Arsimit, Shkencës e Teknologjisë së Kosovës.



# KKSB-ja diskuton për problemet në KBI

**5 mars 2012** - Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi (KKSB) ka diskutuar problemin e shkaktuar nga zgjedhjet e reja në Këshillin e Bashkësisë Islame në Kaçanik. Anëtarët e KKSB-së këtë problem e kanë vlerësuar si tejet shqetësues për sigurinë e përgjithshme të qytetarëve. Z. Heset Loku, nënkryetar i Komunës, ka propozuar që në emër të KKSB-së t'i bëhet ftesë Bashkësisë Islame të Kosovës që të bëjë të mundurën për stabilizimin e situatës. Nisur nga situata e krijuar KKSB-ja ka apeluar te dy palët në konflikt për qetësi e maturi, ndërsa i është bërë apel edhe KBI-së që të japë kontributin e vet për qetësimin dhe tejkalimin e kësaj situate, në të kundërtën, në rast të ndonjë pasoje BIK-u nuk mund të hiqet nga përgjegjësia. Kjo rrethanë është krijuar me rastin e zgjedhjeve në KBI-në e Kaçanikut, proces të cilin kryetari i deritanishëm i këtij këshilli, z. Musli Vërvani, kuvendin e ka cilësuar si jo të rregullt. Mosmarrëveshjet kanë nisur menjëherë pasi kryetar i ri i KBI-së në Kaçanik është zgjedhur z. Florim Neziraj. Lidhur me zhvillimet dramatike në KBI, policia ka raportuar për hapje të rasteve ndaj disa personave për veprën "kanosje" dhe "dëmtim të pronës".



# Diskutohet për autonomi financiare për shkollat

**05 mars 2012 -** Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku dhe z. Alberto Rodriguez, shef i sektorit të arsimit për Rajonin e Evropës dhe Azisë Qendrore nga Banka Botërore (BB), me seli në Uashington, kanë diskutuar për autonominë financiare për shkollat e komunës tonë.

Kryetari Zharku, në takimin në të cilin merrte pjesë edhe z. Nehat Mustafa, zëvendësministër i Arsimit, Shkencës e Teknologjisë, e ka njoftuar z. Rodriguez me përpjekjet që po i bënë Komuna e Kaçanikut për ndërtimin e një sistemi arsimor sa më të avancuar. Ndërkaq zëvendësministri Mustafa ka thënë se veçanërisht projekti i Bankës Botërore për autonominë financiare të shkollave i ka dhënë mbështetje të fuqishme arsimit në nivel vendi. Ai ka sqaruar se drejtorët e shkollave tash e tutje nga drejtues teknik, kanë kaluar në menaxher të përgjithshëm. Ndërkaq shefi i AREAQ-së, z. Rodriguez, është shprehur se autonomia në shkolla është treguar e suksesshme, për faktin se ato janë më të fuqishme në vendimmarrje. Drejtori i Arsimit dhe Kulturës, Azem Guri, e ka njoftuar përfaqësuesin e BB-së se, në komunën tonë funksionojnë 12 shkolla fillore, dy të mesme dhe 1 qendër për edukim parafillor me gjithsej 8600 nxënës.



# Kryeministri i vendit nderon dëshmorët e komunës tonë

**7 mars 2012** - Gjatë një vizite të shkurtër që i ka bërë komunës tonë, për nder të përvjetorit të 13-të të Epopesë së UÇK-së, kryeministri i Kosovës, z. Hashim Thaçi, i shoqëruar edhe nga kryetari i Komunës së Kaçanikut, z. Xhabir Zharku kanë bërë homazhe te Kompleksi i Varrezave të Dëshmorëve të komunës së Kaçanikut, ndërsa kanë vendosur edhe kurora lulesh. Kryeministri Thaçi dhe kryetari Zharku po ashtu kanë vendosur lulesh dhe janë përkulur edhe para lapidarit të dëshmorit Agim Bajrami, komandant Zefi, ish-komandant i Brigadës 162 të UÇK-së. Kryeministri Thaçi shoqërohej nga ministri i Infrastrukturës, z. Fehmi Mujota, ministri i Diasporës, z. Ibrahim Makolli dhe Elmi Reçica, deputet në Parlamentin e Kosovës.



# Kremtohet 7 marsi - Dita e mësuesit

**7 mars 2012** – Për nder të 125-vjetorit të hapjes së mësonjëtores së parë shqipe, është shtruar një darkë dhe është kremtuar 7 marsi – Dita e mësuesit. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, i ka përgëzuar arsimtarët për misionin fisnik të tyre për arsimimin dhe edukimin e brezave. Kryetari Zharku ka theksuar me këtë rast se mësuesit ishit ata që na mësuan e edukuan, ata që u bënë pjesë e pandarë e jetës dhe suksesit tonë, që nuk kursyen asgjë për ti pajisur nxënësit me dije, kulturë dhe edukatë. Kryetari Zharku, duke folur për organizimin e sotëm të arsimit, tha se në sistemin e sotëm arsimor janë bërë reforma progresive, duke u dhënë autonomi më të madhe edhe financiare shkollave. Për kontributin e veçantë në fushën e arsimit dhe edukimit, kryetari Zharku i ka nderuar me mirënjohje dhe me nga një orë muri nga një mësimdhënës të secilës nga shkollat e komunës tonë dhe një të Qendrës së Edukimit dhe Arsimimit Parashkollor: Izet Krivanjeva, Kemajl Çaka, Xhemil Hajdari, Shefket Zharku, Rexhep Ilazi, Ekrem Salihu, Hismet Imishti, Zoja Gashi, Alije Luma, Lazime Mani, Zijadin Rexha, Nuhi Kuçi, Liri Neziraj-Zeneli, Skender Topalli, Remzije Koxha.



# Epopeja e UÇK-së përmbyllet me ndezjen e flakadanit të lirisë

**8 mars 2012** - Me aktivitetin e ndezjes së zjarreve te Varrezat e Dëshmorëve, është përmbyllur Epopeja e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Në këtë aktivitet, në shënimin e 14-vjetorit të Epopesë së UÇK-së, morën pjesë kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, familjarë të dëshmorëve, ish-ushtarë të UÇK-së dhe qytetarë të tjerë. Kryetari i Komunës, z. Zharku është shprehur me këtë rast se sot po përkujtojmë Epopenë e lavdishme të komandantit legjendar Adem Jashari dhe sakrificën vetëflijuese të familjes Jashari. Kryetari Zharku ka tha se nuk do të harrohet e kaluara jonë e dhimbshme, por e lavdishme.



# Përkujtohen dëshmorët e rënë në Betejën e Ivajës

**8 mars 2012** - Janë përkujtuar dëshmorët Murat Lika, Qani Luma, Raif Koraçi dhe Osman Luma, në 13 vjetorin e rënies heroike të tyre. Pranë lapidarit të dëshmorëve, në vendin e rënies, kurora lulesh, në emër të institucioneve komunale ka vendos nënkryetari i komunës, z. Heset Loku. Kurora lulesh kanë vendos edhe përfaqësues të OVL-UÇK-së dega në Kaçanik, bashkëluftëtarë të dëshmorëve, përfaqësues të shkollës së fshatit Ivajë, e Strazhë, përfaqësues të fshatit Ivajë, familjarë të dëshmorëve etj.
Nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku ka thënë se dëshmorët Murat Lika, Qani Luma, Raif Koraçi dhe Osman Luma janë skalitur në themelet e lirisë ndërsa shtoi se ne të gjallët kemi borxh ndaj dëshmorëve që ëndrrën e tyre për të cilën luftuan ta qojmë deri në fund. Nënkryetari Loku duke folur për heroizmin e dëshmorëve dhe luftën e Ushtrisë çlirimtare të Kosovës ka thënë se jo vetëm përmes këtyre manifestimeve përkujtimore duhet tu tregojmë brezave që po vijnë për sakrificat dhe gjakun e derdhur për liri. Në emër të familjeve të dëshmorëve, të pranishmit i ka përshëndet Ilmi Luma, vëlla i dëshmorit Osman Luma. Në betejën e Ivajës, të 8 marsit 1999, në luftimet me forcat serbe ranë dëshmorë, Murat Lika, Qani Luma, Raif Koraçi dhe Osman Luma ndërsa qenë plagosur 10 ushtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Homazhe janë bërë edhe varrezave të dëshmorëve në kompleksin memorial.



## Urimi i kryetari Zharku për festën e 8 Marsit

**8 mars 2012** - Në këtë ditë të shënuar - Ditën Ndërkombëtarë të Gruas, kam kënaqësinë që të gjitha nënave e motrave t'ua uroj 8 Marsi. Në këtë ditë feste, me shumë respekt përgëzoj të gjitha gratë shqiptare, përgëzoj me shumë dashuri nënat që na lindën e rritën me shumë sakrifica. Me respekt e përulje kujtojmë nënat heroina që lindën trima e atdhetarë si Adem Jasharin, Agim Bajramin, Qamil Ilazin e shumë e shumë nëna të tjera që lirisë së vendit, i falën bijtë e bijat e tyre.

Përzemërsisht,
Kryetari i Komunës
Xhabir Zharku

## Arkivohen materialet e dhjetëvjetëshit të fundit

**14 mars 2012** - Zyrtarë të sektorit të arkivit komunal janë duke bërë arkivimin e lëndëve që i përkasin dhjetëvjetëshit të fundit.
Hafide Kuka, koordinatore e sektorit të arkivit, ka thënë se është duke u klasifikuar, sistemuar e arkivuar materiali i periudhës dhjetëvjeçare 1999-2009. Znj. Kuka ka thënë se deri tani janë kompletuar 120 kuti arkivore, të cilat përmbajnë materiale të ndryshme si projekte kapitale, leje ndërtimi, kontrata për shfrytëzimin e tokës ndërtimore, etj. Ndërkaq z. Faik Hoxha, arkivist, është shprehur se gjatë



selektimit të lëndëve janë hasur edhe lëndë me afat të skaduar, të cilat janë asgjësuar. Në arkivin komunale është duke u zbatuar aplikacioni online i e-arkivës, nga projekti i E-qeverisjes. Për sivjet, deri më sot, janë arkivuar 5154 lëndë në mënyre elektronike.

Z. Jeton Topalli, drejtor i Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme, është shprehur se arkivimi elektronik krijon qasje më të shpejt dhe të lehtë në kërkesat e përditshme. Ai shtoi se synim është digjitalizimi i plotë i arkivës komunale e me këtë edhe rritjen e numrit të dokumenteve të arkivuara në mënyrë elektronike.

## LOGOS-i dhe Komuna ndërtojnë trotuar në Kaçanik të Vjetër

**20 mars 2012** - Nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku dhe z. Norbert Pijls, koordinator i Projektit Zvicër-Kosovë për përkrahje të qeverisjes lokale dhe decentralizim (LOGOS), e kanë nënshkruar një kontratë bashkëfinancimi nëpërmjet të cilës do të realizohet projekti i ndërtimit të trotuarit në Kaçanik të Vjetër. Sipas kontratës së nënshkruar, për realizimin e këtij projekti janë akorduar 70.263 euro, prej të cilave LOGOS-i i ka dhuruar 50 mijë euro, ndërsa Komuna 20.263 euro.



# KFOR-i: Siguria në Kaçanik, shembull për tërë Kosovën

**20 mars 2012** – Komandanti i KFOR-it, Erhard Drews ka vizituar komunën e Kaçanikut, ndërsa është pritur në një takim miqësor nga kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku. Kryetari Zharku e ka falënderuar gjeneralin Drews për vizitën e tij në Komunën e Kaçanikut dhe i ka thënë se i çmojmë si miq të mirë të gjithë ata që ndihmuan që Kosova të bëhet shtet i pavarur. Ndërkaq gjenerali Drews ka thënë se ardhja e tij në Kaçanik ishte dëshirë e tij, për t'u njoftuar me gjendjen e përgjithshme në Komunën e Kaçanikut. Duke folur për gjendjen e sigurisë, gjenerali Drews ka thënë se komuna e Kaçanikut është komuna më e qetë në Kosovë dhe se po të kishim një gjendje sigurie kështu të mirë në tërë Kosovën, atëherë nuk do të ishte e nevojshme prania e KFOR-it në Kosovë. Gjenerali Drews në shenjë respekti i ka dhuruar kryetarit Zharku emblemën e KFOR-it, ndërsa kryetari i ka dhurua gjeneralit Drews një ekzemplar të Vjetarit 2011.



# Komuna angazhohet për menaxhim më cilësor të mbeturinave

**21 mars 2012** - Zyrtarë komunal dhe ata të Kompanisë Regjionale të Mbeturinave "Pastërtia" kanë diskutuar për menaxhimin më të mirë të mbeturinave dhe ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët e Komunës së Kaçanikut. Nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku ka thënë se kohëve të fundit nuk jemi të kënaqur me shërbimet që ofron Njësia Komunale për menaxhimin e mbeturinave. Ai tha se jemi të interesuar që të përmirësohen shërbimet që u ofrohen qytetarëve tanë. Ndërkaq, z. Gazmend Bytyqi, drejtor i KRM "Pastërtia", me seli në Ferizaj, ka thënë nuk është i kënaqur me shkallën e arkëtimit të hyrave nga shërbimi që kryhet. Z. Bytyqi tha se Njësia komunale për menaxhimin e mbeturinave mbulon vetëm 40 % të territorit të komunës. Shefi i Njësisë "Pastërtia" në Kaçanik, Ferat Malsiu, ka potencuar faktin se kjo njësi për menaxhimin e mbeturinave aktualisht nuk ka kapacitete për zgjerimin e zonës për grumbullimin e mbeturinave. Ai tha se kemi mungesë të mekanizmit punues, por edhe të kapaciteteve njerëzore.



# Kaçaniku, komunë partnere e USAID-it

**23 mars 2012** - Komuna e Kaçanikut është komunë partnere e Agjencionit Amerikan për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Punëtor të kompanisë së kontraktuar nga USAID e kanë vendosur në hyrje të oborrit të objektit të Komunës tabelën për partneritet në mes të Komunës së Kaçanikut dhe USAID-it. Në tabelë është shkruar teksti: “Kjo komunë është partnere e USAID-it, për Programin Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (IKDE)”. Komuna e Kaçanikut në bashkëpunim me USAID-in është duke bashkëpunuar në disa projekte. Kohë më parë Komuna ka aplikuar në Fondin Stimulues të raundit të II-të të USAID-it në projektin IKDE. Komuna e Kaçanikut ka aplikuar në fondin për menaxhimin e performancës së shërbimeve dhe në atë të kuvendeve komunale transparente.



# Kotlina përkujtoi 14 dëshmorët dhe 15 martirët

24 mars 2012 - Në fshatin Kotlinë, në trembëdhjetë vjetorin e rënies janë përkujtuar 14 dëshmorë dhe 15 martirë të këtij fshati. Fjalën e rastit e ka mbajtur Latif Loku, i cili është shprehur se edhe sot na bashkon kjo date, që si gjithnjë t'i nderojmë të rënët për lirinë e Kosovës dhe me respektin më të madh të përkulemi para veprës së tyre heroike.

Tubimin e ka përshëndetur z. Hajrush Kurtaj, ish-zëvendëskomandant i Brigadës 162 "Agim Bajrami". Ai u shpreh se Ushtria Çlirimtare e Kosovës e udhëhequr nga komandanti legjendar Adem Jashari, ishte arritja më kulmore në historinë tonë, e cila ia ndërroi rrjedhat historisë. Të pranishmit në këtë tubim përkujtimor, në emër të familjeve të dëshmorëve i ka përshëndetur z. Mustafë Loku.

Në nderim të të rënëve, nxënësit e shkollës fillore "Naim Frashëri" kanë shfaqur një program kulturor artistik. Pranë lapidarit të ngritur edhe te vendi i rënies dhe janë vendos kurora lule e po ashtu janë vendos kurora lule dhe janë bërë homazhe te Kompleksi Memorial i Dëshmorëve.



# Kryetari Zharku priti këshilltaren Habesli

**30 mars 2012** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku ka pritur në zyrën e tij znj. Katherine Habesli, këshilltare regjionale për qeverisje në Zyrën zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim. Në takim kanë prezantuar edhe z. Pascal Fredrich, zyrtar i LOGOS-it, z. Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit e z. Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit e Mbrojtjes së Mjedisit.

Znj. Habesli ka thënë me këtë rast se e kam zgjedhur Kaçanikun për ta vizituar, sepse kam dëgjuar fjalë shumë të mira për bashkëpunimin e ndërsjellë të LOGOS-it dhe Komunës së Kaçanikut. Ndërkaq, kryetari Zharku i ka thënë znj. Habesli se Komuna e Kaçanikut është një nga komunat partnere të LOGOS-it dhe e ka falënderuar Qeverinë zvicerane për investimet në Komunën e Kaçanikut. Investimet nga projekti LOGOS janë vlerësuar dhe çmuar shumë lartë edhe nga vet qytetarët e komunës sonë. Ai ka veçuar ndërtimin e urës mbi lumen Neredime, projekt i realizuar me bashkëfinancim të LOGOS-it dhe Komunës së Kaçanikut, si një nga projektet më të rëndësishme. Më pas kryetari Zharku dhe znj. Katherina Habesli kanë vizituar urën mbi lumin Neredime, e ndërtuar vitin e kaluar, për të cilën LOGOS ka investuar 50 mijë euro, ndërsa Komuna e Kaçanikut 27.602 euro.



PRILL 2012

## Iniciohet menaxhimi i aseteve të Komunës

**5 prill 2012** - Komuna e Kaçanikut dhe USAID-i, përkatësisht Projekti i iniciativave për komuna demokratike dhe efektive (IKDE), e kanë iniciuar formimin e grupit punues për menaxhimin e pasurisë së paluajtshme në pronësi të Komunës së Kaçanikut. Grupi punues ka për detyrë të merret me çështje të ndryshme teknike, krahas strategjisë, politikave dhe çështjeve rregullative lokale të menaxhimit të tokës dhe aseteve. Inventarizimi dhe menaxhimi i pronës dhe aseteve komunale do të bëhet në përputhje me Udhëzuesin e hartuar nga konsulentë amerikanë dhe vendorë të USAID-it (të projektit IKDE). Udhëzuesi përfshin në mënyrë të detajuar hapat e mëtutjeshëm të punëve dhe aktiviteteve për të punuar drejt përmirësimit të menaxhimit të aseteve.

Grupi punues do përbëhet nga zyrtarë të specializuar nga të gjitha sferat përfshirë: zyrtarë komunalë, komunitetin e biznesit, shoqërinë civile dhe anëtarë të Kuvendit Komunal.



# Komuna ndihmon sportin dhe kulturën

**6 prill 2012** - Kryetari i Komunës z. Xhabir Zharku ka nënshkruar vendimet për mbështetje financiare në lartësi 15 mijë euro për 6 klubet sportive kaçanikase të cilat garojnë në liga të ndryshme në nivel vendi, si dhe dy vendime për shoqëritë kulturore-artistike që veprojnë në komunën tonë. Këto mjete janë ndarë për aktivitetet e klube për vitin 2012, ndërsa përfitues janë: KF Lepenci 6.000 euro, KF Kaçanikasja (femrat) 1.500 euro, KH Lepenci 1.500 euro, Klubi i Taekwondoo-s "Shqiponja" 1.000 euro, Klubi i Pingpongut "Kaçaniku", 500 euro, KH Lepenci (femrat) 1.000 euro si dhe SHKA "Shqiponja" 1.500 euro e SHKA "Gryka e Kaçanikut" 1.500 euro. Për dallim nga dy shoqëritë kulturore e artistike (SHKA "Shqiponja" dhe "Gryka e Kaçanikut"), SHKA "Rrezet e Sharrit" nuk ka gëzuar mbështetje financiare pasi nuk ka zhvilluar aktivitet kulturor dhe nuk ka dëshmuar shpenzimet e shumës (1.000 euro) të cilën ia kishte ndarë Komuna vitin e kaluar.



# Komuna aplikon në fondin EU-BK dhe MPMS

**6 prill 2012** - Ekzekutivi i Komunës e ka mbajtur takimin e rregullt të fundjavës, në të cilin është bërë e ditur se është aplikuar në tri projekte të raundin e dytë të Programit të Bashkimit Evropian “Kosova e bukur” ( Programi EU-BK). Sipas Rushan Cekës, drejtor i Shërbimeve Publike dhe Emergjente, për të përfituar nga ky fond është aplikuar për ndërtimin e hapësirave gjelbëruese në zonat urbane, renovimin e Shtëpisë së Kulturës “Xheladin Kurtaj” dhe renovimin e pjesës së jashtme të objektit të QKMF-së. Komuna ka aplikuar edhe me dy projekte në Programin e punëve publike “Kosova 2012” dhe atë për heqjen e deponive ilegale dhe pastrimi i përroskave. Ky program ka për objektiv gjenerimin e punësimit të përkohshëm për të papunët dhe zbutjen e varfërisë, ndërsa mbështet nga Banka Botërore dhe implementohet nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale.



# Përkujtohen dëshmorët dhe martirët e 9 Prillit 1999

**9 prill 2012** - Në trembëdhjetë vjetorin e rënies janë përkujtuar 28 dëshmorë dhe 32 martirë të rënë në Betejën e "Lagjes së Re" dhe "Rakocit", në Kaçanik. Në vendin e rënies së 9 dëshmorëve dhe 8 martirëve, pranë pllakës përkujtimore në tubimin në "Lagjen e Re" fjalë rasti ka mbajtur Muharrem Ahmetaj, bashkëluftëtar i dëshmorëve, ndërsa në "Rakoc" fjalën e rastit e ka mbajtur Hajrush Kurtaj, ish-zëvendëskomandant i Brigadës 162 "Agim Bajrami".

Në emër të strukturave komunale tubimet i kanë përshëndetur Rushan Ceka dhe Misim Sopa, ndërsa në emër të familjeve të dëshmorëve pjesëmarrësit e tubimeve përkujtimore i kanë falënderuar Kosovare Thaçi, e bija e dëshmorit Mynyr Thaçi dhe Sabit Raka, i ati i dëshmores Jehona Raka.

Pranë pllakave përkujtimore e të rënëve janë vendosur lule kurora lulesh, ndërsa më pas janë bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve. Në Betejën e 9 Prillit, në "Lagje të Re" ranë dëshmorët: Izahir Troni, Mynyr Thaçi, Remzi Zharku, Blerim Raka, Habit Dullovi, Raif Krivanjeva, Fatmir Horuni, Sylejman Kuka dhe Burim Rexha, ndërsa në Betejën e "Rakocit" ranë heroikisht dëshmorët: Fadil Çaka, Nehat Çaka, Faruk Dogani, Muhamet Zeneli, Ilir Zharku, Nexhmush Elezi, Luminije Raka, Jehona Raka, Emsale Frangu, Abdurrahim Shehu, Reshat Shehu, Daut Rakoci, Kjani Bela, Shefket Fera, Nexhmi Fera, Adem Rakoci, Nevzat Çallaku, Mukadeze Muhaxheri-Lika dhe Kadri Trena.



# Përkujtohen dëshmorët dhe martirët e 13 Prillit

**13 prill 2012** - Në përvjetorin e 13-të të rënies në altarin e lirisë, në fshatin Sllatinë të Kaçanikut janë përkujtuar dëshmorët: Ramadan Xhokli, Isen Elezi, Shaban Elezi, Naim Beka, Agim Matoshi dhe Avni Shehu si dhe 13 martirë të lirisë. Pranë lapidarit të dëshmorëve e martirëve janë vendosur lule të freskëta nga institucionet komunale, SHFMU "Ali Asllani" dhe familjarët e të rënëve.

Në emër të këshillit organizues të këtij tubimi përkujtimor ka folur Kemajl Murseli, administrator i fshatit Doganaj, i cili ka theksuar se e kemi për obligim që përherë ta kujtojmë veprën madhore dhe sublime të dëshmorëve dhe martirëve. Në emër të institucioneve komunale tubimin e ka përshëndetur Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural. Në vazhdim nxënësit e SHFMU "Ali Asllani" kanë shfaqur një program kulturor-artistik dhe më pas janë bërë homazhe të Varrezat e Dëshmorëve.



# BB-ja e bën me kabinet shkollën e Stagovës

**14 prill 2012** - Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ultë “Agim Bajrami” nga fshati Stagovë ka përfituar një grant prej 5 mijë e 75 euro për funksionalizimin e kabinetit të informatikës. Banka Botërore e cila financon projektin për Zhvillimin Institucional të Arsimit (IDEP) ka ndarë shumën prej 4,825 euro ndërsa Komuna e Kaçanikut do të participon me 250 euro. Azem Guri, drejtor I Drejtorisë së Arsimit e Kulturës ka thënë se Ekipi Komunal për Grante Shkollore, të cilin e kryeson ai , e ka përzgjedhur shkollën e Stagovës për të qenë përfituese e projektit (IDEP). Z. Guri ka saktësuar se përzgjedhja është bërë në përputhje me kriteret e Këshillit Qendror për Aprovimin e Granteve. Është thënë se funksionalizimi i kabinetit të informatikës dhe pajisja me teknologji informative do të ndikon në ngritjen e cilësisë në mësim.

# Ambientalistët e rinj formojnë nëngrupe në shkolla

**18 prill 2012** - Grupi Ambientalistët e Rinj kanë filluar organizimin e nëngrupeve ambientaliste nëpër të gjitha shkollat fillore dhe të mesme të komunës tonë. Kjo është mundësuar nëpërmjet projektit “S’bashku për një mjedis të pastër”, të financuar nga organizata “Inovation Lab Kosovo”.



Disa anëtarë të këtij grupi, të shoqëruar nga Fatmir Çaka, koordinator për rini në Kaçanik, kanë vizituar gjimnazin “ Skënderbeu” dhe SHFMU “Emin Duraku” dhe kanë përzgjedhur nxënësit të cilët do të jenë pjesë e nëngrupeve ambientale të

shkollave përkatëse. Sipas koordinatores së këtij projekti znj. Fatlume Guri, në këtë takim, nxënësve u është shpjeguar për format e bashkëpunimit me nëngrupet e krijuara. Me këtë rast, në mënyrë simbolike nxënësve u janë dhuruar disa mjete të nevojshme pastrimi.
Ky projekt do të zgjasë më shumë se dy muaj, ndërsa në fund planifikohet që të organizohet një debat dhe një ekspozitë me punimet në ese dhe pikturë nga nxënësit pjesëmarrës.

## Caritasi i Luksemburgut ndihmon shkollat me vegla pune

**19 prill 2012** - Fondacioni CARITAS NGA Luksemburgut i ka ndihmuar me vegla pune të gjitha shkollat e komunës tonë. Drejtorët e 12 shkollave fillore dhe 2 të mesme, bashkë me punëtorët teknik kanë pranuar veglat e punës, ndërsa të pranishëm gjatë ndarjes së tyre ishin edhe z. Gerhard Fischer, shef i Zyrës së CARITAS-it për Kosovë dhe z. Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës. Të gjitha shkollat kanë pranuar nga një set veglash që kanë vlerë rreth 500 euro ndërsa përmbajnë: sënduk (kofer) për mjete pune plasti, komplet kaçavidash, çelës francez, çelës imbus komplet, çelësa të hapur, aku me bateri 9.6 V, dana të ndryshme, lima druri e metali, komplet burgia etj. Drejtori Guri e ka falënderuar z. Fischer për donacionin e ofruar dhe mbështetjen që CARITAS-i i Luksemburgut po i jep arsimit kaçanikas. Ky fondacion i ka ndihmuar më herët me nga tri mijë euro të gjitha shkollat e komunës tonë dhe ka ndarë 68 bursa nga 400 euro për nxënës të klasave të dhjeta.



# Përkujtohet komandant “Shpata”

**22 prill 2012** - Në 13-vjetorin e rënies në altarin e lirisë janë përkujtuar dëshmorët e UÇK-së, Feriz Guri- komandant “Shpata” dhe bashkëluftëtari i tij Xhevdet Guri. Për t'i nderuar në këtë përvjetor është mbajtur një manifestimin përkujtimor në vendin e rënies, në Gorancë të Hanit të Elezit, në afërsi të kufirit Kosovë-Maqedoni, në të cilin kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve komunale të Kaçanikut dhe të Hanit të Elezit, bashkëluftëtarë, familjarë e të afërm dhe qytetarë jo vetëm nga komuna jonë, si dhe shokë të studimeve të inxhinierit të diplomuar të elektroteknikës Feriz Gurit. Tubimin e ka përshëndetur kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ndërsa fjalën e rastit në këtë manifestim e ka mbajtur Jusuf Lushaku, bashkëluftëtar njëherësh shok i studimeve i dëshmorit Feriz Guri. Ai figurën e komandant Shpatës e ka cilësuar si flakadan të lirisë, duke e radhitur në mesin e figurave të mëdha të luftës së UÇK-së si: Adem Jasharit, Zahir Pajazitit, Agim Ramadanit e shumë të tjerëve. “Feriz Guri ishte një burrë i madh i Kosovës, fliste pak e punonte me nderë. Përherë ishte njeri i fjalës, i pendës e i pushkës, i cili e bashkoi rininë studentore në udhën kombëtare, në udhën e lirisë”, është shprehur z. Lushaku. Në emër të familjeve të dëshmorëve ka përshëndetur Kjani Guri, vëllai i komandant “Shpatës”. Me këtë rast është shfaqur edhe një program kushtuar dëshmorëve. Pranë pllakës përkujtimore janë vendosur kurora lulesh dhe më pas janë bërë homazhe te kompleksi i Varrezave të Dëshmorëve të komunës tonë.



# Fermerëve përfitojnë farë misri e pleh artificial

**25 prill 2012** – Nëpërmjet projektit për subvencionim të mbjelljeve të sivjetme pranverore, 84 fermerë nga komuna jonë kanë përfituar farë misri dhe pleh artificial. Nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, u ka thënë fermerëve se Komuna po mundohet që përmes subvencionimit të nxisë zhvillimin e sektorit të bujqësisë. Për këtë vit janë planifikuar që të shpenzohen për këtë sektorë 100 mijë euro. Ai u ka premtuar fermerëve se edhe në të ardhmen do të kenë mbështetjen e Komunës. Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë, ka sqaruar se përfitues të këtij subvencioni janë fermerët që posedojnë parcela në sipërfaqe prej 0,50 ha deri në 1 ha. Fermerët kanë përfituar nga 1 deri në 3 thasë farë misri dhe 2 deri në 4 thasë pleh artificial.



# KPF shqyrton Raportin tremujor të buxhetit

**25 prill 2012** - Komiteti për Politikë e Financa ka shqyrtuar Raportin tremujor të buxhetit dhe Propozim-vendimin për riemërimin e pronësisë së paluajtshme të pronës komunale, duke përfshir institucionet arsimore, shëndetësore, ish-Bashkësitë Vetëqeverisëse të Interesit, të cilat deri më tani janë evidentuar si pasuri shoqërore. KPF po ashtu ka debatuar rreth raportit të shpenzimeve buxhetore të tremujorit të parë të këtij viti. Sipas këtij traporti, për periudhën Janar-Mars buxheti është realizuar shumën prej 851.742 euro ose 15.2 % e buxhetit final (5.592,504 euro). Nga kjo shumë, për paga dhe mëditje janë shpenzuar 616.970 euro ose 16.4 %, për mallra dhe shërbime 95.904 euro ose 22.5 %, për shërbime komunale 22.453 euro ose 26.7 %, për transfere dhe subvencione 12.005 euro ose 30.2 % dhe për investime kapitale është shpenzuar shuma prej 104.410 euro ose 8.2 % e buxhetit. Gjithnjë sipas këtij raporti, gjatë periudhës së sipërpërmendur janë arkëtuar gjithsej 77.640 euro ose 10.7 % e buxhetit të planifikuar për të hyrat vetjake (727.879 euro).



# Përurohet objekti i ri shkollor në fshatin Vataj

**25 prill 2012** - Në fshatin Vataj është përuruar shkolla e re pesëklasëshe, paralele e ndarë fizikë e SHFMU "Kadri Zeka" nga fshati Dubravë. Shiritin përurues e kanë prerë z. Xhabir Zharku, kryetar i Komunës, z. Zenun Pajaziti, djali i vëllait të heroit Kadri Zeka, njëherësh edhe deputet në parlamentin e Kosovës, Ramadan Vishi, babai i dëshmorit Bashkim Vishi si dhe drejtori i shkollës, Ekrem Vishi. Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku i ka uruar nxënësit, arsimtarët dhe gjithë banorët e fshatit Vataj për shkollën e re, ndërtimi i së cilës ishte kërkesë e kamotshme e këtij komuniteti. Nxënësit, arsimtarët dhe banorët e fshatit Vatë i ka përgëzuar për shkollën e re edhe z. Zenun Pajaziti ndërsa një fjalë rasti e ka prezantuar drejtori i shkollës, Ekrem Vishi. Për nderë të këtij përurimi, nxënësit kanë prezantuar një program të pasur kulturor. Objekti i shkollës fillore i tipit P+1 përbën bazën me 300 m2 dhe ka pesë dhoma mësimi, bibliotekën, nxehjen qendrore dhe hapësirën përcjellëse. Për realizimin e këtij projekti janë investuar 191.239 euro, prej të cilave 100.239 euro i ka ndarë Komuna e Kaçanikut dhe 91.000 mijë euro Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.



## BPK-së i shtohen 718 libra të reja

**26 prill 2012** - Biblioteka Publike e Komunës është pasuruar edhe me 718 ekzemplarë librash. Grupi “Koha” i ka dhuruar një sasi ekzemplarësh librash Bibliotekës Kombëtare Universitare (BKU), e cila një sasi prej 638 ekzemplarësh i ka sjell Bibliotekës Publike të Komunës së Kaçanikut. BKU, po ashtu , më këtë rast i ka dhuruar edhe 80 copë librash nga fondi i vet për Bibliotekën Publike të Komunës. Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës, e ka falënderuar Grupin “KOHA” dhe BKU-në, ndërsa është vlerësuar se ky donacion, i cili ka freskuar këtë bibliotekë me tituj të ri librash, është i mirëseardhur.

## MKRS-ja mbështet Festivalin “Kaçaniku 2012”

**30 prill 2012** - Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e ka mbështetur me 2.500 euro Festivalin Kombëtarë të SHKA-ve “Kaçaniku 2012” . Kontratën për financim e kanë nënshkruar z. Kamuran Goranci, drejtor i Departamentit të Kulturës (MKRS) dhe z. Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës. Mjetet janë siguruara nga programi i MKRS-së për manifestime kulturore. Sipas Kontratës së nënshkruar, këto mjete do të shfrytëzohen vetëm për qëllimin e dedikuar. Këtë vit Komuna e Kaçanikut organizon edicionin e 24-të tradicional të Festivalit “Kaçaniku 2012”.

MAJ 2012

## KLV monitoron punët e rrezikshme të fëmijëve

**2 maj** - Komiteti Lokal i Veprimit (KLV) për monitorimin e punëve të rrezikshme të fëmijëve ka mbajtur takimin e dytë të radhës në të cilin ka shqyrtuar Udhëzuesin për zhvillimin e procesit të monitorimit të punës së fëmijëve në nivel komunal, të hartuar nga Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS). Misim Sopa, udhëheqës i KLV-së, njëherësh drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ka thënë se Qeveria e Republikës së Kosovës ka shprehur përkushtimin për ndalimin e punës së fëmijëve, në përputhje me konventat ndërkombëtare të Organizatës Ndërkombëtare të Punës. Në takim janë dhënë edhe certifikatat për anëtarët të cilët kanë përfunduar një trajnim për monitorimin e punës së fëmijëve. Anëtarët e KLV-së i kanë pranuar edhe pyetësorët përmes se cilëve ata mund ti paraqesin rastet e identifikuar të punës së fëmijëve.



# CARITAS-i Luksemburgut dhe Komuna financojnë projekte në Elezaj

**4 maj –** Fondacioni CARITAS nga shteti i Luksemburgut dhe Komuna e Kaçanikut do të financojnë ndërtimin e ambulancës shëndetësore dhe terrenet sportive në fshatin Elezaj. Projektet janë vlerësuar me prioritet nga donatorët dhe komuniteti i fshatit Elezaj. Marrëveshja e bashkëfinancimit është nënshkruar nga z. Gerhard Fischer, shef i Zyrës së CARITAS-it dhe drejtorëve të drejtorive përkatëse komunale Misim Sopa, Azem Guri e Bekim Troni si dhe administratori i fshatit Elezaj, Ramadush Osmani.

Ky fondacion dhe Komuna kanë nënshkruar më herët një marrëveshje për investime të përbashkëta në fshatin Elezaj. Sipas marrëveshjes investimet do të bëhen në fushën e edukimit, shëndetësisë dhe në për gjenerimin e të hyrave, ndërsa vlera e përgjithshme e investimeve është 400.342 euro. Sipas kësaj marrëveshje CARITAS do ta dhurojë shumën 316.460 (70 % të kostos së projekteve) dhe Komuna e Kaçanikut 83.882 euro (30 %).



# Ekzekutivi zotohet për zbatimin e vendimit për lirimin e hapësirave publike

**7 maj** - Ekzekutivi i komunës është zotuar për zbatimin e vendimit të marrë më 27 prill, për largimin e objekteve në afërsi të shkollës fillore “Emin Duraku” në qytet. Vendimi ishte marrë duke u bazuar në nenin 80 të Statutit të Komunës dhe në përputhje me Planin Zhvillimor Urban, ndërkaq ka për qëllim krijimin e hapësirës për qarkullim të lirë, jo vetëm të nxënësve të shkollës.

Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Ambientit, ka thënë se të gjithë pronarët e lokaleve janë njoftuar se duhet t’i largojnë objektet e tyre më së voni deri më 4 qershor. Ai ka thënë se janë gjithsej 34 lokale me leje të përkohshme që do të rrënohen. Prej tyre 24 gjenden në afërsi të shkollës “Emin Duraku” dhe 10 të tjera në rrugën “Agim Bajrami”.



# Kryetari Zharku dorëhiqet nga posti i parë i Komunës

**11 maj** - Kryetari i Komunës, z. Xhabir Zharku, ka dhënë dorëheqje nga posti i parë i komunës tonë. Dorëheqjen nga ky post kryetari Zharku e ka bërë publike në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal, në prani të zyrtarëve komunalë dhe gazetarëve të cilët raportojnë nga komuna e Kaçanikut. Ai ka thënë se dorëheqjen po e bëjë publike para stafit tim të ngushtë dhe zyrtarëve komunalë me të cilët kemi punuar së bashku deri sot. Kryetari Zharku i ka falënderuar të gjithë qytetarët për përkrahjen e ofruar përherë dhe Qeverinë e Kosovës në krye me z. Hashim Thaçi, për përkrahjen e vazhdueshme. Kreu i deritanishëm i Komunës së Kaçanikut njëkohësisht i ka falënderuar edhe organizatat ndërkombëtare, të cilat me donacionet e tyre financiare kane kontribuar për realizimin e projekteve të ndryshme në interes të qytetarëve të Komunës së Kaçanikut. Kryetari Zharku veçanërisht ka falënderuar stafin e tij profesional, ekzekutivin dhe këshilltarët komunalë si dhe kryesinë e Degës së PDK-së në Kaçanik, për të cilët tha se i kanë dhëne mbështetje të vazhdueshme në ushtrimin e detyrave dhe obligimeve zyrtare në shërbim të komunës sonë. Dorëheqja e kryetarit ka pasuar pas një vendimi të gjykatës, e cila e ka dënuar atë me tri vjet burgim dhe me gjobë 1.500 euro për veprën penale "detyrim dhe armëmbajtje pa leje". Zhabir Zharku (PDK) është zgjedhur kryetar komune në vitin 2007 dhe është rizgjedhur edhe për një mandate të dytë në vitin 2009.



# SHFMU "Emin Duraku" fiton "Olimpiadën e diturisë"

**12 maj -** Shkolla Fillore e Mesme e Ulët "Emin Duraku" nga Kaçaniku e ka fituar garën "Olimpiada e diturisë", garë e nivelit shtetëror.
Shkolla "Emin Duraku" është përfaqësuar nga Grupi "Ardhmëria" që përbëhej nga nxënësit: Lorik Loku, Lirona Bela dhe Alush Bujupi, ndërsa janë udhëhequr nga mësimdhënësi Avdyl Reka. Grupi paraprakisht me sukses ka kaluar dy fazat e para të testimit, duke u radhitur në finale përkrah 7 shkollave më të suksesshme në Republikën e Kosovës.
Për suksesin e arritur nxënësit i ka përgëzuar nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku dhe z. Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës. Për suksesin e treguar dhe në shenjë motivimi nënkryetari Loku e ka shpërblyer këtë grup nxënësish me një vizitë pesëditore në Shqipëri, ndërkohë që organizatori i garës i ka shpërblyer me një vizitë pesëditore në Paris të Francës.



# Përkujtohen dëshmorët dhe martirët e 14 Majit

**14 maj -** Në fshatin Llanishtë, në vendin e rënies, janë përkujtuar dëshmorët e luftës së UÇK-së, Burhan Zeneli e Hesat Axhami, të cilët ranë në altarin e lirisë 13 vjet më parë. Në vendin e rënies pranë pllakës përkujtimore dëshmorëve fjalë rasti ka mbajtur Fatmir Çaka. Në emër të institucioneve komunale tubimin e ka përshëndetur Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë. Te vendi i rënies së dëshmorëve Zeneli e Axhami kurora lulesh ka vendosur nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, bashkëluftëtarët e dëshmorëve dhe familjet e tyre si dhe përfaqësuesit e shkollës "Idriz Seferi" nga fshati Bob. Po ashtu në 13-vjetorin e rënies në fshatin Gjurgjedell janë përkujtuar edhe dëshmorët Rizvan e Xhezair Bela, Sakip Mulaku dhe Ejup Dushkaja si dhe martirët e luftës: Hajdin Bela, Zejnete Avdiu, Selvete e Miradije Kuka dhe Osman Jezerci.



# KKSB-ja apelon te BIK-ja për zgjidhjen e problemit në KBIK

**15 maj** - Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) i ka bërë apel Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK) që ta zgjidh problemin në Këshillin e Bashkësisë Islame në Kaçanik (KBIK). KKSB e ka vlerësuar tejet shqetësuese gjendjen e krijuar në KBIK, pas zgjedhjeve të reja në këtë këshill. Duke prezantuar gjendjen në KBIK, Jaser Jaha, u.d. i komandantit të Stacionit Policor në Kaçanik ka thënë se situata vazhdon të jetë e tensionuar. Ndërkaq, anëtarët e KKSB-së, Kjani Sallahu dhe Zekirja Loku kanë kërkuar nga drejtuesit e pushtetit komunalë në Kaçanik që ta aranzhojnë një takim me krerë të Bashkësisë Islame të Kosovës, për ta trajtuar këtë problem dhe për të ndikuar në uljen e tensioneve të cilat kanë rënduar sigurinë e përgjithshme në komunën tone. Nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, ka shprehur gatishmërinë për ta takuar kreun e BIK-së, z. Naim Tërnava, por ka sqaruar se as Komuna dhe as KKSB-ja nuk do të interferojnë në çështje të brendshme të tyre.



# Përkujtohet Komandant Bardhi

**15 maj –** Në nderim të veprës sublime për lirinë e Kosovës dhe në 13-vjetorin e rënies dëshmor, është mbajtur tubim përkujtimor për Qamil Ilazin-Komandant Bardhi. Ish-komandanti i Brigadës 162 të UÇK-së "Agim Bajrami", është përkujtuar në fshatin e tij të lindjes në Kaçanik të Vjetër dhe te vendi i rënies dëshmor. Fjalën e rastit për Komandant Bardhin, me të cilin ra dëshmorë dhe u përkujtua në këtë tubim edhe Selim Shehu, e ka mbajtur Osman Krasniqi, i cili ka përshkruar veprimtarinë patriotike të Qamil Ilazit, që nga viti 1981 e deri në ditën e rënies në altarin e lirisë. Ndërkaq, nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, i cili e ka përshëndetur këtë manifestim, tha se dëshmorët dhe të rënët janë dëshmia e përjetshme dhe sublime e krenarisë sonë kombëtare. Nënkryetari Loku tha se Komandant Bardhi dhe dëshmorët u flijuan sepse lirisë i duhej gjaku i tyre, sepse shkolla e tyre ishte atdhedashuria e mbjellur me rrënjë nga prijësit dhe patriotët shqiptarë si Skënderbeu, Ismajl Qemajli, Isa Boletini, Hasan Prishtina, Adem Jashari, komandant Zefi e shumë dëshmorë të tjerë. Në emër të familjes së Komandant Bardhit, të pranishmit i ka përshëndetur djali i tij Blerim Ilazi. Nxënësit e shkollës "Qamil Ilazi" e cila me krenari mban emrin e komandant Bardhi, shfaqen një program kulturor e artistik, ndërsa më pas janë vendosur lule pranë lapidarit në vendin e rënies dhe te Kompleksi Memorial i Dëshmorëve.



# Projekt për gjenerimin e punësimit

**18 maj** - Komuna e Kaçanikut ka nënshkruar një marrëveshje me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale, nëpërmjet të cilës parashihet gjenerimi i punësimit të qytetarëve të komunës tonë. Marrëveshjen në emër të Komunës e ka nënshkruar nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku. Projekti realizohet nga Programi i punëve publike për gjenerimin e punësimit dhe zvogëlimin e varfërisë, në përputhje me Strategjinë e Punësimit 2010-2012, e hartuar nga MPMS-ja. Sipas Marrëveshjes së Mirëkuptimit projekti duhet të përfundoj deri më 30 nëntor 2012, ndërsa së paku 60 % të shpenzimeve nga projekti të jenë të dedikuara për pagat e të punësuarve. Projekti parasheh punësimin sezonal të 54 punëtorëve në kohëzgjatje katër muaj, prej të cilëve 80 % angazhohen përmes Zyrës së Punësimit.



# LOGOS dhe Komuna bashkëfinancojnë trotuarin në Kovaçec

**18 maj** - Projektit Zvicër-Kosovë për përkrahjen e qeverisjes lokale dhe decentralizimit LOGOS ka marrë përsipër financimin e projektit të trotuarit për këmbësorë nga SHMP "Feriz Guri e Vëllezërit Çaka" deri në fshatin Kovaçec. Kontratën në emër të LOGOS-it e ka nënshkruar z. Norbert Pijls, koordinator i LOGOS-it, ndërsa në emër të Komunës, z. Heset Loku, nënkryetar. Ndërtimi i trotuarit në gjatësi 1500 metra dhe gjerësi 1,5 metra do të bëhet në anën e majtë të segmentit të rrugës Bob-Kovaçec, duke filluar nga SHMP-ja e deri te "Mulliri i Kuq" në Kovaçec. Sipas Kontratës LOGOS-i do të financojë me me 80 % të vlerës së projektit ndërsa Komuna Kaçanikut, me 20 %. Kontratën e sipërpërmendur nënkryetari Loku e ka nënshkruar në prani të z. Dardan Maliqi, zyrtar për projekte në LOGOS. Projekti Zvicër-Kosovë Përkrahja për Qeverisje Lokale dhe Decentralizim - LOGOS financohet nga Qeveria Zvicerane përmes Zyrës Zvicerane për bashkëpunim në Kosovë SCO, ndërsa realizohet nga Fondacioni Zviceran HELVETAS.



# Në Stagovë përkujtohen dëshmori Ekrem Gudaqi dhe 13 martirët e rënë

**21 maj** - Në fshatin Stagovë është përkujtuar dëshmori Ekrem Gudaqi dhe 13 martirë të rënë më 21 maj të vitit 1999: Fjalë rasti në emër të Këshillit Organizues për shënimin e këtij përvjetori ka mbajtur Bekim Gudaqi, ndërsa në emër të institucioneve komunale tubimin e ka përshëndetur nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku. Të pranishmit në këtë tubim përkujtimor, në emër të familjeve të dëshmorëve i ka përshëndetur Rrustem Gudaqi, vëllai i dëshmorit Ekrem Gudaqi, përkatësisht i ati fëmijës shtatëvjeçar Fitim Gudaqi, i cili u martirizua për lirinë e Kosovës, më 21 maj 1999, në Stagovë.



# Përkujtohet dëshmori Kemal Thaçi

**22 maj** - Në fshatin Runjevë, në trembëdhjetë vjetorin e rënies, është përkujtuar dëshmori Kemal Thaçi. Për jetën dhe veprën heroike të dëshmorit ka folur Zekirja Loku, bashkëluftëtar i tij. Në emër të institucioneve komunale tubimin e ka përshëndetur Misim Sopa, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ndërsa në emër të familjeve të dëshmorëve të pranishmit i ka falënderuar për pjesëmarrje Sevdije Thaçi, e bija e dëshmorit Kemal Thaçi. Më pas është shfaqur edhe një program kulturor-artistik dhe janë vendosur lule pranë pllakës përkujtimore të dëshmorit Thaçi.



# Aksion për mirëmbajtjen e ambientit

**24 maj -** Qytetarët e komunës tonë i janë përgjigjur masivisht aksionit për pastrimin e ambientit, i organizuar me moton: "Ta pastrojmë Kosovën" ("Let's do it Kosova"). Në këtë aksion janë përfshirë: Komuna, Këshilli Rinor për Veprim Lokal (KRVL), Grupi "Ambientalistët e rinj", nxënës të shkollave të mesme e fillore, arsimtarë, punëtorë etj, ndëkohë që ky aktivitet është mbështetur nga policia, administratorët lokalë dhe KRM "Pastërtia". Aksioni është organizuar nga Komuna në bashkëpunim me KRVL-në.



# Marrëveshje Mirëkuptimi për riinxhinierimin e sipërfaqeve

**25 maj 2012 –** Komuna e Kaçanikut ka nënshkruar Marrëveshje Mirëkuptimi me Agjencionin Kadastral të Kosovës (AKK) për riinxhinierimin e hapësirave të Zyrës Kadastrale Komunale në Kaçanik. Marrëveshjen e sipërpërmendur e ka nënshkruar nënkryetari i Komunës, z. Heset Loku, ndërsa në këtë ceremoni merrnin pjesë edhe Ismet Kryeziu, drejtor në Zyrën ligjore të AKK-së, Muzafer Çaka, koordinator i zyrës për koordinimin e projekteve me Bankën Botërore (BB) dhe Edmond Mjaku, shef i sektorit të kadastrit në Komunën e Kaçanikut. Financimi i këtij riinxhinierimi bëhet nga projekti i BB-së RECAP, i cili konsiston me rregullimin e plotë të sistemit të kadastrës, ngritjen e kapaciteteve, rregullimin e regjistrit të drejtave pronësore, hartimin dhe forcimin e kornizës ligjore dhe funksionalizimin e plotë të zyrave kadastrale komunale, ndërsa implementuese e projektit është Agjencia Kadastrale e Kosovës.



# Biçeci përkujton dëshmorët dhe martirët

**25 maj** - Në trembëdhjetëvjetorin e rënies në fshatin në Biçec me një manifestim përkujtimor janë përkujtuar dëshmorët: Nazmi Osmani, Avdullah Baftiu, Sadik Guri, Qemal Guri, Kemal Kolshi, Shaqir Kuka, Sakip Hysa, dhe martirët e luftës, të cilët ranë më 25 maJ 1999. Në këtë tubim Biçeci i ka përkujtuar edhe tre dëshmorët e këtij fshati të cilët ranë më 9 Prill 1999: Fadil Bunjaku, Habit Dullovi dhe Fatmir Horuni. Fjalën e rastit në emër të këshillit organizues e ka mbajtur Fatmir Xh. Bunjaku, ndërsa në emër të strukturave komunale manifestimin e ka përshëndetur z. Heset Loku, nënkryetar i Komunës. Në emër të familjeve të dëshmorëve të pranishmit në këtë manifestim përkujtimor i ka përshëndetur Ganimete Kolshi, motra e dëshmorit Kemal Kolshi. Në vazhdim anëtarët e SHKA "Rrezet e Sharrit" nga Biçeci kanë shfaqur një program me këngë e valle. Para se të fillojë manifestimi qendror janë bërë homazhe dhe janë vendosur lule pranë pllakës përkujtimore të dëshmorëve Shaqir Kuka e Sakip Hysa (në lagjen Kuka), pranë pllakës përkujtimore të dëshmorëve Avdulla Baftiu, Nazmi Osmani dhe Kemal Kolshi (në Lagjen Zharku), te pllaka përkujtimore e dëshmorëve Qemal Guri e Sadik Guri (në vendin e quajtur "Arat e Stanit" në Biçec) si dhe te bustet e dëshmorëve: Fadil Bunjaku, Habit Dullovi e Fatmir Horuni, në Biçec, e më pas edhe te Kompleksi I Varrezave të Dëshmorëve.



# Përurohen tri projekte në Elezaj

**25 maj 2012** – Në fshatin Elezaj janë përuruar tre projekte të cilat janë financuar nga Fondacioni CARITAS nga Luksemburgu dhe ka participuar edhe Komuna. *Z.* Gerhard Fischer, shef i Zyrës së CARITAS-it për Kosovë, Bekim Troni, drejtor i DUKMM-së, Avni Krasniqi, zyrtar i arsimit, Hanife Shorra, drejtoreshë e SHFMU "Nazmi Osmani" në Elezaj dhe Ramadan Osmani, arsimtar, e kanë preë shiritin e përurimit. Projektet e përuruara janë: projekti i vendosjes së shportave për grumbullimin e mbeturinave (3.100 euro), ai për ndërtimin e pusit për furnizim me ujë të shkollës (7.000 euro) dhe kabineti i informatikës dhe biblioteka e shkollës (12.000 euro). CARITAS-i i Luksemburgut dhe Komuna patën nënshkruan një marrëveshje për investime të përbashkëta në Elezaj në vlerë 400. 342 euro, prej të cilave e para do të dhurojë shumën 316.460 euro (70 % të vlerës së projekteve) dhe Komuna e Kaçanikut 83. 882 euro (30 %).

# CDF dhe Komuna ndërtojnë Qendrën e komuniteteve në Kaçanik të Vjetër

**29 maj** - Në fshatin Kaçanik i Vjetër ka filluar ndërtimi i Qendrës për Komunitete. Ky projekt parasheh ndërtimin e objektit të Zyrës së Vendit, i cili do të përmbajë: bibliotekën, tri zyre, sallën për takime dhe hapësirën tjetër përcjellëse. Objekti ka dimensionet 18.35 me 11.20 metra, ndërsa është duke u realizuar me bashkëfinancim të CDF-së dhe Komunës së Kaçanikut. Sipas marrëveshjes së nënshkruar CDF-ja do të financojë me 65.520 euro dhe Komuna me 24.100 euro.



# KK miraton rishikimin e buxhetit

**30 maj** - Kuvendi Komunal me shumicë votash e ka miratuar rishikimin e buxhetit për vitin 2012. Sipas raportit të prezantuar nga drejtori i Financave, Zhvillimit dhe Ekonomisë, z. Fikri Vërbani, buxheti i rishikuar nuk ka pësuar ndryshime nga buxheti I aprovuar në shtator të vitit të kaluar (5.457,755 euro). Vërbani ka sqaruar se ndryshimet dhe plotësimet e propozuara në buxhetin komunal 2012, kanë për qëllim rregullimet brenda kategorive ekonomike të shpenzimeve në programet buxhetore dhe në nivel të organizatës buxhetore, në mënyrë që për periudhën e mbetur të vitit të kemi një stabilitet buxhetor dhe ekzekutim sa më efikas të buxhetit. Sipas tij, ndryshimet e propozuara në RBK për vitin 2012 janë në pajtim të plotë me parimet themelore ligjore dhe instruksionet e MF-së, pasi BK ruan neutralitetin buxhetor, ruan kufijtë e përgjithshëm të shpenzimeve të miratuara me buxhetin fillestar dhe lejimin e lëvizjeve normale të mjeteve.



QERSHOR 2012

## Ndërtohet shtrati i përroskës në rrugën “Lidhja e Prizrenit”

**1 qershor** - Kanë filluar punimet për ndërtimin e shtratit të përroskës në rrugën “Lidhja e Prizrenit”. Sipas projektit do të ndërtohet shtrati, përkatësisht kanali i hapur nga betoni i armuar në gjatësi 250 metra. Punët janë në fazën fillestare, ndërsa është duke u bërë gërmimi i dheut për formimin e shtratit të përroskës. Punimet janë kontraktuar në shumë 24.420 euro.



# KKSB bënë apel për fushatë të qetë

**5 qershor** - Këshilli Komunal i Sigurisë në Bashkësi u ka apeluar të gjitha subjekteve politike që të zhvillojnë fushatë të qetë dhe pa tensione politik, gjatë gjithë procesit zgjedhor. Në takimin e KKSB-së, anëtarë të këtij këshilli të cilët përfaqësojnë shoqërinë civile, kanë ndarë mendimin për organizimin e një takimi me drejtues të shtabeve zgjedhore apo edhe të liderëve të subjekteve politike, të cilat garojnë në këto zgjedhje, për të përcjellë mesazhe te zgjedhësit për sjellje të dinjitetshme dhe kontribut për mbarëvajtjen e tërë procesit elektoral. Në fund KKSB-ja është pajtuar që publikisht t'i apelohet qytetarëve dhe subjekteve politike të angazhohen për fushatë dhe zgjedhje të qeta. Nënkryetari I Komunës, z. Heset Loku, është shprehur se duhet të bëjmë përpjekje maksimale që procesi zgjedhor të shkojë mirë. Ndërkaq togeri Mehmetali Hajdini, i sapoemëruar komandant i Stacionit Policor Kaçanik, ka thënë se këso mesazhe u janë përcjellë drejtpërdrejtë subjekteve politike edhe nga policia.



# Mbahen garat komunale për nderë të Ditës së Çlirimit

**8 qershor** - Për nderë të 11 Qershorit - Ditës së Çlirimit të komunës së Kaçanikut dhe 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, janë mbajtur garat komunale në 7 lëndë mësimore të klasave VI dhe VIII. Garat janë mbajtur në lëndët mësimore: gjuhë shqipe, histori, gjeografi, biologji, kimi, fizikë dhe matematikë, ndërsa nxënësit më të mirë janë shpërblyer me mirënjohje nga Drejtoria e Arsimit e Kulturës. Z. Azem Guri, drejtor i DAK-së, i ka uruar nxënësit për suksesin e arritur nxënësit e shpërblyer, ndërsa u ka thënë atyre se nga ju presim që në një të ardhme të afërt të bëheni edukator, arsimtarë, mjekë, inxhinierë, por edhe profesione tjera në të mirë të shoqërisë.



# Promovohen dy libra për kohën e luftës së UÇK-së

**10 qershor-** Në Shtëpinë e Kulturës "Xheladin Kurtaj", janë promovuar dy libra të autorit Hajrush Kurtaj, ish-zëvendëskomandant i Brigadës 162 të UÇK-së "Agim Bajrami". Librat e promovuar titullohen "Në rrugën e lirisë" dhe "Lufta e UÇK-së në ZON". Me rastin e këtij inaugurimi, në emër të strukturave udhëheqëse komunale autorin e botimit të këtyre dy veprave e ka përgëzuar kryetari në detyrë z. Heset Loku. Ndërkaq, gjenerali Kudusi Lame, duke i vlerësuar këto vepra si pasuri të luftës, është shprehur se misioni i luftëtarit nuk përfundon me mbarimin e luftës, por luftën duhet edhe ta shkruajmë. Për librat kanë folur edhe Selim Daci, recensent, Rexhep Bunjaku, veprimtar i çështjes kombëtare dhe Murtez Neziraj e Xhemal Krivanjeva, bashkëluftëtarë të autorit. Autori i dy veprave "Në rrugën e lirisë" dhe "Lufta e UÇK-së në ZON", kolonel Hajrush Kurtaj, i ka falënderuar të gjithë bashkëpunëtorët, bashkëluftëtarët dhe gjithë të tjerët për mbështetjen e ofruar, ndëra është shprehur i lumtur që botimi i këtyre dy veprave u bë në 134-vjetorin e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë dhe 13 vjetorin e çlirimit të Kaçanikut.



# Filloi Festivali XXIV i SHKA-ve “Kaçaniku 2012”

**10 qershor** – Në oborrin e Gjimnazit “Skënderbeu” në Kaçanik, ka filluar Festivali Kombëtar i shoqërive dhe ansambleve kulturore artistike “Kaçaniku 2012”. Në këtë festival i cili është tradicional dhe mbahet për nder të përvjetorit të 13-të çlirimit të Kaçanikut dhe 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë, po marrin pjesë shoqëri nga mbarë trojet shqiptare: SHKA “Bresana” nga Sharri, SHKA “Muharrem e Xhevat Qena” nga Hasi i Prizrenit, SHKA ”Bajram Shabani” nga Kumanova, SHKA ”Valët e Liqenit” nga Struga, QK ”Pjetër Gaci” nga Shkodra dhe shoqëritë nikoqire SHKA “Gryka e Kaçanikut” dhe SHKA ”Shqiponja” nga Kaçaniku. Juria profesionale e këtij festivali përbëhet nga: Prof.dr. Rexhep Munishi, etnomuzikolog, kryetar i jurisë, prof. Sami Piraj, muzicient dhe këngëtari Milaim Mezini.



# Komuna uron qytetarët për Ditën e Çlirimit

**10 qershor** - Të nderuar qytetarë të komunës së Kaçanikut, 11 Qershori - Dita e Çlirimit të Kaçanikut, është ditë e krenarisë sonë të madhe dhe njëkohësisht edhe e dhembjeve dhe kujtimit për të gjithë ata që u sakrifikuan për lirinë dhe pavarësinë e vendit. Ideali i lirisë dhe lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, do të ndriçojë gjithmonë dhe do të jetë udhërrëfyes për ndërtimin e jetës së re për të gjithë ne. Kujtimi për dëshmorët do të jetë i përjetshëm. Të nderuar qytetarë, ky përvjetor është më i veçantë, pasi sivjet shënojmë edhe 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë dhe 4-vjetorin e shpalljes së pavarësisë së Kosovës.



***Gëzuar Dita e Çlirimit!***

**Heset Loku, kryetar në detyrë i Komunës së Kaçanikut**

# Nderohen dëshmorët në Ditën e Çlirimit

**11 qershor** - Për nder të Ditës së Çlirimit të komunës së Kaçanikut, janë mbajtur aktivitete të ndryshme. Aktivitetet kanë filluar me vendosjen e luleve në Kompleksin Memorial të Varrezave të Dëshmorëve, ku janë bërë homazhe dhe janë vendosur lule nga krerët komunalë, shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së dhe qytetarë të tjerë. Nderime janë bërë edhe pranë shtatores së dëshmorit Agim Bajrami, ish-komandantit të Brigadës 162 të UÇK-së, i cili është dekoruar nga shteti me medaljen "Adem Jashari". Për nder të 11 Qershorit - Ditës së Çlirimit të komunës së Kaçanikut janë zhvilluar edhe aktivitete kulturore e sportive.



# QK “Pjetër Gaci”, fitues i festivalit “Kaçaniku 2012”

**11 qershor** – Me shfaqjen e programeve të natës finale, është përmbyllur Festivalit Kombëtar i shoqërive dhe ansambleve kulturore artistike “Kaçaniku 2012”. Në natën finale janë shpallur edhe më të mirët e këtij eveniment kulturore. Vendin e pare e ka fituar Qendra Kulturore “Pjetër Gaci” nga Shkodra, vendin e dytë e zuri SHKA ”Bajram Shabani” nga Kumanova, ndërsa të tretin SHKA “ Bresana” nga Sharri. Me plaketë të veçantë është shpërblyer këngëtari Kastriot Latifi i SHKA ”Bajram Shabani dhe solistja Mukadeze Çanga nga QK “Pjetër Gaci”. Ky festival është organizuar nga Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës dhe nën përkujdesjen e Komunës së Kaçanikut.



# Kaçaniku festoi 13 vjetorin e Ditës së Çlirimit

**11 qershor -** Komuna e Kaçanikut ka festuar 11 Qershorin – Ditën e Çlirimit. Me një varg aktivitetesh kulturore-sportive është përmbyllur ky përvjetor, ndërsa është mbajtur edhe një akademi solemne. Fjalën e rastit në këtë akademi e ka mbajtur z. Heset Loku, kryetar në detyrë i Komunës së Kaçanikut, i cili i ka uruar qytetarët për përvjetorin e 13-më të çlirimit.
Z. Loku është shprehur me këtë rast se Kaçaniku si gjithë Kosova e trojeve etnike shqiptare vijnë në ditët e kohëve të reja. Ai ka vlerësuar se dëshmorët janë ata të cilët dhanë më së shumti atdheun dhe kombin".
Për nderë të Ditës së Çlirimit janë shpërblyer kryetari deritanishëm, z. Xhabir Zharku, ndërsa për kontributin e dhënë arsimit kaçanikas është nderuar me mirënjohje edhe bashkëvendësi ynë nga Turqia, z. Eshref Lika.



# Besim Ilazi i PDK- së fiton Kaçanikun pa balotazh

**17 qershor -** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka publikuar rezultatet preliminare të zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të komunës së Kaçanikut. Sipas këtyre rezultateve, kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës, Besim Ilazi, ka fituar 52.92 për qind të votave, rezultat i cili ia mundëson PDK-së për të qeverisur me Komunën e Kaçanikut deri në fund të këtij mandati. Arritja e përqindjes në mbi gjysmën e votave të elektoratit (52.92 %) bën që të mos ketë nevojë për shkuarje në balotazh. Sipas rezultateve preliminare, i dyti në këtë garë zgjedhore ka dalë kandidati i AAK-së, z. Tahir Çaka (20 %), ndërsa i treti Shukri Luta VV-së me 16.5 % të votave.



# Të rinjtë duan ambient më të pastër në shkolla

**21 qershor** - Me moton: "Së bashku për një mjedis të pastër", është mbajtur një debat i ambientalistëve të rinj, në të cilin është diskutuar për ambientin në përgjithësi në komunën tonë. Në këtë debat është kërkuar që të ketë më shumë shporta në Bulevardin "Ismail Raka" dhe rrugë të tjera, pastaj që lumenjtë të jenë më të pastër dhe të bëhet sensibilizim më i madh tek qytetarët për mbrojtjen e mjedisit. Po ashtu të rinjtë shprehën brengën e tyre edhe për prerjen ilegale të drunjtëve. Në fund u dha një program i shkurtër artistik nga nxënësit e SHFMU " Kadri Zeka" nga Dubrava. Pas këtij debati është hapur një ekspozitë me punime për ambientin, të realizuara nga nxënësit. Pas kësaj ekspozite është organizuar edhe një koktej rasti për të pranishmit. Këto aktivitete janë zhvilluar në kuadër të projektit për rrjetëzimin e ambientalistëve, i cili ka zgjatur disa muaj dhe është financuar nga Organizata Unicef Inovations Lab nga Prishtina**.** Për kontributin e dhënë për ambientin koordinatorja e Grupit Ambientalistët e Rinj, znj. Fatlume Guri i ka falënderuar aktivistët e këtij grupi dhe mbështetjen e ofruar nga sektori për rini i Komunës së Kaçanikut.



# MAP shpërblen me mirënjohje zyrtaren e KK-së

**23 qershor** - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal e ka shpërblyer me mirënjohje zyrtaren e KK të Kaçanikut, znj. Makfirete Malsiun. Mirënjohja i është ndarë në shenjë falënderimi për punën dhe kontributin e dhënë në fushën e administratës publike për vitin 2011-2012, ndërkaq i është dhuruar për nderë të 23 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Shërbyesve Civilë. Znj. Makfire Malsiu që nga viti 2001 punon në administratën komunale, përkatësisht zyrtare në shërbimin e Kuvendit të Komunës.



# KQZ konfirmon Besim Ilazin për kryetar të Kaçanikut

**27 qershor** - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka certifikuar rezultatet e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të Komunës së Kaçanikut, të mbajtura më 17 qershor të këtij viti. Sipas rezultateve të KQZ-së, kandidati i PDK-së, z. Besim Ilazi është shpallur për kryetar të Komunës së Kaçanikut, i cili ka fituar 5.845 vota ose 52.9 % të votave. Z. Besim Ilazi ka kandiduar për herë të parë për postin e kryetarit të Kaçanikut dhe është kandidati i vetëm i cili është zgjedhur në këtë post që në raundin e parë të votimit, pa pasur nevojë të shkohet në balotazh. Në këto zgjedhje kanë garuar edhe katër kandidatë të subjekteve tjera politike: Tahir Çaka (AAK) 2.239 vota ose 20.2 %, Shukri Luta (Vetëvendosje) me 1.810 vota ose 16.38 %, Sahit Bela (LDK) 615 vota ose 5.57 % dhe Kjani Berisha (AKR) 541 vota ose 4.9 %. Në këto zgjedhje kanë dalë në votime 11.032 votues ose 35.68 % e 31.473 qytetarëve me të drejtë vote.

# KORRIK 2012

## Besim Ilazi merr detyrën e të parit të Komunës

**2 korrik** - Pas betimit të bërë në seancën solemne të Kuvendit të Komunës, z.Besim Ilazi edhe zyrtarisht e ka marrë detyrën e të parit të Komunës të Kaçanikut. Betimin solemn z.Ilazi e ka bërë para anëtarëve të Kuvendit, strukturave komunale, përfaqësuesve të Policisë së Kosovës, zyrtarëve të komunitetit të biznesit, përfaqësuesve të komunitetit fetar dhe qytetarëve tjerë. Kryetari Ilazi ka shprehur gatishmërinë e tij për angazhim të sinqertë për realizimin e projekteve në të mirë të të gjithë qytetarëve të komunës dhe për administratë funksionale e cilësore. Ai është zotuar se do të jetë i hapur për bashkëpunim konstruktiv edhe me opozitën. Ndërkaq, Zekirja Loku (PDK) dhe Shyqeri Luzha (AAK), në emër të grupeve parlamentare që përfaqësojnë në legjislativin komunal, e kanë përgëzuar kryetarin Ilazi duke i dëshiruar suksese në punë. Z.Loku dhe z.Luzha i kanë thënë kryetarit Ilazi se do ta mbështesin në angazhimet dhe punët e tij me interes për të gjithë qytetarët e komunës.



# Takimi i parë i kryetarit Ilazi - me gazetarët lokalë

**2 korrik** - Kryetari i Komunës, z. Besim Ilazi, në ditën e parë të punës është takuar me gazetarët lokalë. Ai u ka thënë gazetarëve se Komunën e Kaçanikut e presin shumë punë dhe sfida të reja. "Me një angazhim më të përkushtuar dhe në koordinim me stafin tim besoj se do t'ia dal që të bashkërendojë dhe avancojë me sukses punët dhe detyrat që na presin", ka nënvizuar z.Ilazi. I pyetur se a do të ketë ndryshime në kabinetin e tij qeverisës, z.Ilazi ka thënë se vendimin për drejtorët e drejtorive komunale do ta marrë pasi ta vlerësojë performacën e deritashme të secilit drejtor aktual.



# Kryetari takon ekipin e Zyrës së KFOR-it në Kaçanik

**3 korrik** - Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, është takuar me ushtarakët e Ekipit Ndërlidhës për Monitorim (LMT) të Zyrës së KFOR-it në Kaçanik. Ekipi amerikano-polak përfaqësohej nga togeri Workman, përgjegjës i Zyrës së LMT-së në Kaçanik dhe togerja Dymerska. Mysafirët e kanë uruar kryetarin Ilazi për inaugurimin e tij në postin e kryetarit të Komunës, ndërsa janë interesuar të dinë se si do të funksionojë Komuna pas ardhjes së tij në krye të saj. Kryetari Ilazi, pasi ka artikuluar gatishmërinë e tij për bashkëpunim të plotë dhe miqësor me KFOR-in, u ka thënë ushtarakëve Workman dhe Dymerska se ai do të angazhohet maksimalisht dhe me përgjegjësi të plotë do t'i përmbushë detyrimet dhe obligimet që e presin. "Unë do të mundohem t'i realizojë të gjitha projektet e nisura dhe ato të planifikuara për këtë periudhë kohore, ndërsa do të angazhohem për krijimin e kushteve më të mira për të gjithë qytetarët", është shprehur z.Ilazi. Ai i ka përmendur projektet infrastrukturore të cilat janë në fazën e realizimit, sikundër edhe ato që pritet të realizohen ndërkohë.

# Kreu i Komunës zotohet për mbështetje të arsimit

**5 korrik** - Arsimi është njëra nga shtyllat kryesore të shoqërisë. Kështu është shprehur kreu i Komunës, z.Besim Ilazi, në takimin e parë me drejtorët e shkollave të komunës. Ai ka artikuluar gatishmërinë e tij për bashkërendim të aktiviteteve me drejtorët, ndërsa ka thënë se do të mbështesë fuqishëm



sferën e arsimit të cilën e ka cilësuar si një nga shtyllat më të rëndësishme të shoqërisë. Qazim Ceka, drejtor i SHFMU "Gafurr Luma", në emër të Këshillit të drejtorëve, e ka uruar kryetarin Ilazi për postin, ndërsa ka premtuar angazhim më të madh për ngritjen e cilësisë në arsim. Ndërkaq, Ibush Vishi, drejtor i gjimnazit "Skënderbeu", ka thënë se me punë të përkushtuar e të përbashkët e nesërmja do të jetë më e mirë për të gjithë. Në shenjë vlerësimi dhe respekti, drejtorët ia kanë dhuruar kryetarit Ilazi një pikturë me motive të 17 Shkurtit - Ditës së Pavarësisë.

## Komuna bëhet me databazë për pronat dhe asetet

**5 korrik** - Komuna e Kaçanikut është bërë me bazë elektronike të të dhënave për pronat e paluajtshme edhe asetet e saj. Ekspertët e USAID-it ia kanë dorëzuar përgjegjësve komunalë databazën e krijuar. Databaza është fryt i punës së përbashkët të ekspertëve të Programit për Komuna Efektive e Demokratike (DEMI) të USAID-it dhe përgjegjësve komunalë. Përfaqësuesit e USAID-it dhe grupi punues komunal janë dakorduar për hapat e mëtejmë në plotësimin e të dhënave për pronat komunale dhe kompletimin e dosjeve të tyre, si një parakusht për tërheqje të investitorëve.



# Në Begracë korren hektarët e parë me grurë

**6 korrik** - Në fshatin Begracë janë korrur hektarët e parë me grurë, ndërsa rendimentet mesatare janë rreth 3.500 kilogramë për një hektar. Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë (DBZHRP), ka thënë se fushata e korrje-shirjeve ka nisur më 5 korrik. Sivjet në territorin e komunës të Kaçanikut janë mbjellur rreth 700 hektarë me grurë, ndërsa në fushatën e korrje-shirjeve janë angazhuar 16 autokombajna. Çmimi për një hektar të korrur është 100 euro. "Autokombajnerët do të subvencionohen nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me 25% të çmimit të derivateve të naftës", ka thënë drejtori Provoliu. Kryetari i Komunës, z. Besim Ilazi, për përcjellje të fushatës e ka themeluar komisionin komunal në përbërje: Zylfi Koxha (DBZHRP), Mustafë Loku (DBZHRP) dhe Ylber Shehu (Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit).



# Testin e maturës e kalojnë 55 për qind e maturantëve kaçanikas

**6 korrik** - Testin shtetëror të maturës e kanë kaluar 55% e maturantëve kaçanikas. Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë i ka publikuar rezultatet e testeve të maturës të mbajtur më 9 dhe 23 qershor. Nga gjithsej 498 maturantë të dy shkollave të mesme të komunës të Kaçanikut që iu kanë nënshtruar provimit, rezultat pozitiv kanë arritur 273 (54,82 %). Avni Krasniqi, zyrtar për arsimin e mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, ka thënë se në gjimnazin "Skënderbeu" testit iu kanë nënshtruar 319 maturantë, ndërsa e kanë kaluar 215 (67,40%). Ndërkaq, nga 179 maturantë të SHMP "Feriz Guri e Vëllezërit Çaka", rezultate pozitiv kanë arritur vetëm 58 (32,4%).

# Shefi rajonal i OSBE-së uron kryetarin për postin

**6 korrik** - Shefi rajonal i OSBE-së, z.Ulrich Biffar, e ka uruar z.Besim Ilazi për zgjedhjen e tij në postin e kryetarit të Komunës. Kryetari Ilazi e ka falënderuar z.Biffar për vizitën dhe urimin, ndërsa ka shprehur gatishmërinë për bashkëpunim edhe me OSBE-në. Gatishmërinë për bashkëpunim të ndërsjellë e ka artikuluar edhe z.Bifar.



Ndërkaq, z.Artan Binaku, zyrtar i OSBE-së, e ka njoftuar nikoqirin për rolin dhe misionin e OSBE-së. Ai ka thënë se OSBE nuk njihet në Kosovë vetëm për organizimin dhe monitorimin e zgjedhjeve, por ka një spektër të gjerë aktivitetesh. "OSBE trajton edhe çështjet e të drejtave të njeriut, demokratizimin, funksionimin e legjislativëve dhe ekzekutivëve komunalë etj.", ka thënë z.Binaku. Qendra e OSBE-së në Gjilan i mbulon 11 komunat e regjionit të Gjilanit.

## Kryetari zhvillon takimin e parë me drejtorët e drejtorive komunale

**9 korrik** - Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, e ka zhvilluar takimin e parë të rregullt me drejtorët e drejtorive komunale. Ai ka thënë se takimi është i karakterit informues. "Dëshiroj që prej jush të informohem për rrjedhat aktuale në administratën komunale dhe në fushat tjera që janë kompetencë e Komunës", u ka thënë drejtorëve z.Ilazi. Drejtorët komunalë e kanë njoftuar kryetarin për angazhimet dhe punët e kryera nga secila drejtori komunale, sikundër edhe për ato të planifikuara për t'u kryer ndërkohë.



# Komuna dhe LOGOS-i debatuan me qytetarë për ekzekutimin e buxhetit të sivjetmë

**10 korrik** - Komuna e Kaçanikut dhe projekti për qeverisje lokale dhe decentralizim-LOGOS, që financohet nga Zyra zvicerane për zhvillim dhe bashkëpunim (SCO) dhe zbatohet nga fondacioni Intercooperation, e kanë mbajtur dëgjimin e parë publik me qytetarë me temë: "Buxheti për vitin 2012 - ekzekutimi në 6-mujorin e parë dhe planifikimi i buxheteve të Komunës të Kaçanikut për vitet 2013, 2014 dhe 2015". Kryetari i komunës, z.Besim Ilazi, pasi i ka përshëndetur qytetarët e pranishëm, e ka falënderuar LOGOS-in për mbështetjen në organizimin e këtij debati dhe për krejt kontributin e dhënë në realizimin e projekteve infrastrukturore në komunën e Kaçanikut. Kryetari Ilazi ka thënë se debatet janë në funksion të përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrje. Ndërkaq, znj.Ermira Salihu, zyrtare vendëse e LOGOS-it, ka theksuar se LOGOS-i, sivjet, me bashkëfinancim të Komunës, është duke i realizuar projektet: "Ndërtimi i trotuarit në Kaçanik të Vjetër" dhe "Ndërtimi i trotuarit në fshatin Kovaçec". Në pjesën e parë të debatit është elaboruar buxheti i sivjetmë i Komunës dhe ekzekutimi i tij në 6-mujorin e parë, ndërsa në pjesën e dytë planifikimi i buxheteve për 3 vjetët në vijim. Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, ka thënë se buxheti i sivjetmë është miratuar në seancën e 29 shtatorit të vitit të kaluar në shumë prej 5.457.755 eurosh, ndërsa sipas gjendjes së 30.6.2012 ai e ka arritur lartësinë prej 5.618.111 eurosh (është rritur për 2,9% ose 160.356 euro). Gjatë periudhës raportuese ishin shpenzuar 2.068.699 euro, që paraqet një ekzekutim prej 36,8% të buxhetit vjetor. Në raport më shpenzimet e periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, shpenzimet e sivjetme kishin shënuar rritje për 222.878 euro ose 12,1%. Drejtori Vërbani ka thënë se sivjet janë planifikuar për realizim 45 projekte. Njëmbëdhjetë projekte ishin realizuar ndërkohë, 10 ishin duke u realizuar, 3 ishin në fazën e nënshkrimit të kontratave, 4 në fazën e tenderimit, kurse të tjerët ishin në fazën e përgatitjes së paramasave dhe parallogarive. Në vijim të debatit, Sevdije Frangu, anëtare e Kuvendit, ka thënë se Kaçaniku ka nevojë për kinema dhe palestër sportive. Fatlume Guri, anëtare e Këshillit për Veprim Rinor Lokal dhe koordinatore e Ambientalistëve të Rinj, e ka artikuluar nevojën e ndërtimit të objektit të ri shkollor në Kaçanik të Vjetër. Një qytetar

tjetër ka kërkuar renovimin e rrugës së dëmtuar afër objektit shkollor në ndërtim e sipër në lagjen "Dushkaja", kurse një tjetër sanimin e rrugës "Agim Bajrami". Ekrem Dullovi, drejtor i QKMF-së, ka shprehur shqetësimin e tij për buxhetin  e vogël për sektorin e shëndetësisë. Pyetjeve të qytetarëve iu kanë përgjigjur kryetari Ilazi dhe drejtori Vërbani. Në pjesën e dytë të debatit, drejtori Vërbani ka shpalosur aspekte të planifikimit të buxheteve për periudhën 2013-2015. Ai ka thënë se buxhetet për këtë periudhë parashikohet të kenë rritje mesatare vjetore prej 5,9%. Ai ka thënë se të hyrat e përgjithshme në buxhetin e parashikuar për vitin 2013 do të jetë në lartësi prej 5.611.059 eurosh, për vitin 2014 në shumë prej 5.716.994 eurosh dhe 5.771.708 euro për vitin 2015. Për periudhën e ardhshme 3-vjeçare ishin paraparë 47 projekte kapitale në shumë prej 3.501.538 eurosh, pa i llogaritur inevstimet eventuale nga donatorë të ndryshëm. Në fund të debatit, qytetarët e pranishëm janë ndarë në grupe punuese ku kanë diskutuar për investimet kapitale dhe të hyrat. Moderatorët e grupeve kanë shpalosur punën e tyre në grupe, ndërsa më pas janë votuar projektet të vlerësuara me prioritet nga qytetarët.



# Kryetari takon zyrtarë të Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë

**11 korrik** - Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, është takuar me zyrtarë të Institutit për Hulumtimin e Krimeve të Luftës në Kosovë (IHKLK). Prof.dr. Ismet Salihu, këshilltar shkencor, prof.dr. Fejaz Drançolli, këshilltar shkencor dhe mr.sc. Abedin Selimaj, bashkëpunëtor profesional, zyrtarë të IHKLK-së, i kanë thënë kryetarit se misioni i institutit është hulumtimi, mbledhja dhe sistemimi i krimeve të bëra në luftën e fundit në Kosovë gjatë periudhës 1 janar 1998-12 qershor 1999. Në këtë kontekst, është thënë se gjatë luftës së fundit në Kosovë konsiderohet të jenë kryer rreth 20 mijë dhunime, pastaj masakra të tmerrshme e krime tjera monstruoze. Z.Salihu ka thënë se IHKLK-ja mëton që të gjitha krimet e luftës t'i botojë në vëllime në gjuhët shqip, serbisht dhe anglisht. Është thënë se IHKLK-ja do t'i bashkërendojë aktivitetet me Komisionin për grumbullimin e të dhënave për krimet e luftës në komunën e Kaçanikut, i themeluar vjet nga Kuvendi i Komunës. Ndërkaq, kryetari Ilazi ka theksuar se komisioni komunal ndërkohë i ka grumbulluar të dhënat lidhur me krimet e luftës në territorin e komunës. "Ky komision aktualisht është në fazën e sistemimit të këtyre të dhënave", ka theksuar z.Ilazi. Ai i ka njoftuar mysafirët për disa nga masakrat dhe krimet tjera të kryera ndaj qytetarëve të komunës të Kaçanikut nga forcat pushtuese serbe gjatë luftës së fundit në Kosovë.



# Drejtoresha e DEMI-it zotohet për vazhdim të mbështetjes për Komunën

**12 korrik –** Programi DEMI i USAID-it edhe në të ardhmen do ta mbështesë Komunën e Kaçanikut. Kështu ka thënë znj.Ginka Kapitanova, drejtoreshë e DEMI-it (Iniciativa për Komuna Efektive dhe Demokratike) të USAID-it, në takimin njoftues me kryetarin e Komunës, z.Besim Ilazi. Të pranishëm në takim ishin edhe z.Sali Salihu, zyrtar për qeverisje lokale i DEMI-it dhe z.Xhelal Gashi, kryesues i Kuvendit të Komunës. Kapitanova e ka përgëzuar z.Ilazi për zgjedhjen e tij në krye të Komunës, ndërsa i ka dëshiruar suksese në punë. Ajo i ka thënë kryetarit se USAID-i dhe Komuna e Kaçanikut kanë krijuar një bashkëpunim të ndërsjellë të shkëlqyer që do të vazhdojë edhe në të ardhmen. "Ne kemi krijuar partneritet me 22 komuna të Kosovës, duke përfshirë edhe Kaçanikun", është shprehur znj.Kapitanova. Ajo ka nënvizuar se projekti ynë mbështet 5 fusha: forcimin e administratës, fuqizimin e kuvendeve, rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje, përmirësimin e performancës në ofrimin e shërbimeve publike dhe zhvillimin ekonomik. Ajo ka thënë se sivjet me bashkëfinancim jemi duke i realizuar dy projekteve: "Ndërtimi i parkut rinor dhe rehabilitimi i pjesës së oborrit në pallatin e kulturës 'Xheladin Kurtaj'" dhe "Shenjëzimi horizontal dhe vertikal në rrugët lokale". Kryetari Ilazi



e ka falënderuar mysafiren për vizitën dhe informacionet. Ai e ka artikuluar gatishmërinë e Komunës për bashkëpunim të mëtutjeshëm me programin DEMI të USAID-it.

## Kryetari bisedon me kreun e BIK-ut për problemet në xhami

**12 korrik** - Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, është takuar me kreun e Bashkësisë Islame të Kosovës (BIK), myftiun Naim Tërnava, ndërsa është folur edhe për problemet në xhaminë e Kaçanikut. Myftiu i Kosovës shoqërohej nga dr.Farush Rexhepi, dr.Vedat Sahiti dhe Florim Neziraj, kryetar i Këshillit të Bashkësisë Islame të Kaçanikut (KBIK). Z.Tërnava e ka uruar kryetarin Ilazi për postin dhe i ka dëshiruar suksese në punë. Duke folur për misionin e BIK-ut, ai i ka thënë kryetarit se ky institucion fetar punon konform kushtetutës së tij. Myftiu Tërnava e ka artikuluar edhe shqetësimin e tij lidhur me telashet e shkaktuara në KBI të Kaçanikut pas zgjedhjeve të fundit për postin e kryetarit të këtij këshilli. "Në xhami duhet të kthehet rendi dhe ligji", është shprehur myftiu Tërnava. Ndërkaq, kryetari i Komunës, z.Ilazi, ka thënë se Komuna nuk synon të ndërhyjë në autonominë e BIK-ut, por është e interesuar që problemet e shkaktuara të zgjidhen. "Problemet në xhami duhet të zgjidhen edhe për shkak se rrezikojnë sigurinë e përgjithshme të qytetarëve", i ka thënë mysafirit kryetari Ilazi.



# Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit lidhet me MPB/AME-në

**18 korrik** - Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi dhe z.Alush Beqiri, drejtor i Departamentit të Parandalimit në Agjencinë e Menaxhimit të Emergjencave (AME), e kanë nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit ndërmjet Komunës të Kaçanikut dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme/Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave për transferimin e pjesëtarëve të Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit (SHZSH) nga niveli komunal në nivel qendror, saktësisht në MPB/AME. Nënshkrimi i memorandumit është bërë në përputhje me Ligjin për zjarrfikës dhe shpëtim nr.04/L-049 dhe Udhëzimin administrativ nr.21/2012. Qëllimi i këtij memorandumi është shndërrimi i SHZSH-së në njësi profesionale të zjarrfikësve dhe shpëtimit në kuadër të MPB/AME-së.



# Komuna mbështet planin e MBPZHR-së për shërbimet këshilluese për fermerët

**18 korrik** - Komuna e Kaçanikut e ka mbështetur nismën e Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) për themelimin e shërbimeve këshilluese për fermerët. Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, është takuar me z.Shaban Dreshaj, shef i sektorit të Shërbimeve Këshillimore dhe z. Behlul Behluli, këshilltar i ministrit të MBPZHR-së, z.Blerand Stavileci, ndërsa është iniciuar formimi i qendrës për shërbime këshilluese për fermerët. Në takim i pranishëm ishte edhe Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë. Z. Behluli i ka thënë kryetarit Ilazi se MBPZHR-ja, bashkë me komunat e Kosovës, do të hartojë një plan për funksionimin e shërbimit këshillues. Themelimin e këtij mekanizmi këshillues, z. Dreshaj e ka arsyetuar me faktin se komunat dhe ministria kanë investuar në grante dhe subvencione për fermerët, ndërsa në jo pak raste këto mjete kanë rezultuar pa efekte të duhura për shkak të mungesës së këshillave profesionale për përfituesit. Nisma e ministrisë është mbështetur nga kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi. "Shërbimet për fermerët janë të mirëseardhura pasi ata kanë nevojë për mbështetje teknike dhe këshilluese", ka nënvizuar z.Ilazi.



# Të rinjtë urojnë kryetarin për postin

**20 korrik** - Të rinjtë e organizuar e kanë uruar kryetarin e Komunës, z.Besim Ilazi, për postin. Kryetari është takuar me krerët e Këshillit Rinor për Veprim Lokal (KRVL), z.Arlind Hysa, kryetar, znj.Mirlinda Axhami nënkryetare dhe znj.Fatlume Guri, sekretare. Të pranishëm në takim ishin edhe Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës (DAK) dhe Fatmir Çaka, koordinator për rini në DAK. Kryetari i KRVL-së, z.Hysa, e ka njoftuar kryetarin e Komunës për aktivitetet e zhvilluara dhe ato të planifikuara të këshillit. Ai ka thënë se KRVL-ja është organizatë ombrellë që përbëhet nga rreth 20 shoqata rinore. Ndërkaq, znj.Axhami e ka njoftuar kryetarin për Planin për veprim rinor lokal (2011-2013) i miratuar në Kuvendin e Komunës. Kryetari Ilazi është shprehur të jetë i kënaqur me arritjet e KRVL-së, ndërsa të rinjve u ka thënë se do ta kenë përkrahjen e vazhdueshme të Komunës edhe sa i përket mbështetjes financiare të projekteve të tyre. Krerët e KRVL-së ia kanë dhuruar kryetarit Ilazi një pikturë me motive të Kaçanikut nga viti 1910.



# Kryetari uron besimtarët për muajin e shenjtë të Ramazanit

**20 korrik** - Të nderuar bashkëqytetarë të besimit islam,
Kam kënaqësinë që në emrin tim dhe të institucionit që e përfaqësoj të ju uroj muajin e madhërishëm të Ramazanit dhe agjërim sa më të lehtë. Muaji i shenjtë i Ramazanit uroj të jetë një muaj i mbarë dhe i qetë për të gjithë ju dhe familjet tuaja. Në këto ditë të gjitha lutjet i drejtohen Zotit për të mirën e kësaj bote, për të jetuar të lirë, në paqe e dashuri me njëri-tjetrin. Edhe me këtë rast të mendojmë e të kujtojmë ata që ranë e u sakrifikuan për të ardhur ditë më të mira në vendin tonë, ata që derdhen gjakun në themelet e shtetit te ri të Kosovës që populli i ynë të gëzojë lirinë dhe pavarësinë e vendit.

Besim Ilazi,
Kryetar i Komunës

# Iniciohet hartimi i Planit lokal të trashëgimisë kulturore

**24 korrik** - Komuna e Kaçanikut, në bashkëpunim me fondacionin suedez Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), e ka iniciuar hartimin e Planit lokal të trashëgimisë kulturore (PLTK). Informacionet lidhur me hartimin e PLTK-së janë shpalosur gjatë takimit të kryetarit të Komunës, z.Besim Ilazi, me z.Enes



Toska, menaxher në CHwB dhe z. Mirian Bllaci, ekspert, e në të cilin të pranishëm kanë qenë edhe Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës dhe Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Zyrtarët e CHwB-së i kanë thënë kryetarit se Komuna e Kaçanikut është njëra nga 6 komunat e përzgjedhura që për periudhën 4-vjeçare (2012-2015), përmes një qasjeje të re, të identifikojë resurset e trashëgimisë kulturore dhe natyrore që mund të shërbejnë si bazë për zhvillimin socio ekonomik. Z.Toska ka thënë se për hartimin e Planit lokal të trashëgimisë kulturore do të formohen forumet lokale (grupe pune), ndërsa CHwB-ja do të sigurojë mbështetje organizative dhe profesionale. Kryetari Ilazi, pasi ka artikuluar gatishmërinë për bashkëpunim me CHwB-në, ka thënë se Komuna e Kaçanikut ka mjaft objekte kulturore me vlerë. "Ne do të koordinojmë veprimet për ruajtjen dhe rehabilitimin e këtyre objekteve të trashëgimisë kulturore", është shprehur z.Ilazi.

## Hartohet Projektrregullorja e administratës komunale

**26 korrik** - Programi Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI) i USAID-it dhe zyrtarë komunalë e kanë promovuar Projektrregulloren për organizmin e brendshëm të administratës komunale. Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, e ka mbështetur hartimin e projektregullores. Ai e ka falënderuar DEMI-n për bashkëpunimin e deritanishëm me Komunën e Kaçanikut, ndërsa është zotuar për thellimin e këtij bashkëpunimi në të ardhmen. Draftin e projektrregullores e ka shpalosur z. Halit Kadriu, ekspert i DEMI-it. Ai ka thënë se Rregullorja për organizimin e brendshëm të administratës komunale bazohet në nenin 12.2



të Ligjit të vetëqeverisjes lokale dhe nenit 33.1, pika 1, të Statutit të Komunës të Kaçanikut. Në projektrregullore është përfshirë organizimi administrativ nëpërmjet drejtorive komunale dhe sektorëve, kurse janë saktësuar kompetencat dhe përgjegjësitë e secilës drejtori. Fadil Guri, shef i personelit të administratës komunale, ka thënë se Komuna e ka një dokument për sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin civil komunal.

## Përurohet ambulanca në Ivajë

**26 korrik** - Në fshatin Ivajë është bërë përurimi i ambulancës, ndërsa shiritin përurues e kanë prerë z.Besim Ilazi, kryetar i Komunës, dhe z.Halil Luta, mërgimtar ivajas që e ka financuar ndërtimin e këtij objekti. Kryetari Ilazi, pasi i ka përgëzuar banorët e Ivajës për ambulancën e re, u ka thënë atyre se ndërtimi i këtij objekti shëndetësor në fshatin tuaj ishte nevojë e kahershme dhe sot u bë realitet falë bashkëfshatarit tuaj, z.Halil Luta. "Tashti e tutje disa nga shërbimet primare shëndetësore do t'i keni më afër", u ka thënë të pranishmëve kryetari Ilazi. Ndërkaq, z.Nexhadi Luta, administrator i fshatit, e ka falënderuar donatorin edhe në emër të bashkëfshatarëve. Administratori Luta e ka vlerësuar lartë aktin human të mërgimtarit Halil Luta. Drejtori i QKMF-së, Ekrem Dullovi, ka thënë se në këtë objekt një infermiere do të punojë çdo ditë pune, ndërsa mjeku një ditë në javë. Kryetari Ilazi e ka nderuar me mirënjohje donatorin. Z.Halil Luta është nderuar me mirënjohje edhe nga komuniteti i fshatit. Është thënë se për ndërtimin e ambulancës janë shpenzuar më se 20 mijë euro, ndërsa krejt mjetet e investuara i ka dhuruar z.Halil Luta.



# Kuvendi shfuqizon vendimin për kufizimin e shërbimeve për qytetarët

**31 korrik** - Kuvendi i Komunës e ka shfuqizuar vendimin për kufizimin e shërbimeve për qytetarët me pagesën e faturave të ujit dhe mbeturinave. Vendimi për kufizimin e shërbimeve qe marrë në seancën e mbajtur më 4.4.2012, ndërsa më vonë Ministria e Administratës dhe Pushtetit Lokal pati kërkuar nga KK-ja që të rishqyrtojë këtë vendim. Anëtarët e Kuvendit e kanë shqyrtuar edhe Raportin 6-mujor të buxhetit (1 janar-30 qershor). Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, ka thënë se buxheti i sivjetmë është miratuar në shtator të vitit të kaluar në shumë prej 5.457.755 eurosh, ndërsa sipas gjendjes së 30.6.2012 buxheti aktual ka arritur shumën prej 5.618.111 eurosh (është rritur 2,9% ose për 160.356 euro). Buxheti i shpenzuar për periudhën raportuese është 2.068.699 euro, që paraqet një ekzekutim prej 36,8%. Në raport më shpenzimet e periudhës së njëjtë të vitit të kaluar, ato të sivjetmet kanë shënuar rritje për 12,1% ose për 222.878 euro. Legjislativi komunal e ka miratuar edhe Kornizën afatmesme të shpenzimeve për periudhën 2013-2015. Drejtori Vërbani ka thënë se buxhetet vjetore për këtë periudhë parashikohet të rriten mesatarisht për 5,9% (6,1% nga grantet qeveritare dhe 3,9% nga të hyrat vetjake). Buxheti i 2013-s është paraparë të jetë 5.611.059 euro, ai i 2014-s në lartësi prej 5.716.994 eurosh dhe 5.771.708 euro buxheti i 2015-s. Anëtarët e Kuvendit e kanë miratuar edhe Propozimvendimin për caktimin e tarifave, shërbi-meve dhe produkteve kadastrale të ofruara nga Zyra kadastrale dhe kompanitë gjeodete, ndërsa e kanë shtyrë për seancën e radhës Propozimvendimin për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale në komunën e Kaçanikut.



## GUSHT 2012

# CDI-ja premton investime të reja në komunën e Kaçanikut

**2 gusht** - Organizata CDI (Community Development Initiatives), që financohet nga Qeveria zvicerane, ka artikuluar gatishmërinë për vazhdimin e investimeve në komunën e Kaçanikut. Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, është takuar me drejtorin e CDI-së, z.Astrit Vokshi, dhe z.Lavdim Osmani, inxhinier. Të pranishëm kanë qenë edhe znj.Hajrije Morina, konsulente për ujëra e CDI-së dhe Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Kryetari Ilazi dhe drejtori Vokshi kanë biseduar për mundësinë e vazhdimit të bashkëpunimit ndërmjet Komunës dhe CDI-së. Z.Vokshi ka thënë se CDI-ja ka implementuar projekte për ujësjellës dhe ujëra të zeza nga viti 2005. Më 2008 qe nënshkruar marrëveshja për ndërtimin e sistemit të ujësjellësit për fshatrat Kaçanik i Vjetër dhe Begracë. Projekti qe bashkëfinancuar nga CDI-ja, Komuna, komunitetet e dy fshatrave dhe kompania rajonale e ujit dhe kanalizimit "Bifurkacioni". Drejtori Vokshi ka artikuluar gatishmërinë për investime të reja komunën e Kaçanikut, ndërsa ka rikujtuar se CDI-ja investon vetëm në kompanitë rajonale të ujit. Ndërkaq, drejtori Troni ka folur për gjendjen e ujësjellësve në territorin e komunës, me fokus gjendjen e ujësjellësit të qytetit dhe të fshatrave Doganaj, Dubravë, Rekë, Nikaj dhe Elezaj. Janë vlerësuar nevoja të ngutshme investimet e reja në rrjete ujësjellësish dhe në projekte për trajtim ujërash të zeza.



# LOGOS-i do të bashkëpunojë me Komunën edhe më 2013

**2 gusht** - Projekti për qeverisje lokale dhe decentralizim-LOGOS, që financohet nga Qeveria zvicerane, do të bashkëpunojë me Komunën e Kaçanikut edhe më 2013. Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, e ka zhvilluar një takim pune me z.Norbert Pijls, koordinator i LOGOS-it dhe znj.Ermira Salihu, zyrtare vendëse, ndërsa është biseduar për bashkëpunimin e deritashëm dhe mundësitë për vazhdimin e partneritet Komunë-LOGOS. Z.Pijls i ka thënë kryetarit Ilazi se Kaçaniku është njëra nga komunat partnere më të mira. Ai e ka lavdëruar stafin komunal për punë efikase dhe të përgjegjshme. "Projekti LOGOS do të vazhdojë punët me komunat partnere edhe më 2013. Tani presim vetëm të formalizohen disa procedura, ndërsa shpresojmë se mot do të bashkëpunojmë edhe me Komunën e Kaçanikut", ka thënë z.Pijls. Ai ka shtuar se më 2013 LOGOS-i do të financojë një projekt në vlerë 50 mijë euro. Kryetari Ilazi e ka falënderuar z.Pijls dhe LOGOS-in për bashkëpunimin e deritashëm, kurse e ka mirëpritur vazhdimin e partneritetit edhe për vitin vijues. Kryetari Ilazi dhe z.Pijls kanë biseduar edhe për realizimin e dy projekteve infrastrukturore të cilat janë planifikuar të implementohen sivjet: "Ndërtimi i trotuarit në Kaçanik të Vjetër" me vlerë 70 mijë euro (50 mijë euro i investon LOGOS-i, 20 mijë euro Komuna) dhe "Ndërtimi i trotuarit për këmbësorë Bob – Kovaçec" me vlerë 92.846 euro (50 mijë euro i investon LOGOS-i, 42.846 euro Komuna). Në takim është biseduar edhe për të hyrat



vetjake komunale dhe mundësitë e rritjes së tyre, pastaj për hartimin e Planit rregullues urban, buxhetin e ndjeshëm gjinor etj.

## Nisin punët në projektin e pastrimit që financohet nga Banka Botërore

**3 gusht** - Kanë nisur punët për realizimin e projektit për pastrimin e përrenjve dhe largimin e mbeturinave nga deponitë ilegale. Për realizimin e këtij projekti janë angazhuar 45 punëtorë nga Zyra Komunale e Punësimit apo 80% e të kontraktuarve, ndërsa 20% e punëtorëve janë të kompanisë që e ka fituar tenderin për kryerjen e punëve. Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, ka thënë se projekti i sipërpërmendur është kontraktuar në shumë prej 61.958 eurosh. Ai ka thënë se punëtorët e angazhuar do të marrin paga mujore në lartësi prej 220 eurosh. "Fillimisht do të bëhet pastrimi i shtratit të lumit Neredime e pastaj edhe shtretërit e përrenjve dhe largimi i mbeturinave nga deponitë ilegale", ka sqaruar drejtori Ceka. Mjetet për projektin janë akorduar nga Banka Botërore, ndërsa ai është pjesë e Programit të Punëve Publike të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale. Projekti është në funksion të gjenerimit të punësimit dhe zbutjes së varfërisë dhe në përputhje me Strategjinë e Punësimit 2010-2012 të MPMS-së. Kohëzgjatja e projektit është 4 muaj.



# Themelohet Komisioni komunal për riintegrimin e të riatdhesuarve

**6 gusht** - Ekzekutivi i Komunës ka marrë vendim për themelimin e Komisionit komunal për riintegrimin në shoqëri të personave të riatdhesuar. Është thënë se komisioni themelohet në përputhje me Rregulloren nr.10/2012 për menaxhimin e programit, organet kompetente, procedurat dhe kriteret e përfitimit për riintegrim të personave të riatdhesuar. Hidajete Guri, shefe e Zyrës për Integrime Evropiane, Kthim dhe Komunitete, ka thënë se komisioni e ka për detyrë të shqyrtojë dhe marrë vendime lidhur me kërkesat e personave të riatdhesuar.

# Ndërpriten punët për ndërtimin e objekteve pa leje te Livadhet e Shtrazës

**9 gusht** - Janë ndërprerë të gjitha punët për ndërtimin e objekteve pa leje në zonën turistike te Livadhet e Shtrazës. Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, i shoqëruar nga inspektorët komunalë, gjatë vizitës në zonën e sipërpërmendur turistike ka urdhëruar ndërprerjen e të gjitha punëve për ndërtimin e objekteve derisa të hartohet Plani rregullues për Livadhet e Shtrazës. Drejtori Troni ka thënë se jemi të vendosur që të mos lejojmë asnjë ndërtim pa leje. Ai është shprehur se ndaj pronarëve të cilët nuk e respektojnë vendimin do të merren masa ndëshkuese, përfshirë edhe rrënimin e objekteve të tyre.



# Homazhe dhe kurora lulesh për dëshmorët

**10 gusht** - Aktivitetet për nder të 10 Gushtit-Ditës së Dëshmorëve të brigadës 162"Agim Bajrami" të UÇK-së kanë filluar me homazhe dhe vendosje kurora lulesh te memoriali i Varrezave të Dëshmorëve. Më pas, kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, dhe bashkëpunëtorët e tij, kurora lulesh kanë vendosur edhe te memoriali i komandantit Agim Bajrami dhe dy bashkëluftëtarëve të tij, Besnik Begunca e Xheladin Kurtaj, në fshatin Gabrricë. Kryetari Ilazi dhe shoqëruesit e tij kurora lulesh kanë vendosur edhe te shtatorja e komandantit Agim Bajrami në parkun e qytetit. Kurora lulesh ka vendosur edhe delegacioni i OVL të UÇK-së, sikundër edhe bashkëluftëtarë të dëshmorëve dhe qytetarë.



# Kryetari viziton nënat e dëshmorëve të rënë më 10 gusht

**10 gusht** - Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, i shoqëruar nga bashkëpunëtorë të tij dhe kryetari i Shoqatës së Invalidëve të Luftës, Menduh Krasniqi, e ka vizituar nënën e komandantit Agim Bajrami dhe nënat e dëshmorëve Besnik

Begunca dhe Xheladin Kurtaj, të rënë më 10 gusht 1998. Zonja Elife Bajrami, nëna e Agim Bajramit, i ka thënë kryetarit Ilazi se ndihem shumë e kënaqur kur ju shoh ju që na nderoni e respektoni ne, nënave të dëshmorëve. "Djali im Agimi dhe të gjithë dëshmorët tjerë më shumë e deshën lirinë se jetën e tyre", është shprehur zonja Elife. Edhe zonja Emine, nëna e dëshmorit Xheladin Kurtaj, dhe zonja Hisnije, nëna e dëshmorit Besnik Begunca, i kanë thënë kryetarit se ndihen krenare për veprat heroike të djemve të tyre. Ndërkaq, kryetari Ilazi, pasi e ka vlerësuar lart heroizmin dhe sakrificën e dëshmorëve të rënë më 10 gusht, u ka thënë nënave se liria fitohet vetëm me pushkë, ashtu siç luftuan Agimi, Besniku e Xheladini. Komandanti Agim Bajrami, Besnik Begunca e Xheladin Kurtaj kanë rënë heroikisht në një përleshje të pabarabartë me forcat pushtuese serbe më 10 gusht të vitit 1998 në fshatin Gabrricë.



## Në Ditën e Dëshmorëve përurohen dy rrugë të reja

**10 gusht** - Dita e Dëshmorëve është shënuar edhe me përurim projektesh të finalizuara. Është përuruar rruga e re në lagjet "Kolshi" e "Murseli" të fshatin Doganaj dhe rruga e "Lagjes së Re" në Kaçanik. Kryetari i Komunës, z.Besim

Ilazi, bashkë me z.Hisni Kolshi, baba i dëshmorit Kemal Kolshi dhe z.Haziz Xhokli, baba i dëshmorit Ramadan Xhokli, e kanë prerë shiritin përurues të rrugës së re në lagjet "Kolshi" e "Murseli" të fshatit Doganaj. Kryetari Ilazi, pasi i ka përgëzuar banorët e dy lagjeve për rrugën e re, u ka thënë të pranishmëve se jo rastësisht e kemi zgjedhur këtë ditë për përurimin e rrugës tuaj. "Dëshmorët janë ata që sollën lirinë dhe pavarësinë e vendit, prandaj ne sot jetojmë e punojmë të lirë. Ne po mundohemi që çdo ditë e më tepër të punojmë në të mirë të qytetarëve të komunës sonë duke e rritur mirëqenien e përgjithshme. Me realizimin e këtij projekti tani janë krijuar kushte më të mira për të gjithë ju", ka thënë kryetari Ilazi. Rruga e asfaltuar është 550 metra e gjatë, ndërsa ajo e shtruar me pllaka betoni është 1.000 metra e gjatë. Është instaluar edhe rrjeti i kanalizimit në gjatësi prej 1.100 metrash dhe është ndërtuar shtrati i përroit në gjatësi prej 434 metrash. Për realizimin e këtij projekti janë shpenzuar gjithsej 164 mijë euro të buxhetit komunal. Më vonë gjatë ditës është bërë edhe përurimi i rrugës së asfaltuar në "Lagjen e Re". Shiritin përurues e kanë prerë kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, bashkë me z.Azem Krivanjeva, baba i dëshmorit Raif Krivanjeva, z.Misim Sopa, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë e Mirëqenies Sociale, dhe z.Afrim Bela, udhëheqës i lagjes. Rruga e asfaltuar është e gjatë 304 metra, e gjerë 3 metra, ndërsa asfalti është shtruar në trashësi prej 7 centimetrash. Është instaluar edhe rrjeti i kanalizimit fekal në gjatësi prej 192 metrash. Segmenti i asfaltuar nis nga rruga "Drenica" dhe përfundon te lapidari i 9 dëshmorëve dhe 8 civilëve të rënë më 9 prill të vitit 1999. Mjetet për realizimin e këtij projekti janë siguruar nga fondi për rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve lokale.



# Akademia përkujtimore përmbyll aktivitetet për Ditën e Dëshmorëve

**10 gusht** - Aktivitetet për shënimin e 10 Gushtit-Ditës së Dëshmorëve të komunës së Kaçanikut janë përmbyllur me akademi përkujtimore në pallatin e kulturës "Xheladin Kurtaj". Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, në fjalën e tij të rastit ka thënë se nga viti 1912 shqiptarët e Kosovës asnjëherë nuk kanë pushuar së luftuar për liri e pavarësi. "Pas vitit 1990 populli shqiptar ishte gjetur në udhëkryq: të pajtohej me robërinë apo të fillonte luftën e armatosur. Ishin trimat që u mobilizuan dhe e organizuan luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ishin djemtë tanë si Agimi, Besniku, Xheladini dhe shokët e tyre, që ia kthyen pushkën armikut deri në çlirimin e vendit", ka thënë kryetari Ilazi. Ndërsa, duke folur për angazhimet e pushtetit lokal, ai ka thënë se ne sot po mundohemi të krijojmë një jetë sa më të mirë për të gjithë qytetarët. "Ju ftoj që në këtë Ditë të Dëshmorëve të jemi të gjithë së bashku. Dëshmorët janë të popullit, ata kishin vetëm një ideal: çlirimin e atdheut, prandaj edhe t'i kujtojmë të gjithë së bashku", është shprehur në fund z.Ilazi. Fjala i është dhënë edhe kolonelit Hajrush Kurtaj, ish-zëvendëskomandant i brigadës 162"Agim Bajrami". Ai ka thënë se UÇK-ja mori mbi vete misionin e ndryshimit përfundimtar të historisë së Kosovës dhe historisë kombëtare shqiptare. "UÇK-ja e udhëhequr nga komandanti legjendar Adem Jashari ishte arritja më kulmore në historinë tonë e cila i ndërroi rrjedhat e historisë. UÇK-ja i dha Kosovës emër, kurajo, imazh, respekt dhe miq të shumtë dhe vuri në themelet e



lirisë së saj gjakun e mijëra dëshmorëve" ka theksuar z.Kurtaj. Në vijim ai ka thënë se brigada jonë në luftën çlirimtare i ka dhënë 94 dëshmorë, përfshirë edhe dy komandantë të brigadës, Agim Bajrami e Qamil Ilazi, dhe veprimtarin e çështjes kombëtare, Ismail Raka. Në fund të fjalës së tij, z.Kurtaj ka thënë se për popullin dhe shtetin e Kosovës dëshmorët do të mbesin vlera më e shenjtë që qëndron në themelet e lirisë sonë. Të gjitha aktivitetet për shënimin e 10 Gushtit-Ditës së Dëshmorëve të komunës së Kaçanikut janë mbajtur në patronazhin e kryetarit të Komunës, z.Besim Ilazi.

## Pinjollët e patriotëve të shquar qëndrojnë për pak çaste në Kaçanik

**12 gusht** - Pinjollët e familjeve patriotike të Hasan Prishtinës, Isa Boletinit, Idriz Seferit dhe të tjerave, në marshimin e tyre drejt Shkupit, për pak çaste kanë qëndruar edhe në Kaçanik. Z.Mehmet Prishtina, stërnip i Hasan Prishtinës, i printe eskortës e cila është pritur nga kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi. Kryetari Ilazi dhe pjesëmarrësit e marshit kanë bërë homazhe dhe kanë vendosur kurora lulesh te shtatorja e komandantit të UÇK-së për komunën e Kaçanikut, Agim Bajrami, në parkun e qytetit. Marshit për në Shkup iu ka bashkëngjitur edhe kryetari Ilazi me disa bashkëpunëtorë për të marrë pjesë në shënimin e 100-vjetorit të çlirimit të këtij qyteti nga ushtria osmane. Më 12 gusht



1912 Shkupi qe çliruar nga forcat shqiptare të udhëhequra nga Isa Boletini, Bajram Curri, Idriz Seferi dhe figura të tjera të shquara.

## Komuna dhe KPMM-ja vendosin të firmosin marrëveshje bashkëpunimi

**13 gusht** - Komuna dhe Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale (KPMM) janë pajtuar që të firmosin një marrëveshje bashkëpunimi. Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, është takuar z.Ramiz Krasniqi, anëtar i Bordit të KPMM-së dhe z.Aqif Axhami, udhëheqës i Departamentit të Gjeodezisë. I pranishëm në takim ishte edhe Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës e Mbrojtjes së Mjedisit, ndërsa është folur për nevojën e avancimit të bashkëpunimit Komunë-KPMM. Në këtë kontekst, bashkëbiseduesit janë pajtuar për nënshkrimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi. Në takim është folur edhe për menaxhim më të mirë të guroreve dhe koordinim të dyanshëm të aktiviteteve.



# Zbukurohen me piktura muret e jashtme të Pallatit të Kulturës

**14 gusht** - Janë zbukuruar me piktura disa mure të jashtme të pallatit të kulturës "Xheladin Kurtaj". Pikturat i kanë punuar piktorët e rinj të Këshillit Rinor të Veprimit Lokal dhe profesorët e artit figurativ, Arif Mulaku e Zeqir Xhokli. Aktiviteti i realizuar është pjesë e projektit: "Ndërtimi i parkut rinor dhe rehabilitimi i oborrit të pallatit të kulturës 'Xheladin Kurtaj'". Konform projektit, më herët është bërë mbjellja e barit, luleve sezonale dhe e 20 pishave; ngjyrosja e fasadës në pjesën perëndimore të objektit; oborri është shtruar me pllaka guri; shkallët hyrëse janë shtruar me pllaka graniti dhe hyrja anësore me pllaka betoni. Projekti me vlerë 45 mijë e 514 euro është bashkëfinancuar nga projekti Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI) i USAID-it dhe Komuna e Kaçanikut. DEMI i ka investuar 35.303 euro, kurse Komuna 10.211 euro.



# Remzi Elezi emërohet nënkryetar i Komunës

**14 gusht** - Z.Remzi Elezi është emëruar në postin e nënkryetarit të Komunës. Emërimi i z.Elezi është bërë nga kreu i Komunës, z.Besim Ilazi, në përputhje me Ligjin e vetëqeverisjes lokale nr.03/L-40 dhe me Statutin e Komunës të Kaçanikut. Remzi Elezi (1962), nga fshati Sllatinë, ish-i burgosur politik, pas mbarimit të luftës në Kosovës ka qenë bashkëthemelues në nivel qendror i Partisë për Progres Demokratik të Kosovës, ndërsa më vonë edhe themelues dhe kryetar i parë i Degës në Kaçanik të Partisë Demokratike të Kosovës. Emërimi i z.Elezi ka ardhur pas dorëheqjes së z.Heset Loku, nënkryetar i deritashëm i Komunës. Z.Loku ka dhënë dorëheqje pasi është emëruar drejtor i Qendrës Korrektuese për Femra dhe të Mitur në Lipjan.



# QKRB-ja nis me lëshimin edhe të 3 certifikatave

**16 gusht** - Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve (QKRB) ka nisur të lëshojë edhe certifikata të numrit fiskal, certifikata të TVSH-së dhe certifikata të doganave. Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, ka rikujtuar se deri tashti në këtë qendër janë lëshuar certifikatat e bizneseve (për bizneset e regjistruara në Komunën e Kaçanikut dhe në atë të Hanit Elezit). Drejtori Vërbani ka theksuar se pas bartjes së kompetencave shtesë nga niveli qendror në atë lokal janë krijuar lehtësira për regjistrim biznesesh të cilat kanë rezultuar me përfitime për palët në kohë dhe në koston e shpenzimeve. "Shkurtimi i procedurave dhe themelimi i bizneseve pa pagesë ka efekt pozitiv sa i përket motivimit të qytetarëve për themelimin e bizneseve të reja", ka thënë drejtori Vërbani. Nasrullah Shehu, udhëheqës i QKRB-së, ka thënë se kjo qendër është përuruar më 2 qershor të vitit 2011. "Deri sot janë regjistruar 175 biznese të reja, janë bërë 84 ndryshime në biznese dhe janë evidencuar 13 shuarje biznesesh", ka thënë Shehu.

# DAK-ja shpalos aktivitetet për fillim të mbarë të vitit të ri shkollor

**17 gusht** - Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës (DAK) i ka shpalosur aktivitetet e planifikuara për fillim të mbarë të vitit të ri shkollor 2012/2013. Shpalosjen e aktiviteteve e ka bërë Azem Guri, drejtor i DAK-ut, në takim me drejtorët e shkollave. Të pranishëm kanë qenë edhe kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, dhe nënkryetari, z.Remzi Elezi. Kryetari Ilazi dhe nënkryetari Elezi i kanë uruar drejtorët e shkollave për fillimin e vitit të ri shkollor duke i nxitur ata



për suksese të reja. Kryetari Ilazi u ka thënë drejtorëve të shkollave dhe zyrtarëve të DAK-ut që të jenë shumë të vëmendshëm në përzgjedhjen e kandidatëve që kanë aplikuar për vendet e lira të punës në arsim. "Të respektohen me përpikëri kriteret për përzgjedhjen e kuadrit arsimor", ka theksuar kryetari Ilazi. Në këtë kontekst, drejtori Guri ka thënë se për 51 vende të lira kanë aplikuar 250 kandidatë. Në takim është folur edhe gjendjen sa i përket inventarit shkollor në disa shkolla, për pajisjen me libra shkollorë, me material pedagogjik, me lëndë djegëse etj.

## Kryetari uron besimtarët për Bajramin e Madh

**18 gusht** - Qytetarë të nderuar të besimit islam,
Kam kënaqësinë që në emrin tim dhe të administratës komunale t'ju uroj Festën e Fitër Bajramit dhe bashkë me ju të ndajë gëzimin që sjell kjo festë e madhërishme. Uroj që ditët e festës t'i kaloni sa më mirë, në mesin e më të dashurve tuaj. Fitër Bajrami është festë e paqes, solidaritetit dhe harmonisë për të gjithë besimtarët myslimanë dhe vjen pas shumë ditësh të agjërimit, përkushtimit dhe falënderimit ndaj Krijuesit, duke ngjallë midis njerëzve ndjenjën fisnike të mbështetjes dhe solidaritetit. Edhe me këtë rast të kujtojmë të gjithë ata që u sakrifikuan për lirinë e Kosovës, të gjithë dëshmorët, ata që dhanë jetët e tyre që ne të festojmë sot të lirë. Në veçanti uroj familjet e dëshmorëve, që edhe në këto ditë feste të ndihen krenare për gjakun e derdhur prej më të dashurve të tyre që e solli lirinë dhe pavarësinë e Kosovës.

Sinqerisht,
Kryetari i Komunës
Besim Ilazi

# Shtyhet afati për rrënimin e lokaleve me leje të përkohshme

**30 gusht** - Ekzekutivi i Komunës ka marrë vendim për shtyrjen e afatit për rrënimin e 35 lokaleve afariste me leje të përkohshme. Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, ka thënë se Komuna aktualisht nuk planifikon investime në dy lokacionet ku gjenden lokalet, prandaj shtyrja e afatit është vendim i drejtë. Vendimi për rrënimin e objekteve qe marrë më 27.4.2012, ndërsa pronarët qenë urdhëruar t'i largojnë objektet e tyre deri më 4 qershor. Ndërkohë, më 27 maj, Ekzekutivi i Komunës e pati shtyrë afatin e largimit të lokaleve deri më 31 gusht. Lokalet e përfshira në vendimin për rrënim gjenden në rrugën "Emin Duraku", në afërsi të shkollës fillore, dhe në rrugën "Agim Bajrami" (në qendër të qytetit). Vendimi për heqjen e objekteve është marrë në përputhje me nenin 80 të Statutit të Komunës dhe në përputhje me Planin zhvillimor urban që parasheh lirimin e hapësirave publike për qarkullim të papenguar.

# SHTATOR 2012

## Kryetari uron nxënësit dhe mësimdhënësit për vitin e ri shkollor

**1 shtator** - Të dashur nxënës, të nderuar arsimtarë dhe prindër, Kam nderin dhe kënaqësinë që në emrin tim dhe të qytetarëve të komunës së Kaçanikut të ju uroj fillimin e vitit të ri shkollor 2012/2013**.** Një armatë e tërë e nxënësve po u kthehen bankave shkollore për ta vazhduar betejën e madhe për thellimin e dijes dhe nxënien e njohurive të reja në institucionet tona arsimore. Mësuesit meritojnë mirënjohje për punën e palodhshme që po bëjnë, për misionin e tyre fisnik për edukimin dhe arsimimin e brezave të rinj. Jam i bindur se me përkrahjen e institucioneve qendrore do t'i jetësojmë synimet tona për ngritjen e mëtejme të sistemit arsimor. Në veçanti i uroj vogëlushët dhe vogëlushet të cilët sivjet për herë të parë do të fillojnë të mësojnë ABC-në në bankat shkollore. Uroj që edhe ky vit shkollor të jetë i mbarë dhe i sukseseve të përbashkëta.

Besim Ilazi,
Kryetar i Komunës

## Kreu i Komunës viziton dy shkolla në ditën e parë të vitit të ri shkollor

**3 shtator** - Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, e ka ndarë gëzimin dhe emocionet e ditës së parë të vitit të ri shkollor më nxënësit dhe mësimdhënësit e dy shkollave, ndërsa shoqërohej nga Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës (DAK), dhe Hafet Ceka, zyrtar i DAK-ut. Kryetari Ilazi i ka takuar nxënësit dhe mësimdhënësit e gjimnazit "Skënderbeu" dhe ata të shkollës fillore "Kadri Zeka" të Dubravës. Drejtori i "Skënderbeut", z.Ibush Vishi, e ka njoftuar kryetarin Ilazi për përgatitjet

teknike dhe fillimin e procesit mësimor. Edhe drejtori i "Kadri Zekës", z.Ekrem Vishi, i ka thënë kryetarit se të gjitha përgatitjet për fillim të mbarë të vitit shkollor 2012/2013 janë bërë me kohë. Procesi mësimor në komunën e Kaçanikut zhvillohet në 4 nivele arsimore (parafillor, fillor, i mesëm i ulët dhe i mesëm i lartë), në gjithsej 12 shkolla nëntëvjeçare dhe 15 paralele të ndara fizike, pastaj në dy shkolla të mesme dhe në një qendër të edukimit parafillor. Drejtori Guri ka thënë se numri i përgjithshëm i nxënësve këtë vit shkollor është rreth 8 mijë, prej tyre rreth 6.200 do t'i ndjekin mësimet në ciklin parafillor e fillor dhe afro 1.700 në atë të mesëm. Sivjet, për herë të parë, 612 vogëlushë do të nisin betejën për mësimin e ABC-së.




# Komunës i ofrohet mundësia e huamarrjes për realizim projektesh

**5 shtator** - Komunës së Kaçanikut i është ofruar mundësia e huamarrjes së mjeteve për realizim projektesh të saja. Firma KPMG Albania Sh.p.k e ka nisur një studim për të vlerësuar mundësitë e financimit të projekteve infrastrukturore nëpërmjet huadhënies së mjeteve nga projekti që

financohet nga disa qeveri evropiane, pastaj nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe banka gjermane Kreditanstalt fur Wiereraufbau (KfW). Znj.Annie Gjollma, menaxhere e KPMG Albania Sh.p.k, e cila shoqërohej nga znj.Silvana Syziu, konsulente, dhe z.Remzi Uka, zyrtar, në takim me kryetarin e Komunës, z.Besim Ilazi, dhe nënkryetarin, z.Remzi Elezi, ka thënë se shuma e financimit për çdo projekt është parashikuar të jetë nga 100 mijë euro e deri në 5 milionë euro. Drejtorët Fikri Vërbani dhe Bekim Troni, të cilët ishin të pranishëm në takim, e kanë njoftuar menaxheren Gjollma me kapacitetet e Komunës, nevojat për investime në infrastrukturën fizike dhe kapacitetet buxhetore nga të hyrat vetjake komunale. Është thënë se në fazat e mëvonshme do të diskutohen çështje konkrete lidhur me realizimin e projekteve në Komunën e Kaçanikut nëpërmjet huamarrjes.



## "Caritasi" i Luksemburgut zotohet për vazhdim të partneritetit me Kaçanikun

**10 shtator** - "Caritasi" i Luksemburgut do ta vazhdojë partneritetin me Komunën e Kaçanikut edhe në të ardhmen. Kështu është thënë në takimin që kreu i Komunës, z.Besim Ilazi, e ka pasur me shefin në largim të Zyrës së

"Caritasit" të Luksemburgut në Kosovë, z.Gerhard Fischer. Të pranishëm kanë qenë edhe nënkryetari i Komunës, z.Remzi Elezi dhe Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës e Mbrojtjes së Mjedisit. Kryetari Ilazi e ka falënderuar z.Fisher për angazhimin e tij sa i përket partneritetit me Komunën e Kaçanikut, kurse Qeverinë e Luksemburgut e ka falënderuar për bashkëfinancimin projektesh jo vetëm në komunën tonë. Kryetari Ilazi ka deklaruar se kemi shumë nevojë për investime në projekte me interes për qytetarët. Ndërkaq, z.Fischer ka thënë të jetë i kënaqur me bashkëpunimin e ndërsjellë dhe sukseset e përbashkëta. Ai e ka njoftuar kryetarin me pasardhësin e tij, z.Ardian Hasanaj. Shefi i ri, z.Hasanaj, ka thënë se Komuna e Kaçanikut është njëra nga 6 komunat partnere të Zyrës në Kosovë të "Caritasit" të Luksmeburgut. Ai ka nënvizuar se ky partneritet do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Edhe drejtori Troni ka deklaruar të jetë i kënaqur me bashkëpunimin e deritashëm me z.Fischer dhe "Caritasin". Ai ka thënë se me "Caritasin" jemi duke i realizuar disa projekte, ndërsa e ka veçuar atë në fshatin Elezaj. Vitin e kaluar Komuna e Kaçanikut dhe "Caritasi" i Luksemburgut e kanë nënshkruar marrëveshjen për investime të përbashkëta në Elezaj. Investimet do të bëhen në fushën e edukimit, në atë shëndetësisë dhe në fushën e gjenerimit të të hyrave. Vlera e përgjithshme e investimeve në Elezaj është 400 mijë e 342 euro. Në marrëveshjen e firmosur thuhet se "Caritasi" do t'i investojë 316.460 euro (70% e totalit të mjeteve), kurse Komuna e Kaçanikut 83.882 euro (30%).



# Universumi i jep 5 bursa për studentë kaçanikas

**11 shtator** - Kolegji Universum i Ferizajt i ka ndarë 5 bursa për studentë kaçanikas për vitin akademik 2012/2013. Prof.dr.Hajrullah Gorani, rektor i Universumit, ia ka dorëzuar kryetarit të Komunës, z.Besim Ilazi, vendimin e Këshillit Drejtues të Universumit. Ceremonia e dorëzimit të vendimit të sipërpërmendur është mbajtur në prani edhe të z.Suad Berisha, kryetar i këshillit drejtues, dhe z.Sedat Berisha, bashkëthemelues i Universumit. Kryetari Ilazi e ka vlerësuar lart iniciativën e kolegjit për ndarjen e bursave, ndërsa ka thënë se ato janë të mirëseardhura për maturantët. Përzgjedhja e studentëve do të bëhet nga Komuna e Kaçanikut në përputhje me kriteret bazë dhe gjendjen ekonomike të studentëve. Përfituesit e bursave do të përzgjidhen nga stafi i shërbyesve civilë komunalë (1), nga familjet e dëshmorëve (1), nga invalidët të luftës (1), nga maturantët në asistencë sociale (1) dhe nga maturantët e dalluar në mësime (1).



# Kryetari firmos letrën përkrahëse të MBPZHR-së

**11 shtator** - Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, e ka nënshkruar letrën përkrahëse të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, e firmosur paraprakisht edhe nga ministri Blerand Stavileci. Në aktin e nënshkrimit të pranishëm ishin: z.Behlul Behluli, këshilltar i ministrit Stavileci, z.Shaban Dreshaj, shef i Sektorit të Shërbimeve Këshillimore, dhe Nuhi Provoliu, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë. Në letrën përkrahëse thuhet: "Pajtohemi që të zbatojmë Ligjin nr.04/L-074 për shërbimet këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural, pastaj aktet nënligjore që dalin nga zbatimi i tij dhe Strategjinë e shërbimeve këshilluese për bujqësi dhe zhvillim rural 2012 – 2016 (e aprovuar nga Qeveria e Kosovës në gusht të vitit 2012)". Kryetari Ilazi kohë më parë qe takuar me z.Behluli dhe z.Dreshaj, ndërsa qenë dakorduar për themelimin e qendrës për shërbime këshilluese në Komunë. Në takim qe thënë se qendrat për shërbime lokale këshilluese do të jenë të lidhura me nivelin qendror dhe Institutin Bujqësor, ndërsa do të kryejnë jo vetëm shërbime këshilluese sa i përket menaxhimit të fermave, marketingut dhe çështjeve teknike.



## Kryetari cakton të enjtet për takime me qytetarë

**13 shtator** - Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, i ka caktuar ditët e enjte për takime me qytetarë nga ora 13:00-16:00. Kryetari Ilazi ka thënë se ne jemi këtu për qytetarët dhe u shërbejmë atyre. "Unë do t'i dëgjoj brengat e tyre, sikurse edhe vërejtjet, sugjerimet dhe këshillat, gjithnjë duke qenë në funksion të të gjithë qytetarëve të komunës sonë", ka nënvizuar kryetari Ilazi.

## Komuna dhe DEMI investojnë në QSHQ-në

**13 shtator** - Komuna dhe programi Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI) i USAID-it do ta bashkëfinacojnë projektin për riaranzhimin e Qendrës së Shërbimeve për Qytetarë (QSHQ). Kështu është thënë në takimin e kryetarit të Komunës, z.Besim Ilazi, me z.Sali Salihu, përfaqësues i DEMI-t. Kryetari Ilazi dhe z.Salihu e kanë vlerësuar si shumë të suksesshëm bashkëpunimin e deritashëm të Komunës me DEMI-n. Për riaranzhimin e QSHQ-së (Zyra pritëse) programi DEMI do të kontribuojë me rreth 35 mijë dollarë amerikanë, kurse pjesën tjetër të shpenzimeve do ta heq Komuna nga buxheti i vet.

## "Caritasi" dhuron pajisje për QKMF-në dhe QMF-të

**14 shtator** - "Caritasi" i Luksemburgut ia ka dhuruar një numër pajisjesh dhe aparaturash dore Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Kaçanik dhe të gjitha qendrave të mjekësisë familjare (QMF) në fshatra. Misim Sopa, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, ka thënë se "Caritasi" i Luksemburgut i ka dhuruar një numër pajisjesh dhe aparaturash shumë të nevojshme për qendrat e shëndetësisë të komunës. Ai ka thënë se janë dhuruar: 7 copë Sphygnomanometer, 6 Sthetoscope, 9 Glucometer, 9 komplete Glucotest strips, 5 copë Snellen Card, 4 Ear Syringe, 9 Inhalator, 1 Adult Scale, 1 Baby Scale, 1 Vaginal Speculum, 11 PF Meter, 1 Tongue Depressors, 3 Electronic Ear Themometer, 1 Sterilizer, 7 Ophta/Otoscope, 1 Fetoscope, 7 Pregnancy test, 2 Measring tape, 10 Urine

dipstick, 1 Gloves dhe 9 copë Oxygen Mask. Ekrem Dullovi, drejtor i QKMF-së, e ka falënderuar "Caritasin" e Luksemburgut për pajisjet dhe aparaturat e dhuruara të cilat i ka cilësuar si shumë të vlefshme.

## Kryetari riemëron drejtorët e drejtorive komunale

**18 shtator** - Kryetari i Komunës, Besim Ilazi, i ka riemëruar drejtorët e drejtorive komunale në postet që i kanë mbajtur deri tashti. Kryetari Ilazi i ka nënshkruar vendimet për emërimin e 7 drejtorëve të drejtorive komunale duke u bazuar në nenin 62.2 të Ligjit nr.03/L-040 për vetëqeverisjen lokale dhe nenit 73.7 të Statutit të Komunës së Kaçanikut.

## Përurohet parku rinor

**19 shtator** - Në Ditën e Rinisë të Kaçanikut, kryetari Komunës, z.Besim Ilazi, dhe znj.Sade Owolabi, zyrtare e USAID-it për demokraci dhe qeverisje, e kanë bërë përurimin e projektit: "Ndërtimi i parkut rinor dhe rehabilitimi i pjesës së oborrit të pallatit të kulturës 'Xheladin Kurtaj' në Kaçanik". Kryetari Ilazi e ka falënderuar programin DEMI të USAID-it për mbështetjen e projektit të sipërpërmendur, ndërsa ka rikujtuar se ideja për realizimin e tij ishte e të rinjve të cilët nëpërmjet Këshillit për Veprim Rinor Lokal e iniciuan atë. Edhe znj. Owolabi i ka inkurajuar të rinjtë për realizim projektesh tjera. Ajo ka thënë të jetë e lumtur që e përfaqëson USAID-in në këtë



manifestim përurues, ndërsa është shprehur e bindur se USAID-i do të mbështesë edhe projekte tjera për të rinjtë kaçanikas. Realizimi i projektit të parkut rinor ka kushtuar 45.514 euro, ndërsa është bashkëfinancuar nga programi Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI) i USAID-it dhe Komuna e Kaçanikut. DEMI i ka investuar 35.303 euro, ndërsa Komuna 10.211 euro.

## USAID-i do të vazhdojë ta mbështesë Komunën e Kaçanikut

**19 shtator** - Zyrtarë të USAID-it i kanë thënë kryetarit të Komunës, z.Besim Ilazi, se do të vazhdojnë t'i mbështesin financiarisht projektet e Kaçanikut. Komuna dhe programi Iniciativa për Komuna Efektive dhe Demokratike (DEMI) i USAID-it e kanë vlerësuar si shumë të suksesshëm bashkëpunimin e deritashëm. Kryetari Ilazi ka thënë se programi DEMI në vazhdimësi e ka mbështetur me projekte të ndryshme Komunën e Kaçanikut. Ai ka artikuluar bindjen e tij se bashkëpunimi i ndërsjellë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ndërkaq, znj.Sade Owolabi, zyrtare për demokraci dhe qeverisje e USAID-it, ka deklaruar se USAID-i nëpërmjet programit DEMI do të realizojë edhe projekte tjera me interes për qytetarët kaçanikas. Në takim me kryetarin Ilazi, znj.Owolabi shoqërohej nga znj.Ginka Kapitanova, drejtoreshe e programit DEMI, dhe z.Sali Salihu, këshilltar për qeverisje lokale.



# Kryetari takon të rinjtë në ditën e tyre

**19 shtator** - Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, me rastin e Ditës së Rinisë të Kaçanikut, i ka takuar të rinjtë përfaqësues të Këshillit për Veprim Rinor Lokal (KVRL). Të rinjtë përfaqësoheshin nga Arlind Hysa, kryetar i KVRL-së, Fatlume Guri, sekretare, Mirlinda Axhami, nënkryetare, dhe Arif Mulaku, anëtar, ndërsa ata shoqëroheshin nga Fatmir Çaka, koordinator për rini. Kryetari Ilazi ua ka uruar të rinjve ditën e tyre, ndërsa i ka inkurajuar për punë dhe suksese të reja. Të rinjtë, në shenjë nderi dhe respekti, ia kanë dhuruar kryetarit Ilazi një fanellë me emblemën e KVRL-së.



# Dita e Rinisë të Kaçanikut përmbyllet me aktivitete sportive

**19 shtator** - Aktivitetet për shënimin e Ditës së Rinisë të Kaçanikut janë përmbyllur me finalet në garat sportive. Në ndeshjen finale të turneut në futboll të vogël janë përballur ekipi i gjimnazit "Skënderbeu" me atë të SHMP "Feriz Guri e Vëllezërit Çaka". Ndeshjen e ka fituar "Skënderbeu" me rezultatin 2:1. Në kuadër të aktiviteteve sportive janë zhvilluar edhe ndeshjet finale në basketboll e volejboll. Në basketboll fitues u shpall ekipi i SHMP"Feriz Guri e Vëllezërit Çaka", i cili në finale e ka mposhtur ekipin e Këshillit për Veprim Rinor Lokal. Ndërkaq, në volejboll, në kategorinë e femrave, fitues doli ekipi i gjimnazit "Skënderbeu", i cili ishte më i mirë se ai i SHMP "Feriz Guri e Vëllezërit Çaka". Pjesë e aktiviteteve përmbyllëse ka qenë edhe shfaqja e një filmi artistik.



# Mbahet panairi i gjedhit "Kaçaniku 2012"

**23 shtator** - I organizuar nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në oborrin e shkollës fillore në fshatin Koxhaj është mbajtur panairi i gjedhit "Kaçaniku 2012", i katërti me radhë. "Komuna e Kaçanikut, në bashkëpunim me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR) dhe shoqata të ndryshme, ka realizuar një numër projektesh mbështetëse për fermerët sidomos në fushën e blegtorisë", ka theksuar Nuhi Provoliu, drejtor i DBPZHR-së, pasi e ka shpallur të hapur panairin. Ndërkaq, kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, ka rikujtuar se komuna e Kaçanikut ka kushte të volitshme për zhvillimin e blegtorisë. "Edhe ky panair synim kryesor e ka motivimin e fermerëve për përmirësimin e racave të gjedhit", ka thënë kryetari Ilazi. Ai i ka falënderuar përfaqësuesit e Zyrës së biznesit K-Kosova, përfaqësuesit e MBPZHR-së, jurinë profesionale të Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë të UP-së dhe ProCredit Bankën për mbështetjen e panairit. Bajram Imeri, drejtor i Departamentit të Blegtorisë të MBPZHR-së, ka thënë se ministria është duke i mbështetur fermerët nëpërmjet subvencionimit dhe granteve direkte. Prof.dr.Hajrip Mehmeti, ligjërues në FBV të UP-së, ka thënë se të gjitha kafshët e ekspozuara ishin elitare, prandaj komisioni e kishte të vështirë përzgjedhjen e gjedhit më të mirë. Fituesit e "Kaçaniku 2012" janë shpallur nga komisioni vlerësues në përbërje: Prof.dr.Hajrip Mehmeti, Bajram Imeri dhe Hadushe Ukshini, zyrtare rajonale për blegtori. Në kategorinë e racës produktive



vendi i parë i takoi lopës së fermerit Muharrem Deda, vendi i dytë lopës së Ibush Vishit, ndërsa i treti asaj të fermerit Ibush Rexhepi. Në konkurrencën e racës vendore "Metise", vendi i parë i takoi lopë së pronarit Xhevahir Berisha, vendi i dytë asaj të Imri Selimit, kurse i treti asaj të pronarit Festim Gabrrica. Në kategorinë e mëshqerrave, më e mirë u shpall ajo e pronarit Qefser Sopa, vendi i dytë i takoi mëshqerrës së fermerit Shiqeri Vishi, ndërsa i treti asaj të fermerit Sali Salihu. Në kategorinë e demit më të mirë, vendi i parë i takoi demit të fermerit Kadri Salihu, vendi dytë demit të Sabri Manit, ndërsa vendi i tretë atij të pronarit Ramadan Demnika. Vendet e para janë shpërblyer me nga 250 euro, vendet e dyta me nga 150 euro, kurse vendet e treta me nga 100 euro.

## Mbahet dëgjimi i dytë publik për draftet e buxheteve 2013-2015

**26 shtator** - Është mbajtur dëgjimi i dytë publik me qytetarë për draftbuxhetet e Komunës për vitet fiskale 2013, 2014 dhe 2015, me theks të veçantë për atë të vitit të ardhshëm. Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, i ka shpalosur buxhetet e Komunës për tri vitet në vijim. Drejtori Vërbani ka thënë se është ruajtur struktura e përgjithshme buxhetore në shumën prej 5.611.059 euro të planifikuara për vitin e ardhshëm. Nga të hyrat vetjake komunale mot ishte paraparë të sigurohen 600 mijë euro. Buxheti i vitit 2014 ishte projektuar në lartësi prej 5.716.994 eurosh, ndërsa ia i 2015-s në shumë prej 5.771.708 eurosh. Gjatë periudhës 2013-2015 ishin paraparë 3.546.061 euro për realizmin e 58 projekteve kapitale, pa i llogaritur grantet eventuale nga donatorët qeveritarë dhe joqeveritarë. Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, pasi i ka falënderuar qytetarët për pjesëmarrje, ka theksuar se buxhetet janë të pamjaftueshëm në raport me nevojat. "Ne jemi munduar që të bëjmë një gjithëpërfshirje të lokaliteteve sa i përket investimeve kapitale. Nuk do të ishte e drejtë që diku të bëhen më shumë investme e diku aspak", ka theksuar z.Ilazi. Pensionisti Zekirja Bajra ka kërkuar mbështetje më të madhe për sektorin e arsimit dhe atë të shëndetësisë. Nxënësja Ardita Rrahmani, anëtare e Këshillit Rinor të Veprimit Lokal, ka kërkuar mbështetje më të madhe financiare për KVRL-në. Nexhadi Luta (Ivajë) ka artikuluar shqetësimin

për mosplanifikim mjetesh për situata emergjente. Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencës, i ka thënë Lutës se komunave nuk u lejohen fonde për situata emergjente. Ekrem Dullovi, drejtor i Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), ka thënë se infrastruktura fizike e objektit të QKMF-së është shumë e vjetruar. Kryetari Ilazi i ka thënë Dullovit se në QKMF do të bëhen riparimet më emergjente dhe do të ndërrohen dyert e dritaret. Bafti Loku, drejtor në SHMP "Feriz Guri e Vëllezërit Çaka", ka kërkuar që projektet e filluara me faza të vazhdohen në vitin vijues. Kjani Sallahu (Biçec) ka kërkuar të dijë se për ç'arsye po zvarritet projekti për ndërtimin dhe asfaltimin e rrugës së fshatit dhe ai i fazës së dytë të kanalizimit në Biçec. Fatlume Guri (KVRL) ka kërkuar riparimin e kulmit të pallatit të kulturës "Xh. Kurtaj", ndërsa Abedin Vishi ka kërkuar instalimin e kanalizimit fekal në lagjen "Çardak" të Kaçanikut të Vjetër. Ilirjana Berisha (KVRL) u interesua të dijë se a është planifikuar ndërtimi i palestrës sportive, kurse Burim Bunjaku, drejtor i SHF"Jusuf Gërvalla" në Biçec, ka kërkuar që në projektet prioritare të futet edhe riparimi i kulmit të kësaj shkolle. Beqir Krasniqi (Kaçanik i Vjetër) ka thënë se ne disa lokalitete deri tashti nuk është realizuar asnjë projekt, prandaj duhet pas parasysh edhe këtë fakt. Duke iu përgjigjur pyetjeve dhe kërkesave të qytetarëve, kryetari Ilazi ka thënë se projekti për ndërtimin e palestrës sportive dhe ai për rregullimin e kulmit të Pallatit të Kulturës i janë përcjellur nivelit qendror, ndërsa për rrugën e fshatit Biçec ka thënë se ajo është paraparë të finalizohet në 3 faza gjatë 3 vjetëve në vijim.



# Kuvendi miratoi buxhetin e 2013-s

**27 shtator** - Legjislativi komunal e ka miratuar buxhetin e Komunës për vitin 2013 dhe vlerësimet për vitet 2014 dhe 2015. Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, i ka shpalosur buxhetet e Komunës për tri vitet e ardhshme me theks në atë vitit fiskal 2013, i projektuar në shumë prej 5.611.059 eurosh. Është thënë se në totalin e buxhetit të vitit të ardhshëm transferet qeveritare marrin pjesë me 5.011.059 euro, kurse të hyrat vetjake komunale me 600.000 euro. Për paga dhe mëditje ishte paraparë 66,7% e buxhetit ose 3.743.672 euro, për mallra dhe shërbime me 9,5% (535.468 euro), për subvencione dhe transfere 2,3% (130.000 euro), për shpenzime komunale 1,9 % (108.757 euro) dhe për investime kapitale 19,5% e buxhetit ose 1.093.162 euro. Buxheti i 2014-s ishte projektuar në shumë prej 5.716.994 eurosh, kurse ai i 2015-s në lartësi prej 5.771.708 eurosh. Buxhetet e Komunës ishin projektuar me rritje vjetore prej 5,9%. Drejtori Vërbani ka theksuar se për periudhën 2013-2015 janë alokuar 3.546.061 euro për realizimin e 58 projekteve kapitale, pa i llogaritur donacionet eventuale nga donatorë qeveritarë dhe joqeveritarë. Kuvendi i Komunës e ka miratuar edhe Rregulloren për tatimin në pronë mot. Është thënë se nga viti i ardhshëm do të aplikohen shkallët e me rritje të tatimit nga 0,10% në 0,15% për objektet e banimit, për pronat bujqësore dhe për garazhet. Faturat e vitit 2013 do të kenë rritje prej 11%, ndërsa mesatarja e tatimit në nivel komune do të jetë 24,42 euro. Kuvendi e ka miratuar edhe propozimvendimin për ndryshimin e



shumave të ndara për projektet kapitale sipas ndarjeve me buxhetin e Komunës të vitit 2012, pastaj propozimvendimin për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale në komunën e Kaçanikut dhe propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e minihidrocentraleve në lumin Lepenc.

## Punohen murale te Varrezat e Dëshmorëve

**28 shtator** - Portreti i komandantit legjendar Adem Jashari, emblema e UÇK-së dhe dy kolona ushtarësh të UÇK-së janë përfshirë në muralin e punuar te Varrezat e Dëshmorëve. Punimi i muraleve është pjesë e projektit: "Ndërtimi i Varrezave të Dëshmorëve – faza e dytë", i cili është në realizim e sipër. Betim Shala, menaxher i projektit, ka thënë se pjesë e projektit është edhe nivelimi i tërë sipërfaqes, veshja me pllaka guri e shkallëve të varrezave dhe hapësirës tjetër, ndërtimi i fontanës në formë të hartës së trojeve shqiptare etj. Për realizimin e projektit të sipërpërmendur do të shpenzohen gjithsej 47.838 euro të buxhetit komunal.



# TETOR 2012

## Komuna dhe CHwB firmosin memorandumin për trashëgiminë kulturore

**2 tetor** - Komuna e Kaçanikut dhe fondacioni suedez Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) e kanë nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit për trashëgiminë kulturore. Memorandumi parasheh zbatimin e një programi të financuar nga Suedia i cili ka për qëllim mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore gjatë periudhës 2013-2015. Memorandumi është nënshkruar edhe nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe nga ajo e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, ka thënë se Komuna e Kaçanikut ka mjaft resurse kulturore me vlera. "Ne do të koordinojmë veprimet me CHwB-në për t'i identifikuar resurset e trashëgimisë kulturore dhe natyrore që mund të shërbejnë si bazë për zhvillim socioekonomik", ka theksuar z.Ilazi.



# Hartohet plani i realizimit të objektivit vjetor të të hyrave

**3 tetor** - Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, në takim me znj.Ginka Kapitanova, drejtoreshë e programit Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI) të USAID-it, e ka shpalosur planveprimin e Komunës nëpërmjet të cilit synohet arritja e objektivit për arkëtimin e të hyrave vetjake të planifikuara për sivjet. Ai ka thënë se gjendjen aktuale duhet ndryshuar. "Në mospërmbushjen e objektivit të synuar kanë ndikuar shpërndarja me vonesë e faturave të tatimit në pronë, vendimi i Kuvendit të Komunës për lirimin e bizneseve nga taksat komunale dhe vendimet për kufizimin e ofrimit të shërbimeve komunale me pagesën e faturave të mbeturinave dhe ujit, pasat zgjedhjet e parakohshme për kryetar të Komunës etj", ka thënë z.Ilazi. Ai ka theksuar se tani jemi mobilizuar maksimalisht, ndërsa kemi ndërmarrë edhe hapa konkret. "Janë formuar dy grupe punuese për të biseduar me pronarët e bizneseve që t'u shpjegohet edhe një herë se për ç'arsye ata duhet të përmbushin obligimet e tyre ndaj Komunës. Nëse ky aktivitet nuk rezulton i suksesshëm, atëherë do të jemi të detyruar të ndërmarrim masa ndëshkuese", ka nënvizuar kryetari Ilazi. Ndërkaq, znj.Kapitanova, ka thënë se programi DEMI objektiv kryesor e ka ofrimin e ndihmës komunave për të ngritur kapacitetet e tyre për të analizuar dhe ndërmarrë veprime në lidhje me potencialet bazë të të hyrave vetjake. Në takim kanë qenë të pranishëm edhe z.Sali



Salihu, këshilltar për qeverisje lokale i DEMI-it, z.Agim Salihu, analist i të hyrave i DEMI-it, z.Xhelal Gashi, kryesues i KK-së dhe Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit. Z.Gashi ka shprehur gatishmërinë e legjislativit komunal për mbështetje nismës për shtim të të hyrave komunale, ndërsa Vërbani ka thënë se ndërkohë janë shënuar trende pozitive në inkasimin e të hyrave. Të hyrat vetjake komunale për sivjet janë planifikuar në shumë prej 593.130 eurosh, ndërsa gjatë periudhës 9-mujore janë arkëtuar 300 mijë euro.

## Komuna krijon databazën e bizneseve të mërgimtarëve

**4 tetor** - Komuna dhe Ministria e Diasporës (MD) e kanë mbështetur projektin për evidencimin e bizneseve të pronarëve nga diaspora. Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, dhe z.Shani Hamitagaj, drejtor departamenti (MD), janë pajtuar për realizimin e nismës së sipërpërmendur. Në takim kanë marrë pjesë edhe znj.Linda Tahiri, zyrtare e MD-së, Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave e Zhvillimit, dhe Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Kryetari Ilazi ka thënë se Komuna ka krijuar lehtësira për të gjitha bizneset duke i liruar nga taksat komunale për 3 vjet. "Ne mirëpresim iniciativat e reja për themelimin e bizneseve me pronarë nga diaspora dhe do të mundohemi që të tregojmë një përkujdesje institucionale për këto biznese", ka nënvizuar kryetari Ilazi. Ndërkaq, z.Hamitagaj ka thënë se



në fazën e parë do të evidencohen bizneset në nivelin lokal, kurse në të dytën bizneset më të suksesshme që operojnë në diasporë. "Të dhënat që do të grumbullohen do të përfshihen në një informator, ndërsa do të publikohen edhe në uebfaqen zyrtare të MD-së", ka thënë z.Hamitagaj. Në takim është thënë se Komuna do të caktojë një zyrtar komunal i cili në koordinim me MD-në do t'i kryejë detyrat që i parashtrohen.

## Komuna e Kaçanikut, e nënta në nivel vendi për kushte për biznes

**12 tetor** - Komuna e Kaçanikut është renditur e nënta në nivel vendi sa i përket kushteve të krijuara për ushtrim biznesi. Programi i USAID-it për Përmirësimin e Mjedisit Afarist (PPMA) në komunat e Kosovës, e ka prezantuar Indeksin e Konkurrencës për komunën e Kaçanikut, ndërsa në këtë aktivitetet kanë marr pjesë zyrtarë komunalë dhe pronarë biznesesh. Znj.Samire Saliu, koordinatore e PPMA-së, ka thënë se ky program i USAID-it është duke punuar për përmirësimin e mjedisit ligjor dhe rregullativ në Kosovë. Ajo ka theksuar se Indeksi i Konkurrencës së komunave paraqet një matje të cilësisë së qeverisjes ekonomike lokale lidhur me krijimin e mjedisit afarist nëpërmjet anketës së bërë me bizneset në komunat e Kosovës. Sipas anketës, komuna e Kaçanikut është renditur e 9-a në mesin e simotrave të Republikës së Kosovës. Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, ka thënë se po



punojmë së bashku me bizneset që të krijojmë një ambient sa më të favorshëm afarist. Komuna ka krijuar edhe lehtësira duke hequr taksën komunale për periudhën 2012-2014. Drejtori Vërbani ka nënvizuar se Komuna e Kaçanikut synon të renditet në mesin e 5 komunave me mjedis më të favorshëm, ndërsa e ka vlerësuar si hap pozitiv avancimin e komunës nga vendi i 14, ku ishte renditur më 2010, në të 9-in për vitin 2011.

## "Syri i Sharrit" mbajti kuvendin zgjedhor

**12 tetor** - Është mbajtur kuvendi zgjedhor i grupit lokal të veprimit "Syri i Sharrit" në të cilin është zgjedhur kryesia e re e Bordit drejtues në përbërje prej 8 anëtarëve (4 nga sektori publik dhe po aq nga ai privat). Bordi drejtues e ka rizgjedhur në postin e kryetarit Nuhi Provoliun, drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë. Hidajete Guri është zgjidhur nënkryetare e parë, ndërsa Xhelal Luma nënkryetar i dytë. Është thënë se fushëveprimtari të saj GLV-ja e ka mbështetjen dhe promovimin e zhvillimit ekonomik lokal. Në këtë kontekst, "Syri i Sharrit" angazhohet për të shtuar të ardhurat për individët dhe ndërmarrjet, për të rritur punësimin, për të mbrojtur dhe ngritur vlerën e trashëgimisë lokale natyrore e kulturore dhe për të ndërmarrë dhe mbështetur çfarëdo veprimi tjetër i cili synon menaxhim më të mirë të viseve rurale brenda territorit të komunës së Kaçanikut. GLV-ja është organizatë joqeveritare, ndërsa është themeluar në mars të vitit 2009.



# Themelohet Këshilli organizativ për shënimin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë

**15 tetor** - Është themeluar Këshilli organizativ për shënimin e 100-vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë. Vendimi për themelimin e këshillit të sipërpërmendur është marrë nga ekzekutivi komunal. Në përbërjen e këshillit janë caktuar 11 veta, ndërsa do të kryesohet nga kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi.



# Vizitë studimore në Kaçanik e zyrtarëve të komunave të rajonit të Gjilanit

**15 tetor** - Zyrtarë të disa komunave të rajonit të Gjilanit kanë qëndruar në Kaçanik për vizitë studimore në Komunë. Zyrtarët e komunave Gjilan, Kamenicë, Novobërdë dhe Hani Elezit e kanë vizituar Komunën e Kaçanikut në kuadër të projektit të OSBE-së: "Përkrahja për shkëmbimin e përvojave më të mira të zyrtarëve të të njëjtit nivel". Në përbërje të delegacioneve

kanë qenë kryesuesit e kuvendeve komunale, zyrtarë të kuvendeve dhe zyrtarët e informimit. Mysafirët janë pritur nga z.Besim Ilazi, kryetar i Komunës, i cili u ka thënë atyre se shkëmbimi i përvojave të mira ndërmjet komunave është në interes të avancimit të punës dhe praktikave rezultative. Mysafirët e kanë vizituar Zyrën e kryesuesit të Kuvendit, zyrtaren e Kuvendit, Makfire Malsiu, Zyrën e Informimit, Drejtorinë e Arsimit dhe Kulturës, Drejtorinë e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, sallën e Kuvendit dhe Zyrën pritëse. Në kuadër të projektit të sipërpërmendur më herët në Gjilan OSBE-ja e pati organizuar një punëtori në të cilën përfaqësuesit e Komunës të Kaçanikut e patën prezantuar punën e Kuvendit në rrafshin e përgatitjes dhe mbajtjes së seancave të KK-së, sikundër edhe aktivitetet për informimin e qytetarëve dhe ato në funksion të bashkëpunimit ndërkomunal.



## Komuna dhe LOGOS-i debatuan me qytetarë për draftin e PRRU-së

**16 tetor** - Komuna e Kaçanikut dhe projekti për qeverisje lokale dhe decentralizim LOGOS, që financohet nga Qeveria zvicerane, e kanë organizuar debatin me qytetarë lidhur me draftin parafinal të Planit rregullues urban të zonës së parë dhe një pjesë të zonës së dytë të qytetit Kaçanik. Të pranishëm kanë qenë edhe kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, nënkryetari, z.Remzi Elezi, dhe koordinatori i LOGOS-it, z.Norbert

Pijls. Kryetari Ilazi ka thënë se dokumenti i hartuar është i një rëndësie të veçantë dhe përcakton kahet gjithëpërfshirës të zhvillimit të qytetit. Kryetari Ilazi e ka falënderuar LOGOS-in për mbështetjen jo vetëm të këtij projekti, ndërsa e ka falënderuar edhe grupin e ekspertëve për angazhimin e përkushtuar. Ndërkaq, z.Pijls ka thënë se së bashku me Komunën kemi punuar një vit e gjysmë dhe sot e kemi këtë dokument që duhet të zbatohet. Z.Pijls ka deklaruar se LOGOS-i do të vazhdojë ta mbështes edhe në të ardhmen Komunën e Kaçanikut. Znj.Suzana Goranci, zyrtare e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka theksuar se Komuna e Kaçanikut e ka hartuar Planin zhvillimor komunal dhe Planin zhvillimor urban dhe e ka marrë pëlqimin nga MMPH-ja për hartimin e Planit rregullues urban (PRRU). Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e ka shpalosur draftin e hartuar të PRRU-së të zonës I dhe një pjesë të zonës II të qytetit. Më pas qytetarët e pranishëm në debat janë ndarë për të punuar në 4 grup. Krejt në fund, Grupi për demografi dhe çështje sociale, Grupi për zhvillim ekonomik, Grupi për infrastrukturë dhe Grupi për shfrytëzimin e tokës punuese dhe mjedis i kanë shpalosur para të pranishmëve rekomandimet e tyre për përfshirje në draftin final të PRRU-së.



## Komuna nis komunikimin nëpërmjet WEB SMS-ve

**17 tetor** - Komuna e Kaçanikut ka filluar të aplikojë formën e re të komunikimit nëpërmjet WEB SMS-ve. Jeton Topalli, drejtor i Administratës së Përgjithshme, ka thënë se ky shërbim mundëson dërgimin e mesazheve me përmbajtje informuese nga kompjuteri në telefonat mobilë të zyrtarëve komunalë. Ai ka nënvizuar se aplikimi i kësaj forme të komunikimit do të ndikojë dukshëm në zvogëlimin e shpenzimeve telefonike të administratës komunale. Ndërkaq, Bejtulla Dalloshi, përgjegjës për teknologjinë informative, ka thënë se ky shërbim është efikas dhe kursen edhe kohën në procesin e komunikimit.

## Promovohet drafti parafinal i Planit rregullues për "Livadhet e Shtrazës"

**18 tetor** - Është promovuar drafti parafinal i Planit rregullues për zonën turistike "Livadhet e Shtrazës" në një debat publik me qytetarë. Draftin e planit e ka shpalosur znj.Florina Hoxha, zyrtare e Entit Urbanistik të Kosovës, njëherësh konsulente e projektit. Ndërkaq, z.Xhelal Gashi, kryesues i Kuvendit të Komunës, hartimin e planit të sipërpërmendur e ka vlerësuar projekt madhor që do t'i bëjë nder jo vetëm Kaçanikut. Ai ka thënë se rekomandimet që do të dalin nga debati do të përfshihen në draftin final që do t'i hapë rrugë zhvillimit të kësaj zone turistike e rekreative. Bafti Loku, qytetar, është interesuar të dijë se a është harmonizuar me planin rruga Gajre-Ivajë-Shtrazë e planifikuar për ndërtim mot. Hafet Ceka ka propozuar që grupi i ekspertëve, gjatë hartimit të draftit final,



të ketë parasysh edhe pjesën e hapësirës ku shtrihet Liqeni i Ivajës. Qytetari Xhemal Guri ka sugjeruar që të ruhen lisat në hapësirën e përfshirë në plan. Të pranishmit kanë bërë edhe shumë pyetje të cilave u janë përgjigjur hartuesit e draftit, sikundër edhe znj.Iliriana Zhubi, arkitekte, dhe z.Mahmut Vizdik, projektues i rrugës në zonën turistike. Plani do të jetë në diskutim publik 30 ditë, ndërsa vërejtjet dhe propozimet mund të përfshihen në fletoren e shënimeve e cila gjendet në pallatin e kulturës "Xheladin Kurtaj" bashkë me materialet e planit të hartuar.

## OSBE-ja i dhuron libra bibliotekës së qytetit



**18 tetor** - OSBE-ja ia ka dhuruar një numër librash bibliotekës së qytetit. Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, dhe z. Ulrich Biffar, drejtor i Qendrës rajonale të OSBE-së në Gjilan, e kanë bërë pranimdorëzimin e librave. Projekti në vlerë prej 500 eurosh është financuar nga OSBE-ja, ndërsa është realizuar nga Këshilli i Veprimit Rinor Lokal (KVRL). Kryetari Ilazi i ka përgëzuar të rinjtë për realizimin jo vetëm të këtij projekti, kurse i ka inkurajuar që të vazhdojnë edhe me projekte tjera. "Libri është pasuri, libri na e pasuron mendjen dhe shpirtin", ka thënë kryetari Ilazi. Edhe z. Biffar e ka çmuar lartë rëndësinë e librit. Kryetari Ilazi, në shenjë nderi e respekti, ia ka dhuruar z. Biffar një fjalor enciklopedik shqiptar. Është thënë se puna dhe angazhimi i të rinjve, anëtarë të KVRL-së, e ka nxitur OSBE-në që të mbështesë projektin e sipërpërmendur. Në aktivitetin e organizuar me rastin

e dorëzimpranimit të librave ka performuar grupi i letrarëve të rinj dhe ai i muzikantëve të rinj.

## Nxirren për shqyrtim publik dy plane rregulluese

**19 tetor** - Janë nxjerrë në shqyrtim publik 30-ditësh drafti parafinal i Planit rregullues urban (PRRU) për zonën e parë të qytetit dhe një pjesë të zonës së dytë dhe drafti i Planit rregullues (PRR) për zonën turistike "Livadhet e Shtrazës". Draftet e planeve të sipërpërmendura janë ekspozuar në hollin e pallatit të kulturës "Xheladin Kurtaj". Të dy draftet paraprakisht janë diskutuar në dy debate të ndara publike me qytetarë. Vërejtjet, sugjerimet dhe rekomandimet e qytetarëve të artikuluar në debatet e mbajtura, sikundër edhe ato që do të evidencohen në fletoret vendosura për këtë qëllim gjatë periudhës së shqyrtimit publik, do të merren parasysh gjatë hartimit të drafteve finale të planeve.



# Themelohet Forumi Lokal i Trashëgimisë Kulturore të Kaçanikut

**22 tetor** - Është themeluar Forumi Lokal i Trashëgimisë Kulturore të Kaçanikut (FLTKK) për zbatimin e programit: "Planet lokale të trashëgimisë kulturore 2012 – 2015". Forumi përbehet nga 19 anëtarë dhe kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi. Anëtarët e forumit janë nga dy ministri, ndërsa niveli komunal përfaqësohet me nga 2 anëtarë të Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës, Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit dhe Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit. Pesë anëtarë të FLTKK-së janë të shoqërisë civile. Kryetari Ilazi ka thënë se ky program mundëson një qasje të re sa i përket mbrojtjes dhe promovimit të resurseve te trashëgimisë kulturore, ndërsa është një mundësi për të bërë gjëra të mira në këtë rrafsh. Ndërkaq, z.Nol Binakaj, zëvendësdrejtor i CHwB-së, Zyra në Kosovë, i ka shpalosur disa nga aktivitetet e programit Trashëgimia kulturore pa kufij për periudhën 2012-2015. Idetë për hartimin e Planit lokal të trashëgimisë kulturore të Kaçanikut (PLTKK) 2012-2015 i ka shpalosur z.Mirian Bllaci, ekspert i CHwB-së. Themelimit të FLTKK-së i ka paraprirë nënshkrimi i memorandumit të mirëkuptimit ndërmjet Komunës të Kaçanikut, fondacioni suedez Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB), Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (MKRS) dhe Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Sipas memorandu



mit, Komuna obligohet edhe të kontribuojë me së paku 20% të vlerës së projekteve që do të realizohen në kuadër të PLTKK-së, ndërsa CHwB-ja do t'i investojë nga 100 mijë euro. Është thënë se zbatimi i PLTKK-së pritet të nisë në prill të 2013-s.

## Qytetarët njoftohen me të drejtat për ankesa

**23 tetor** - Qytetarët janë njoftuar me të drejtat e tyre dhe mekanizmat e sistemit të drejtësisë për të parashtruar ankesa kundër gjyqtarëve, porotëve, avokatëve, prokurorëve etj, në debatin e organizuar nga Qendra e Trajnimeve dhe Burimeve për Avokim (ATRC). Është thënë se fushata "Drejtësia dhe qytetarët", që mbështet nga E Drejta Ndërkombëtare Publike dhe Grupi për Politika (PILPG) dhe financohet nga Departamenti Amerikan i Shtetit, është një lëvizje që sjell së bashku qytetarët dhe grupet e shoqërisë civile me qëllim të identifikimit të çështjeve konkrete në sistemin e drejtësisë dhe për të promovuar ndryshimet nëpërmjet avokimit publik. Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, e ka vlerësuar si shumë të rëndësishëm qëllimin e kësaj fushate. Ai ka thënë se fushata i fuqizon qytetarët në të kuptuarit e mekanizmave për përmirësimin e sistemit gjyqësor dhe i inkurajon ata që të kërkojnë drejtësi. Ndërkaq, z.Kushtrim Kaloshi, drejtor i ATRC-së, ka folur për rolin, qëllimin dhe rëndësinë e fushatës. Ai ka thënë se fushata synon të rris qasjen e qytetarëve në drejtësi. Pyetjeve të të pranishmëve iu janë përgjigjur panelistët: Zef Prendrecaj, drejtor i Zyrës së Prokurorit



Disiplinor, Ajshe Berisha, zëdhënëse e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Isuf Hakiu, kryetar i Gjykatës Kundërvajtëse të Kaçanikut, Riza Livoreka, gjykatës i Gjykatës Komunale të Kaçanikut dhe Shukri Jashari, kryeprokuror i Gjykatës Komunale të Ferizajt.

## Përurohet shtëpia e familjes Berisha

**24 tetor** - Është përuruar shtëpia e re e familjes 3-anëtarëshe të Shyqeri Berishës, nga fshati Runjevë, e financuar nga shoqata humanitare "Feniks" dhe donatorë të tjerë, përfshirë edhe Komunën e Kaçanikut. Kryetari i Komunës, z. Besim Ilazi, e ka vlerësuar punën humanitare që është duke e bërë "Feniksi". Ai ka thënë se edhe Komuna e Kaçanikut e ka mbështetur ndërtimin e shtëpisë së familjes Berisha. I pranishëm në ceremoni ishte edhe kryetari i SHH"Feniks", z.Milaim Jashari, i cili e ka uruar familjen Berisha për shtëpinë. "'Feniksi' do të vazhdojë të ndihmojë familjet e varfra kudo që janë", ka thënë z.Jashari. Ndërkaq, Sevdije Frangu, koordinatore e "Feniksit" për komunën e Kaçanikut, ka thënë se deri tashti kjo shoqatë ka investuar në ndërtimin e 21 shtëpive dhe rinovimin e 4 të tjerave në komunën e Kaçanikut.



Komuna e Kaçanikut ka kontribuar me 850 euro për ndërtimin e shtëpisë së familje Berisha.

# Kryetari uron besimtarët për Bajramin e Vogël

**25 tetor** - Qytetarë të nderuar,
Kam kënaqësinë që të gjithë qytetarëve të besimit islam të ua uroj Festën e Kurban Bajramit, një ditë kjo e shënuar ku manifestohet sakrifica dhe devotshmëria ndaj Zotit. Kjo festë e madhërishme ngjallë midis njerëzve ndjenjën fisnike të mbështetjes dhe solidaritetit dhe na frymëzon të jemi gjithmonë të gatshëm të bëjmë sakrifica për të mirën e përgjithshme. Uroj që kjo festë në familjet tona të sjell lumturi, harmoni, respekt, tolerancë e mirëkuptim. Edhe në këtë ditë feste me krenari kujtojmë të gjithë ata që u sakrifikuan për lirinë e Kosovës, të gjithë dëshmorët, të gjithë ata që dhanë më të shtrenjtat, jetët e tyre, që ne të festojmë sot të lirë.

Besim Ilazi,
kryetar i Komunës

# Miratohet Plani strategjik i auditimit të brendshëm 2013-2015

**30 tetor** - Komiteti i Auditimit të Brendshëm (KAB) e ka miratuar Planin strategjik të auditimit të brendshëm të Komunës për periudhën 2013-2015 dhe Planin vjetor të auditimit të brendshëm për vitin 2013. Kefsere Koxha, drejtore e Njësisë së auditimit të brendshëm, i ka shpalosur planet e sipërpërmendura në takimin e dytë të rregullt të KAB-së. Në planet e hartuara ishin përfshirë



objektivat e synuara dhe vlerësimet e rrezikut. Planet janë vlerësuar edhe nga kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, i cili ishte i pranishëm në takimin e KAB-së. Në takim është debatuar edhe për raportin e Zyrës së Auditorit Gjeneral (ZAGJ) lidhur me pasqyrat financiare të Komunës së Kaçanikut për vitin 2011. Raporti i ZAGJ-it është cilësuar pozitiv për Komunën. Është thënë se nga 5 rekomandimet e raportit të 2010-s, tre janë përmbushur më 2011. Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, i ka njoftuar të pranishmit edhe me planveprimin e hartuar për eliminimin e të gjeturave të Auditorit të Përgjithshëm.

## Kryetari njoftohet me projektin ATOMI

**30 tetor** - Zyrtarë të qendrës ENCOMASS, z.Jusuf Thaçi, menaxher i projektit, z.Nait Vrenezi, mbikëqyrës i projektit, dhe znj.Edona Zogu, zyrtare për komunikim dhe donacione, e kanë njoftuar kryetarin e Komunës, z.Besim Ilazi, me projektin ATOMI. Menaxheri Thaçi ka thënë se ATOMI synon identifikimin dhe përkrahjen e nxënësve me inteligjencë mbi mesataren. "Synojmë identifikimin e hershëm të nxënësve inteligjentë dhe ofrimin e mundësive dhe kushteve për shkollim të veçantë për ta", ka theksuar z.Thaçi. Ai ka nënvizuar se projekti mbështetet nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Universiteti i Prishtinës dhe Radio Televizioni i Kosovës. Z.Thaçi ka thënë se ATOMI ka nevojë për mbështetje financiare edhe nga komunat. Ndërkaq, kryetari Ilazi e ka artikuluar gatishmërinë e Komunës për ta mbështetur financiarisht projektin të cilin e ka vlerësuar të



qëlluar dhe të veçantë. Projekti ATOMI zbatohet nga organizata joqeveritare Qendra për Studime dhe Shërbime Psikologjike dhe Sociale - ENCOMPASS.

## Kuvendi miratoi Rregulloren për këshillat e lokaliteteve të komunës

**31 tetor** - Në seancën e tetë, Kuvendi i Komunës e ka miratuar Rregulloren për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane të komunës të Kaçanikut, pastaj Rregulloren për caktimin e kritereve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve dhe propozimvendimin për ndërrimin e destinimit të parcelave kadastrale në përputhje me Planin zhvillimor urban (PZHU) të Kaçanikut. Legjislativi e ka shqyrtuar edhe raportin lidhur me ekzekutimin 9-mujor të buxhetit (1 janar-30 shtator), pastaj raportin e Zyrës së Auditorit Gjeneral (ZAGJ) lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të Komunës të Kaçanikut për vitin 2011 dhe informatën për përfundimin e vitit shkollor 2011/2012. Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, ka shpalosur aspekte të Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane, i hartuar në bashkëpunim me projektin LOGOS.



"Rregullorja do të vendosë rregull sa i përket organizimit dhe bashkëpunimit të Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane nëpërmjet zgjedhjes së

këshillave të lokaliteteve si trupa mbështetës të Komunës", ka thënë drejtori Ceka. Ndërkaq Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë e Zhvillimit, e ka shpalosur Rregulloren për caktimin e kritereve për ndarjen e subvencioneve dhe transfereve. Rregullorja e miratuar i lejon kryetarit të Komunës që të ndajë mjete financiare për entitete publike e jopublike dhe për ndihma çasti. Drejtori Vërbani e ka shpalosur edhe raportin lidhur me ekzekutimin 9-mujor të buxhetit. "Buxheti i aprovuar në lartësi prej 5.457.755 eurosh është rritur ndërkohë për 2,9% ose për 160.356 euro. Këtë rritje e kanë prodhuar bartja e bilanceve të pashpenzuara të vitit të kaluar (120.356 euro) dhe mjetet e donatorëve (40.033 euro)", ka thënë drejtori Vërbani. Është thënë se gjatë periudhës 9-mujore janë realizuar 3.375.607 euro ose 60,7% e buxhetit të sivjetmë.

# NËNTOR 2012

## 200 kubikë dru për familjet skamnore

**5 nëntor** - Ekzekutivi i Komunës ka marrë vendim për dhurimin e 200 kubikëve dru për familjet skamnore. Drutë për ngrohje që do t'u jepen familjeve përfituese janë konfiskuar nga prerës dhe transportues ilegalë. Propozimi për dhurimin e druve familjeve skamnore është mbështetur nga kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, dhe nënkryetari, z.Remzi Elezi.

## Identifikohen parcelat për këmbim me AKP-në

**6 nëntor** - Komuna i ka identifikuar katër parcela për këmbim me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP). Ekzekutivi i Komunës e ka shqyrtuar raportin e hartuar nga Komisioni për caktimin e zonave me interes te veçantë për Komunën e Kaçanikut. Komisioni i ka identifikuar katër zona të cilat aktualisht administrohen nga AKP-ja. Komisioni ka propozuar që për bartjen e këtyre parcelave në pronësi të Komunës, AKP-së t'i dhurohet një sipërfaqe mal i klasës së tretë në fshatin Stagovë. Komisioni i sipërpërmendur



qe themeluar nga kryetari i Komunës në përputhje me nenin 13 të Ligjit të vetëqeverisjes lokale nr.03/L-040 dhe nenit 77 të Ligjit mbi procedurat administrative nr.02/L-28. Bazuar në raportin e komisionit dhe në përputhje me Ligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës nr.03/L-226, kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, do të kërkojë nga Bordi i drejtorëve i AKP-së që ta lejojë bartjen e pronave të identifikuara në pronësi të Komunës të Kaçanikut.

## Komuna dhe USAID/DEMI - fushatë për tatimin në pronë

**9 nëntor** - Komuna dhe programi Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI) i USAID-it e kanë zbatuar fushatën vetëdijësuese për ngritjen e të hyrave nga tatimi në pronë, me moton: "Për shërbime më të mira - Paguaj tatimin në pronë". Në kuadër të fushatës janë shpërndarë broshura e posterë, ndërsa janë vendosur edhe bilbordë. Pjesë të fushatës kanë qenë edhe spotet me zë dhe ato vizuale që janë transmetuar edhe në uebfaqen zyrtare të Komunës.



## Inspektorati komunal nis zbatimin e planit operativ

**12 nëntor** - Njësia e inspektoratit komunal ka nisur zbatimin e Planit operativ për inspektimin e transportit publik, ambientit, ndërtimeve, sanitarisë, tregtisë etj. Mendu Krasniqi, shef i njësisë, ka thënë se plani është duke u zbatuar me qëllim të rritjes së përformancës komunale dhe eliminimit të disa dukurive negative në sektorët që i mbulon kjo njësi. Sipas planit, do të veprohet në lirimin e hapësirave publike dhe largimin e shitësve ambulantë, pastaj ndalimin e parkimit të palejuar në hapësira publike dhe largimin e automjeteve të paregjistruara nga vendparkimet, sikundër edhe për ngritjen e performancës në transportin publik të udhëtarëve.

## Punohet murali i 100-vjetorit të shtetit shqiptar

**13 nëntor** - Në kuadër të aktiviteteve për shënimin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë është punuar murali me simbole kombëtare në murin e rrugës "Skënderbeu". Në kuadër të muralit të punuar janë përfshirë flamuri kombëtar, simboli zyrtar i 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë dhe mbishkrimi: "100 Vjet Shtet Shqiptar". Muralin e ka punuar Arif Mulaku, profesor i artit figurativ, ndërsa është ndihmuar nga Blerim Berisha, anëtar i Këshillit për Veprim Rinor Lokal. Nënkryetari i Komunës, z.Remzi Elezi, gjatë vizitës që i ka bërë vendit ku po punohej murali, është



shprehur të jetë i kënaqur me cilësinë dhe mesazhin e tij. Jo vetëm për simbolikë, z.Elezi për pak çaste i ka ndihmuar autorët e muralit duke e ngjyrosur një pjesë të tij. Punimi i muralit financiarisht është mbështetur nga Komuna.

## Gjimnazi "Skënderbeu" bëhet me uebfaqe

**13 nëntor** - Në kuadër të aktiviteteve të gjimnazit "Skënderbeu" për shënimin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë është përuruar uebfaqja zyrtare e kësaj shkolle. Drejtori i gjimnazit, Ibush Vishi, i ka përgëzuar nxënësit, mësimdhënësit dhe dizajnuesit e uebfaqes, të cilën e ka çmuar shumë të nevojshme dhe të mirëpritur. Projekti i realizuar është vlerësuar edhe nga nënkryetari i Komunës, z.Remzi Elezi. "Jo vetëm nxënësit dhe mësimdhënësit tashti e tutje do të mund të informohen për punët, arritjet dhe sfidat e këtij institucioni arsimor", ka theksuar z.Elezi. Prezantimin profesional të uebfaqes e ka bërë ish-nxënësi i "Skënderbeut", Shkëlzen Vishi, aktualisht student i shkencave kompjuterike, dizajnues i saj. Uebfaqja www.gjimnaziskenderbeu.com edhe nga të pranishmit tjerë është vlerësuar si projekt i qëlluar dhe i realizuar suksesshëm.



# Shpaloset projekti për parandalimin e dhunës në shkolla

**16 nëntor** - Komuna e Kaçanikut dhe Qendra për Arsim e Kosovës (KEC) kanë shpalosur aspekte të projektit: "Parandalimi i dhunës në shkolla" që financohet nga UNICEF-i. Halim Hyseni, koordinator i projektit, i ka prezantuar arritjet e projektit dhe rezultatet e synuara deri në vitin 2017. Ai ka thënë se nëpërmjet këtij projekti synohet promovimi i qasjes së integruar për ndërtimin e rrjeteve të fuqishme mbrojtëse të mjediseve shkollore dhe parandalimi i të gjitha llojeve të dhunës në institucionet arsimore parauniversitare. "Dhuna nuk evitohet me dhunë, dënime e ndëshkime. Dhuna është paaftësi", ka nënvizuar Hyseni. Duke folur për arritjet e shkollave të komunës së Kaçanikut, ai ka thënë se në të gjitha shkollat është shtuar siguria dhe nuk ka dhunë të mësimdhënësve ndaj nxënësve. "Ka dhunë të nxënësve ndaj nxënësve", ka thënë Hyseni. Ai ka thënë se projekti ka për qëllim krijimin e ambientit miqësor për fëmijët. Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, projektin e sipërpërmendur e ka vlerësuar si shumë të rëndësishëm. "Ne jemi ata që mund të bëjmë ndryshime pozitive në shkollat tona edhe në rrafshin e parandalimit të dhunës", ka theksuar kryetari Ilazi. Ndërkaq, Azem Guri, drejtor i Drejtorisë së Arsimit e Kulturës, e ka shpalosur raportin lidhur me organizimin dhe zhvillimin e sistemit arsimor në komunën e Kaçanikut. Për dhunën në shkolla kanë folur edhe një grup nxënësish të gjimnazit "Skënderbeu", anëtarë të Këshillit Rinor për Veprim Lokal.



# Komuna investon në QKMF

**19 nëntor** - Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Kaçanik është duke u realizuar një projekt i financuar nga Komuna. Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, i ka inspektuar punimet për rinovimin e katit përdhes të QKMF-së. Projekti: "Ndërrimi i dyerve dhe dritareve në katin përdhes të QKMF-së" parasheh zëvendësimin e dyerve dhe dritareve të materialit PVC me të reja të punuara me material gjerman të klasës së parë, sikundër edhe rinovime të vogla në hapësirat e objektit. Drejtori i QKMF-së, z.Ekrem Dullovi, është shprehur të jetë i kënaqur me investimet e bëra. Ai ka rikujtuar se kohë më parë është bërë edhe rinovimi i laboratorit dhe pajisja e tij me inventar. Për zëvendësimin e dyerve dhe dritareve janë alokuar 9.975 euro të buxhetit komunal.



## Komuna dhe USAID/DEMI investojnë në Qendrën e shërbimeve për qytetarët

**21 nëntor** - Komuna dhe USAID-i do ta bashkëfinancojnë projektin për pajisjen me teknologji dhe inventar të Qendrës së shërbimeve për qytetarët (QSHQ). Programi Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI) i USAID-it i ka alokuar 28.350 euro për QSHQ-në (zyra pritëse), saktësisht për blerjen e pajisjeve të nevojshme teknologjike dhe të inventarit. Projekti do të mbështetet edhe me 22.170 euro të buxhetit komunal. Projekti është vlerësuar nga kreu i Komunës, z.Besim Ilazi. "Projekti synon të rris në mënyrë të dukshme shpejtësinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga QSHQ-ja", ka thënë z.Ilazi. Në këtë kontekst, Bejtulla Dalloshi, përgjegjës për teknologjinë informative, ka theksuar se nga projekti i sipërpërmendur do të përfitojnë edhe 5 zyrat e vendit në terren. Ndërkohë kanë vazhduar punimet për rinovimin e hapësirave të QSHQ-së me rreth 20 mijë euro të buxhetit komunal, ndërsa ajo do t'u ofrojë qytetarëve shërbime të llojit "të gjitha në një vend". Komuna e Kaçanikut nëpërmjet bashkëfinancimit me projektin e USAID/DEMI sivjet ka realizuar projekte në vlerë prej 150.000 dollarësh amerikan; duke përfshirë rregullimin e Parkut rinor në pjesën ballore të Pallatit të Kulturës (60,000 $), projektin për shenjëzim horizontal dhe vertikal të rrugëve (40,000 $) dhe disa projekte tjera më të vogla në mbështetje të promovimit të praktikave të qeverisjes së mirë në Kaçanik.

## Në draftin final të PRRU-së edhe rekomandimet e qytetarëve

**22 nëntor** - Në draftin final të Planit rregullues urban (PRRU) për zonën I dhe një pjesë të zonës II të qytetit Kaçanik do të përfshihen edhe disa nga rekomandimet e qytetarëve. Ata patën kërkuar që në draftin final të PRRU-së të përfshihen propozimet e tyre nga sferat demografike, sociale, ekonomike, infrastrukturore dhe mjedisore. Ndërkohë materialet e draftplanit kanë qëndruar të ekspozuara 30 ditë në pallatin e kulturës "Xheladin Kurtaj" për vërejtje, propozime dhe sugjerime të reja nga qytetarët. Në fletoren për

shënime, një qytetar ka kërkuar që të ruhet pamja e çarshisë së vjetër, ndërsa dy të tjerë kanë artikuluar mendimet e tyre për PRRU-në. Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, ka thënë se në draftin final do të përfshihen edhe disa nga rekomandimet e qytetarëve të vlerësuar nga grupi punues. Drafti final i PRRU-së do t'i përcillet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim. Grupi punues përbëhet nga zyrtarë komunalë dhe ekspertë të jashtëm, ndërsa pjesë e tij është edhe z.Ismajl Baftiari konsulent në LOGOS. Projekti Zvicër-Kosovë për qeverisje lokale dhe decentralizim-LOGOS, është duke e mbështetur Komunën e Kaçanikut për hartimin e PRRU-së për zonën I dhe një pjese të zonës II të qytetit.



## Vendosen tabelat me emërtimet e rrugëve

**22 nëntor** - Ka nisur vendosja e tabelave me emërtimet e rrugëve. Vendosja e tyre është duke u bërë në përputhje me vendimin e Kuvendit të Komunës për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve lokale në komunën e Kaçanikut. Projekti për vendosjen e tabelave është pjesë e Planit të veprimit për përmirësimin e shërbimeve (PVPSH) që po realizohet në bashkëpunim me USAID-in. Për zbatimin e PVPSH-së, USAID-i i ka dhënë rreth 20 mijë euro,

ndërsa Komuna ka participuar me rreth 6 mijë euro. Rushan Ceka, drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Emergjencave, ka thënë se vendosja e tabelave me emërtimet e rrugëve të qytetit do të përmbyllet shumë shpejt, ndërsa në vijim do të vendosen edhe tabelat me emërtimet e rrugëve të gjysmës së fshatrave.




## Iniciohet hartimi i Planit të integruar komunal

**23 nëntor** - Komuna e Kaçanikut dhe projekti i binjakëzimit: "Bashkëpunimi evropian për komuna më të fuqishme" (BEKF) e kanë iniciuar hartimin e Planit të integruar komunal (PIK). Kreu i Komunës, z.Besim Ilazi, PIK-un e ka cilësuar dokument strategjik për komunën. Këtë vlerësim ai e ka artikuluar në takim me z.Graham Cutts, konsulent për pushtet lokal në BEKF dhe z.Alan Packer,



udhëheqës i projektit për binjakëzim. Në takim i pranishëm ishte edhe nënkryetari i Komunës, z.Remzi Elezi, dhe drejtorët e drejtorive komunale. Është thënë se PIK-u do të hartohet për periudhën 2013 – 2015, ndërsa në të do të përfshihen prioritetet e kryetarit, sikundër edhe vizioni, synimet dhe aktivitetet për arritjen e objektivëve. Bazë për hartimin e planit të sipërpërmendur do të jenë edhe dokumentet ekzistuese komunale (Plani zhvillimor komunal, Plani zhvillimor urban, Korniza afatmesme buxhetore 2013-2015 etj.) "Bashkëpunimi evropian për komuna më të fuqishme - planifikimi për ofrimin e shërbimeve" është projekt i Komisionit Evropian, ndërsa synon të ndërtojë marrëdhënie të ngushta ndërmjet Britanisë së Madhe e Danimarkës me Kosovën.

## Përurohet libri "Lufta e Kaçanikut"

**23 nëntor** - Është përuruar libri "Lufta e Kaçanikut më 1910 (Beteja për pavarësi)" i mr.sc.Hafet Cekës. Kryetari i Komunës, z. Besim Ilazi, e ka përgëzuar autorin Ceka, ndërsa ka thënë se ky libër sjellë fakte të reja historike për njërën nga betejat më të rëndësishme të kryengritjes shqiptare të 1910-s kundër Perandorisë Osmane. Ndërkaq, prof.dr.Fehmi Rexhepi, kryeredaktor i librit, ka thënë se libri përmban fakte shkencore. "Autori ia ka arritur të rrumbullakojë temën që trajton", ka thënë ai. Autori i librit, Hafet Ceka, i ka falënderuar të gjithë ata që e kanë ndihmuar në procesin e shkrimit dhe botimit të librit. Kryetari i Komunës e ka mbështetur me 500 euro të buxhetit komunal botimin e librit të sipërpërmendur.



# Kryetari uron qytetarët për festat e nëntorit

**27 nëntor** - Qytetarë të nderuar,
Më lejoni t'ua përcjellë urimet e mia më të sinqerta me rastin e 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, Ditëlindjes së komandantit legjendar Adem Jashari dhe paraqitjes publike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Para 100 vjetësh, më 28.11.2012, plaku i urtë Ismail Qemali e ngriti flamurin në Vlorë, por më se 2/3 e tokave shqiptare padrejtësisht mbetën jashtë shtetit shqiptar. Luftërat për liri nuk pushuan asnjëherë, ndërsa u finalizuan me luftë heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e prirë nga legjendari Adem Jashari. 28 Nëntori është dita e shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë, është dita e paraqitjes publike të UÇK-së dhe është ditëlindja e legjendarit Adem Jashari. Këto janë festa të krenarisë kombëtare që na dhanë forcë dhe kurajo për ta bërë shtetin e Kosovës. Edhe në këtë ditë të shënuar ne i përkulemi heroizmit të atyre që luftuan dhe flijuan jetët e tyre për liri dhe pavarësi.

Besim Ilazi,
Kryetar i Komunës

# Festa nis me homazhe për dëshmorët



**28 nëntor** - Shënimi i 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë, i daljes publike të UÇK-së dhe i Ditëlindjes së komandantit legjendar Adem Jashari ka nisur me homazhe për dëshmorët. Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, i shoqëruar nga bashkëpunëtorë të tij dhe zyrtarë të OVL të UÇK-së, kanë vendosur kurora lulesh dhe kanë bërë homazhe te Varrezat e Dëshmorëve. Kurora lulesh kanë vendosur edhe pranë lapidarëve të dy komandantëve, Agim Bajrami-Zefi dhe Qamil Ilazi-Bardhi, sikurse edhe pranë bustit të dëshmorit Ismail Raka dhe bustit të Idriz Seferit. Aktivitetet për shënimin e festave të sipërpërmendura kanë vijuar me parakalimin e fëmijëve nëpër rrugët e qytetit. Fëmijët, të veshur kuq e zi e duke valëvitur flamuj kombëtarë dhe me emblema të 100-vjetorit të Pavarësisë, kanë parakaluar nëpër bulevardin "Ismail Raka". Më pas në oborrin e pallatit të kulturës "Xheladin Kurtaj" është shfaqur një program për fëmijë.



# Përurohet pllaka "100 Vjet Shtet Shqiptar"

**28 nëntor** - Në nderim të 100-vjetorit të shtetit shqiptar, në rrugëhyrjen për në Kaçanik është përuruar pllaka me mbishkrimin: "100 Vjet Shtet Shqiptar" dhe me emblemën e 100-vjetorit. Shpalosjen e pllakës e kanë bërë z.Besim Ilazi, kryetar i Komunës, z.Xhabir Zharku, ish-kryetar, znj.Zylehaje Bajra-Syla, e bija e Sali Bajrës dhe znj.Xhemile Raka, bashkëshortja e dëshmorit Ismail Raka. Pllaka është ngritur nga Komuna e Kaçanikut dhe qytetarët e saj. Në një shtyllë pranë pllakës është vendosur edhe një flamur kombëtar përmasash të mëdha.




# Dekorohen të gjithë dëshmorët e komunës

**28 nëntor** - Janë dekoruar me medalje të gjithë dëshmorët e Komunës të Kaçanikut të rënë për liri e pavarësi gjatë luftës heroike të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK). Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, në akademinë solemne të mbajtur për nder të 100-vjetorit të Pavarësisë së Shqipërisë-Ditës së Flamurit Kombëtar, Përvjetorit të daljes në skenë të UÇK-së dhe Ditëlindjes së

komandantit legjendar Adem Jashari, me medalje e ka dekoruar komandantin Agim Bajrami, komandantin Qamil Ilazi, Ismail Rakën, Feriz Gurin, vëllezërit Fadil e Nehat Çaka dhe Nazmi Osmanin. Me medalje janë dekoruar edhe të gjithë dëshmorët e rënë. Akademisë i ka paraprirë shfaqja nëpërmjet videoprojektorit e inserteve nga akti i pavarësisë së Shqipërisë më 1912, pastaj e inserteve të zgjedhura nga lufta e UÇK-së dhe akti i pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt të vitit 2008. Kryetari Ilazi ka thënë se muaji nëntor është muaj historik, ndërsa e ka përmendur nëntorin e vitit 1443, nëntorin e vitit 1912, daljen publike të UÇK-së dhe ditëlindjen e komandantit legjendar Adem Jashari. Ai ka thënë se plaku i urtë Ismail Qemali e shpalli pavarësinë e Shqipërisë në Vlorë më 28 nëntor 1912, por më se 2/3 e atdheut mbetën jashtë trungut të Shqipërisë. Populli shqiptar i mbetur jashtë kufijve të shtetit shqiptar asnjëherë nuk u pajtua me këtë ndarje të padrejtë, por vazhdoi luftën për liri dhe pavarësi. Kryetari i ka përmendur ngjarjet historike nëpër kohë, me theks të veçantë luftën e UÇK-së e prirë nga komandanti legjendar Adem Jashari. Kryetari Ilazi theksoi se UÇK-ja e mbështetur nga populli ynë dhe bashkësia ndërkombëtare përfundimisht dëboi pushtuesit për të qenë ne sot të lirë. Ish-kreu i Komunës, Xhabir Zharku, ka folur në emër të Brigadës 162 "Agim Bajrami". Ai ka thënë se liria jonë është e shenjtë. "Ne lirinë e fituam me pushkën e luftëtarëve të UÇK-së dhe ndihmën e popullit tonë, por edhe me ndihmën e aleatëve tanë", ka thënë Zharku. Grupi i nxënësve të gjimnazit "Skënderbeu" e kanë shfaqur veprën skenike "Burgjet plot, liria në derë", e realizuar sipas dramës "Procesi" të Jusuf Gërvallës, ndërsa në skenë është ngjitur edhe grupi i valltarëve të SHKA"Shqiponja".



# Qamil Ilazi-Bardhi edhe zyrtarisht Hero i Kosovës

**29 nëntor** - Qamil Ilazi-Bardhi edhe zyrtarisht është shpallur Hero i Kosovës. Presidentja e Kosovës, znj.Atifete Jahjaga, me rastin e 28 Nëntorit-Ditës së Flamurit, dëshmorin Qamil Ilazi, komandant i brigadës 162"Agim Bajrami" të UÇK-së, e ka dekoruar me urdhrin "Hero i Kosovës". Ndërkaq, me urdhrin "Luftëtari i Lirisë Adem Jashari" presidentja i ka dekoruar dëshmoret kaçanikase: Mukadeze Lika-Muhaxheri, Jehona Raka dhe Emsale Frangu.



# Inicohet hartimi i Planit për përmirësimin e organizatës me performancë të lartë

**29 nëntor** - Është inicuar hartimi i Planit për përmirësimin e organizatës me performancë të lartë (PPOPL). Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi dhe znj.Deborah Kimble, udhëheqëse e Njësisë për administratë komunale në projektin Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI) të USAID-it, e kanë mbështetur idenë për hartimin e PPOPL-së. Kryetari Ilazi e ka falënderuar znj.Kimble për mbështetjen e deritanishme, ndërsa është

shprehur i bindur për vazhdimin e bashkëpunimit me DEMI-n. Ndërkaq, znj.Kimble ka thënë se USAID/DEMI në këtë fazë është duke mbështetur komunat partnere në përpilimin e planeve vepruese për përmirësimin e performancave të administratave komunale. Në takim është thënë se Plani për përmirësimin e organizatës me performancë të lartë kontribuon në ndërtimin e shkathtësive udhëheqëse (lidershipi) dhe menaxheriale, konsolidimin e komunikimit te brendshëm në administratë, rritjen e bashkëpunimit midis administratës dhe Kuvendit të Komunës në funksion të përmbushjes efektive të përgjegjësive etj. Sali Salihu, zyrtar i DEMI-t, ka thënë se ndërtimi i organizatës me performancë të lartë nënkupton të menduarit ndryshe dhe të kuptuarit e procesit të ndryshimit dhe si të udhëhiqet dhe menaxhohet ndryshimi. Administrata komunale e Kaçanikut në janar të vitit 2011 e ka themeluar Ekipin për Përmirësimin e Organizatës Komunale (EPOK). EPOK-u është dizajnuar si një mekanizëm këshillëdhënës për përmirësimin e performancës së administratës komunale. Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit, njëherësh koordinator i EPOK-ut, i ka përmendur aktivitetet e EPOK-ut në përmbushjen e objektivëve për këtë periudhë kohore.



# DHJETOR 2012

## Komuna rihap "kuletën" për studentë

**2 dhjetor** - Pas një ndërprerjeje disavjeçare, Komuna ka vendosur ta rihap "kuletën" për studentë. Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, ka vendosur ta ndërpresë praktikën e mosdhënies së bursave studentëve të dalluar dhe atyre me gjendje të rëndë sociale. "Në buxhetin e Komunës të Kaçanikut të vitit fiskal 2013 janë paraparë mjete për dhënie bursash studentëve të dalluar dhe atyre me gjendje të rëndë sociale", ka theksuar Fikri Vërbani, drejtor i Drejtorisë së Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit. Ai ka thënë se për shumën e mjeteve për bursat do të vendoset më vonë. "Bursat do të jepen për vitin akademik 2012/2013", ka theksuar Vërbani. Ai ka pohuar se studentët që do të përzgjidhen bursat do t'i marrin retroaktivisht nga 1.10.2012.

## Mbështetje nga buxheti për projektet e "Handikosit"

**3 dhjetor** - Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, ka artikuluar gatishmërinë për të mbështetur projektet e "Handikosit" brenda mundësive buxhetore. Me rastin e 3 Dhjetorit - Ditës Ndërkombëtare të Personave me Aftësi të Kufizuara, kryetari Ilazi është takuar me znj.Elmihane Malsiu, koordinatore e "Handikosit", Dega në Kaçanik. Z.Ilazi ka thënë se personat me aftësi të



kufizuara meritojnë një vëmendje më të madhe të shoqërisë. Kryetari është shprehur i gatshëm që të mbështesë projektet e shoqatës. "Ne do të mbështesim projektet tuaja varësisht nga mundësitë buxhetore", i ka thënë mysafires kryetari Ilazi. Ndërkaq, koordinatorja Malsiu është shprehur e gatshme për angazhim edhe më të madh në të mirë të kategorisë së njerëzve me aftësi të kufizuara.

## BE-ja mbështet Kaçanikun për sistem të unifikuar adresash

**4 dhjetor** - Bashkimi Evropian është duke e mbështetur Kaçanikun në rrafshin e promovimit të sistemit të unifikuar të adresave. B&S Europe është duke e zbatuar projektin: "Unifikimi i sistemit të adresave në komunën e Kaçanikut" që financohet nga BE-ja. Në takimin e zyrtarëve për planifikim urban dhe zyrtarëve të B&S Europe është bërë kontrolli vizuel i hartave të terrenit dhe trajnimi për identifikimin e të gjitha rrugëve me emër dhe kod unik. Migena Çumani, eksperte e sistemit të adresave në B&S Europe, ka thënë se nëpërmjet projektit që po zbatohet synohet krijimi i sistemit të adresave, pastaj bërja me adresë e çdo objekt në territorin e komunës dhe adoptimi i kritereve për emërtim rrugësh. Ndërkaq, Shkëlzen Hasani, koordinator për komunat e regjionit të Gjilanit, ka thënë se me realizimin e këtij projekti do të përfitojnë Agjencia Kadastrale e Kosovës, komunat dhe qytetarët.



# Krerët e Komunës inspektojnë 4 projekte

**7 dhjetor** - Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, nënkryetari, z.Remzi Elezi, dhe drejtori i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Bekim Troni, i kanë inspektuar punimet për realizimin e 4 projekteve infrastrukturore. "Ndërtimi i trotuarit në fshatin Kovaçec", "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Kovaçec", "Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës në lagjet 'Bunjaku', 'Mezini' e 'Koraçi'" dhe "Ndërtimi i trotuarit në fshatin Kaçanik i Vjetër" kanë qenë projektet që janë inspektuar. Projekti për ndërtimin e trotuarit nga SHMP"Feriz Guri e Vëllezërit Çaka" me kubëza betoni, në gjatësi prej 1.500 metrash dhe gjerësi prej 1,5 metrash, dhe ndërtimi i murit për krijimin e bazës së trotuarit është duke u realizuar me bashkëfinancim të LOGOS-it dhe Komunës të Kaçanikut. LOGOS-i i ka alokuar 50 mijë euro, ndërsa Komuna 14.050 euro. Kryetari Ilazi dhe bashkëpunëtorët e tij e kanë vizituar edhe rrugën e asfaltuar në Kovaçec. Segmenti primar i rrugës është 1.500 metra i gjatë, ndërsa krahu i rrugës në



lagjen 'Mezraja' është i gjatë 135 m. Ai i lagjes 'Kupina' është 106 m i gjatë, i lagjes 'Ahmetaj' - 70 m dhe i lagjes 'Muçaj' - 90 m. Pjesë e të këtij projekti janë edhe rruga e dytë hyrëse në gjatësi prej 200 metrash dhe gjerësi 6 metrash, kanalizimi fekal në gjatësi prej 580 metrash dhe kanalizimi atmosferik në gjatësi 245 metrash. Për realizimin e këtij projekti Komuna e Kaçanikut i ka investuar 244.916 euro. Kryetari Ilazi dhe shoqëruesit e tij e kanë vizituar edhe vendpunishten në rrugët e lagjeve 'Bunjaku', 'Mezini' e 'Koraçi'. Rruga në gjatësi prej 1.600 metrash dhe gjerësi të asfaltit prej 3 metrash është në fazën e ndërtimit të trupit të saj, ndërsa për realizimin e këtij projekti Komuna i ka alokuar gjithsej 58.368 euro. Krerët e Komunës i kanë inspektuar edhe punimet në projektin për ndërtimin të trotuarit në Kaçanik të Vjetër. Trotuari në gjatësi 2.500 metrash dhe gjerësi prej 1 metri është realizuar me bashkëfinancim të LOGOS-it dhe Komunës të Kaçanikut. Për realizimin e këtij projekti janë investuar 65.615 euro. LOGOS-i i ka investuar 50 mijë euro, ndërsa Komuna 15.615 euro.

## USAID/DEMI mbështet Komunën për barazinë gjinore

**11 dhjetor** - Programi Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI) i USAID-it është duke e mbështetur Komunën e Kaçanikut për vetëdijesimin e të rinjve për barazinë gjinore. Vedat Dema, zyrtar për barazi gjinore, ka thënë se është duke u zbatuar projekti: "Vetëdijesimi për barazi gjinore" që parasheh mbajtjen e 24 ligjëratave me nxënës të shkollave. Është thënë se projekti është në funksion të vetëdijësimit të rinjve dhe njoftimi i tyre me ligjet për barazi gjinore. Pjesë e projektit është edhe pajisja e zyrtarit për barazi gjinore me laptop e projektor.



Realizimi i projektit është përllogaritur të kushtojë 1.410 euro. USAID/DEMI i ka dhënë 1.210 euro, kurse Komuna ka participuar me 200 euro.

## Kryetari takon kreun e BEKF-së

**14 dhjetor** - Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, është takuar me z.Alan Packer, udhëheqës i projektit për binjakëzim: "Bashkëpunimi evropian për komuna më të fuqishme - planifikimi për ofrimin e shërbimeve" (BEKF). Për bashkëpunimin e sinqertë dhe kontributin e dhënë në Komunën e Kaçanikut, kryetari Ilazi i ka dhuruar mysafirit një plaketë. Kohë më parë Komuna e Kaçanikut dhe BEKF-ja e kanë iniciuar hartimin e Planit të integruar komunal 2013-2015. Dokumenti do të përmbajë prioritetet e kryetarit, vizionin, synimet dhe aktivitetet për arritjen e synimeve të planifikuara. Projekti: "Bashkëpunimi evropian për komuna më të fuqishme - planifikimi për ofrimin e shërbimeve" është projekt i Komisionit Evropian, ndërsa synon të ndërtojë marrëdhënie të ngushta ndërmjet Britanisë së Madhe e Danimarkës me Kosovën.



# Ligjëratë për dhunën ndaj gruas

**19 dhjetor** - Zyra për barazi gjinore ka mbajtur një ligjëratë me qëllim të sensibilizimit të fushatës për eliminimin e dhunës ndaj gruas. Vedat Dema, zyrtar për barazi gjinore, e Luljeta Vuniqi, eksperte për çështje gjinore, kanë folur edhe për zbatimin e ligjeve për barazi gjinore dhe dhunën si dukuri negative. Fushata është mbështetur nga Komuna e Kaçanikut, "Caritasi" i Luksemburgut dhe USAID-i.



# Kryetari uron nxënësit e mësimdhënësit për gjysmëvjetorin e suksesshëm

**21 dhjetor** - Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, ua ka përcjellur urimet më të sinqerta të gjithë nxënësve dhe mësimdhënësve me rastin e përfundimit të suksesshëm të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor 2012-2013, ndërsa u ka dëshiruar pushime të këndshme, shëndet, lumturi e mbarësi. "Synim i përbashkët yni është ngritja e nivelit arsimor përmes qasjes së re e dinamike,

prandaj kërkohet mobilizim e përkushtim për përmbushjen e objektivave për arritjen e rezultateve sa më të mira. Aplikimi i metodologjive te reja e bashkëkohore në mësimdhënie promovon ngritje të vazhdueshme në procesin mësimor, sidomos në atë bazik, pasi arsimi është instrumenti më i rëndësishëm për zhvillimin e përgjithshëm të shoqërisë sonë", thuhet në urimin e kryetarit Ilazi.

## Komuna mbështet fuqizimin e shoqërisë civile

**21 dhjetor** - Instituti Demokraci për Zhvillim (D4D) e ka organizuar një tryezë debatuese me përfaqësues të institucioneve komunale të Kaçanikut, subjekteve politike dhe shoqërisë civile. Në këtë tryezë me temën: "Roli i shoqatave me anëtarësi në politikëbërje", është diskutuar fillimisht rreth verifikimit të listave të votuesve në komunën tonë, projekt të cilin e ka realizuar D4D-ja menjëherë pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar të Kaçanikut. Përveç kësaj, theks i veçantë i është kushtuar edhe fuqizimit të rolit të shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse. Në këtë tryezë ka marrë pjesë edhe kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, pastaj kryesuesi i KK-së, z.Xhelal Gashi, kryetarët e të gjitha subjekteve politike, shefat e grupeve parlamentare në KK dhe këshilltarë të tjerë si dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare. Është konkluduar se shoqëria civile e Kaçanikut dhe autoritetet komunale duhet të krijojnë bashkëpunim më të mirë për mbrojtjen e interesave të qytetarëve të komunës. Ndërkaq, sa i përket të gjeturave në verifikimin e listave të votuesve është potencuar nevoja për marrjen e një iniciative të pastrimit të listave të votuesve, për organizim sa më të efektshëm të zgjedhjeve në të ardhmen. Kryetari i Komunës, z.Ilazi, i cili ishte njëri nga tre panelistët e kësaj tryeze (krahas z.Visar Sutaj, menaxher i projektit në D4D dhe z.Kjani Sallahu, koordinator i verifikimit të listave të votuesve në Kaçanik), është shprehur i gatshëm për të bashkëpunuar me shoqërinë civile dhe është pajtuar se listat e votuesve duhet pastrohen. Ai ka përshëndetur këtë iniciativë të shoqërisë civile, ndërsa ka kërkuar përkrahjen e institucioneve relevante në mënyrë që pastrimit të listave t’i shkohet deri në fund. Përfaqësues të shoqërisë civile kanë kërkuar nga institucionet komunale që t'u jepet hapësirë dhe të përkrahen iniciativat dhe projektet e tyre në adresimin e çështjeve me interes për të gjithë qytetarët e komunës. Ky debat ishte pjesë e projektit

"Ndikimi i shoqërisë civile të vërtetë", që është financuar nga Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe është mbështetur nga qendra ndërkombëtare "Olof Palme".



## Miratohet Plani rregullues për Livadhet e Shtrazës

**24 dhjetor** - Kuvendi i Komunës e ka miratuar Planit rregullues (PRR) për zonën turistike te Livadhet e Shtrazës, sikundër dhe propozimvendimin për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objektit të banimit kolektiv për të pastrehët dhe atë për dhënie bursash studentëve të komunës të Kaçanikut për vitin akademik 2012/2013. Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit, e ka vlerësuar PRR-në e hartuar për zonat turistike në bjeshkët e Sharrit. Ai ka thënë se zona turistike te Livadhet e Shtrazës paraqet një potencial turistik për Komunën e Kaçanikut. Ndërkaq, versionin final të PRR-së e ka shpalosur znj.Florina Hoxha, përfaqësuese e Entit Urbanistik të Kosovës, njëherësh konsulente e projektit. Ajo ka thënë se plani i ka të gjitha elementet e një qendre rekreative-turistike. Në vijim anëtarët e Kuvendit e kanë miratuar shumën prej 20 mijë eurosh për dhënie bursash studentëve. Në propozimvendim

ishte përfshirë shuma prej 10 mijë eurosh, ndërsa pas sugjerimeve të dëgjuara nga këshilltarët për rritjen e saj njëzëri është miratuar propozimi i kreut të Komunës, z.Besim Ilazi, për dyfishimin e shumës (nga 10 mijë euro në 20 mijë). Këshilltarët e kanë miratuar edhe propozimvendimin për caktimin e parcelës kadastrale nr.1356 në Kaçanik të Vjetër si sipërfaqe për ndërtimin e objektit social të banimit kolektiv. Ky objekt u dedikohet kategorive të ndryshme sociale të dala nga lufta.



## KVRL-ja prezantoi punën njëvjeçare

**27 dhjetor** - Këshilli i Veprimit Rinor Lokal (KVRL) e ka prezantuar punën e sivjetme njëvjeçare. Arlind Hysa, kryetar i KVRL-së, i ka shpalosur aktivitetet e realizuara në takim me kryetarin e Komunës, z. Besim Ilazi. Hysa e ka falënderuar Komunën për mbështetjen e ofruar, sikurse edhe partnerët tjerë: USAID-in, KVRL-në në nivel qendror etj. Të pranishëm në takim ishin edhe z. Remzi Elezi, nënkryetar i Komunës, Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Avni Krasniqi, zyrtar i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës. Kryetari Ilazi e ka vlerësuar raportin,

ndërsa ka thënë se të gjitha aktivitetet e Këshillit kanë qenë impresionuese. Z.Ilazi u ka thënë anëtarëve të KVRL-së se Komuna do t'i mbështesë edhe në të ardhmen, varësisht nga mundësitë buxhetore. Fatlume Guri, sekretare e KVRL-së, e ka përgëzuar kryetarin Ilazi për ndarjen e bursave për studentë, ndërsa Zana Lika, Brikena Raka e Delvina Kyqyku i kanë artikuluar përshtypjet dhe përvojat e tyre si anëtare të KVRL-së.



## Legjislativi miratoi Planin rregullues urban për një pjesë të qytetit

**28 dhjetor** - Në seancën e fundit për sivjet, Kuvendi i Komunës njëzëri e ka miratuar Planin rregullues urban (PRRU) për zonën e parë dhe një pjesë të zonës së dytë të qytetit Kaçanik. Plani është vlerësuar nga folësit në seancë, ndërsa është rikujtuar se PRRU-ja është hartuar nga profesionistë të Komunës dhe ekspertë të projektit për qeversije lokale dhe decentralizim - LOGOS, që financohet nga Qeveria zvicerane. "Është një plan i mirë që përcakton kahet gjithëpërfshirës të zhvillimit të qëndrueshëm të qytetit", ka thënë Bekim Troni, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Plani është vlerësuar nga shumica e këshilltarëve që kanë folur në seancë, ndërsa është thënë se me hartimin e tij Komuna e Kaçanikut është bërë me një dokument me peshë të munguar deri tashti.

Nuk është harruar të falënderohet LOGOS-i për kontributin e madh të dhënë gjatë hartimit të dokumentit të sipërpërmendur, për të cilin është thënë se duhet të zbatohet e jo të mbetet letër në sirtar. Në seancën përmbyllëse për vitin 2012, Kuvendi i Komunës e ka themeluar edhe Komisionin 5-anëtarësh për ndarjen e bursave studentëve në përbërje: Avni Krasniqi e Afet Ceka, zyrtarë komunalë të Drejtorisë së Arsimit e Kulturës, Kemal Murseli (PDK), Florjeta Gashi (LDK) dhe Sherife Troni (e pavarur, e propozuar nga radhët e AAK-së).



# Intervistë e kryetarit të Komunës dhënë mediave në fundvit

Besim Ilazi: 2012-a, vit angazhimesh dhe arritjesh

■ Sa jeni të kënaqur me zhvillimet kryesore në Komunën e Kaçanikut gjatë vitit 2012, që kanë të bëjnë me buxhetin, projektet kapitale etj. ?

Kryetari Ilazi: Unë e kam filluar punën time si kryetar i Komunës në muajin korrik të këtij viti (2012), pas zgjedhjeve të jashtëzakonshme të mbajtura më 17 qershor 2012. Qytetarët e Komunës së Kaçanikut më besuan pozitën e të

parit të Komunës duke më votuar që në raundin e parë me rreth 53 % të votova. Besimin e dhënë po mundohem që ta dëshmoj me punë e përkushtim gjithnjë në të mirë të gjithë qytetarëve. Në kohën kur e kam marrë detyrën e kreut të Komunës, një numër projektesh ishin në fazën e realizimit e disa të tjera në fazën e tenderimit, ndërsa Kuvendi i Komunës e kishte miratuar edhe rishikimin 6-mujor të buxhetit. Sa i përket buxhetit, Komuna e Kaçanikut për këtë vit ka menaxhuar me një buxhet prej 5 milion e 618 mijë e 111 euro, ndërsa tani së fundi Qeveria e Kosovës i ka ndarë Komunës së Kaçanikut edhe një buxhet shtesë prej 200 mijë eurosh dhe aktualisht këtë vit po e përmbyllim me një shumë të buxhetit në total prej 5 milion e 818 mijë e 111 euro. Nga kjo shumë për investime kapitale për sivjet kanë qenë në dispozicion 1 milion e 316 mijë e 351 euro dhe afro 500 mijë euro të tjera nga donatorët e ndryshëm. Duhet theksuar se pjesa më e madhe e projekteve kapitale infrastrukturore të planifikuara për sivjet janë realizuar, ndërsa 4 prej tyre janë në fazën e finalizimit.

■ Cili ka qenë niveli i bashkëpunimit të Komunës me qytetarë dhe shoqërinë civile?

Kryetari Ilazi: Mendoj se që nga dita e parë jam munduar të zbatojë aktivitetet që janë të përcaktuara me Statut të Komunës dhe zbatimin e përgjegjësive si kryetar i Komunës duke administruar pushtetin lokal në harmoni me kompetencat e kryetarit. Duke qenë përfaqësues i Komunës dhe duke vepruar në emër të saj jam munduar të shtrijë bashkëpunimin e Komunës me qytetarët, shoqërinë civile, shoqatat e ndryshme rininë etj. Një bashkëpunim të sinqertë e kam zhvilluar edhe me partitë politike e veçanërisht me opozitën duke krijuar një klimë relaksuese e bashkëpunuese, gjithnjë në interes të gjithë qytetarëve. Takimet me qytetarët kanë qenë të shpeshta, duke debatuar për hallet dhe preokupimet e tyre.

■ Çfarë mundë të na thoni për trendet në ekonomi?

Kryetari Ilazi: Komuna e Kaçanikut ka trashëguar një ekonomi të dobët që nga paralufta. Edhe periudha e pasluftës nuk ka sjell ndryshime pozitive, përkundrazi privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore vetëm sa e ka përkeqësuar gjendjen e përgjithshme si rezultat i shkurtimit të vendeve të punës. Ne po mundohemi që përmes ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM) ta ulim

nivelin e lartë të papunësisë duke stimuluar zhvillimin e tyre. Një veprim konkret e kemi bërë me heqjen e taksës komunale për veprimtaritë biznesore, për periudhën 3-vjeçare. Meqenëse Komuna jonë është terren kodrinor malor, fokusi ynë është zhvillimi i blegtorisë, bujqësisë e pemëtarisë. Në këtë drejtim janë bërë hapa konkret duke subvencionuar fermerët në mbjelljen e fidanëve të reja, ndërtimin e serrave për mbjelljen e perimkulturave etj.

■ Po aspektet sociale në Komunë krahasuar me vitin pararendës?

Kryetari Ilazi: Gjendja sociale nuk është e mirë dhe ka tendencë përkeqësimi. Vitin e kaluar në skemën e ndihmës sociale kanë qenë afër 850 persona që e kanë gëzuar ndihmën sociale. Gjendja përafërsisht është e njëjtë edhe sivjet përkundër numrit të shtuar të kërkesave, por mundësitë buxhetore dhe kriteret nuk kanë lejuar mbështetjen e të gjithë atyre personave e familjeve që realisht kanë nevojë. Gjendjen sociale e rëndojnë edhe familjet e pastreha. Komuna është munduar që në disa raste të mbështesë këtë kategori, ndërsa kemi participuar me mjete financiare edhe në rastet kur shoqatat apo grupet e njerëzve vullnetarë kanë iniciuar ndërtimin apo meremetimin e ndonjë objekti banimi për skamnorë.

■ Cilat kanë qenë rrjedhat në punësim?

Kryetari Ilazi: Komuna jonë ka numër relativisht të vogël të të punësuarve. Të dhënat tregojnë se nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës, pagë marrin diçka mbi 1 mijë të punësuar në sektorë të ndryshëm. Po ashtu është një numër i vogël që janë të punësuar në bizneset ekzistuese. Mundë të them se bizneset nuk kanë fuqi të absorbimit më të madh të fuqisë punëtore, prandaj papunësia mbetet një nga brengat kryesore. Këtë vit kemi arritur që përmes Zyrës Komunale për Punësim dhe Ministrisë Punës e Mirëqenies Sociale të punësojmë një numër simbolik prej 175 punëkërkuesve të cilët janë angazhuar në dy projekte të ndara. Ndërsa të dhënat e Zyrës Komunale për Punësim tregojnë se aktualisht janë afër 7.100 të papunë në Komunën tonë.

■ Cilat janë planet dhe projektet kapitale për vitin 2013?

Kryetari Ilazi: Ne në shtator e kemi miratuar buxhetin për vitin e ardhshëm në shumën e përgjithshme prej 5 milion e 611 mijë e 59 euro prej të cilave për investime kapitale është dedikuar shuma prej 1 milion e 93 mijë e 162 euro. Shpresojmë se bashkëpunimi me donatorët do të vazhdojë edhe vitin e ardhshëm dhe nuk do të mungojë mbështetja financiare sikurse edhe deri tashti. Sa i përket projekteve, ne bashkë me qytetarët kemi bërë identifikimin dhe kemi nxjerr projektet më me prioritet të cilat do ti mbështesim në 2013-n. Kryesisht do të investohet në rregullimin dhe asfaltimin e rrugëve, kanalizimeve, ujësjellësve etj. Dua të theksoj se një mbështetje të fuqishme do ta kemi edhe nga Qeveria e vendit. Projekti i rrugës Gajre – Ivajë – Shtrazë do të mbështet nga Qeveria, ndërsa tani më janë përmbyllur procedurat e tenderimit, sikurse që kemi premtime se do të mbështeten edhe projektet për rregullimin e shtatit të lumit Lepenc dhe shtratit të lumit Neredime, pastaj për ndërtimin e një palestre sportive dhe dy shkolla.



# Kryetari ua uron qytetarëve Vitin e Ri

**31 dhjetor** - Qytetarë të nderuar, gëzuar Vitin e Ri 2013!
Duke qenë në prag të ndërrimit të moteve, në emër të Komunës të Kaçanikut iu shpreh urimet më të sinqerta për shëndet, lumturi dhe suksese edhe në vitin 2013.
Besoj se bashkë do t'u gëzohemi arritjeve të reja në komunën tonë.

Besim Ilazi,
kryetar i Komunës

# Kryetari Ilazi pak çaste para ndërrimit të moteve vizitoi shërbimet kujdestare

**31 dhjetor** - Kryetari i Komunës, z.Besim Ilazi, i shoqëruar nga nënkryetari, z.Remzi Elezi, e drejtorët Misim Sopa e Rushan Ceka, pak çaste para ndërrimit të moteve i kanë vizituar institucionet komunale që punojnë edhe gjatë festave.
Kryetari Ilazi ka takuar përgjegjësit dhe stafet kujdestare në Stacionin e Policisë, Shërbimin e Zjarrëfikjes e Shpëtimit, Qendrën Kryesorë të Mjekësisë Familjare dhe KEK-un, Njësia në Kaçanik. Kryetari i ka falënderuar bartësit e këtyre shërbimeve për vullnetin e tyre që edhe në natën e ndërrimit të moteve të jenë në shërbim të qytetarëve, ndërsa u ka uruar Vitin e Ri 2013 duke ju dëshiruar fat, shëndet e suksese.



PARTITË ENDE NUK DALIN ME EMRA

## Asnjë kandidat për Kaçanikun



procset atëherë edhe zhgënjehesh", është shprehur Ceka. Ndër të tjera, Ceka ka thënë se Dega e AAK-së në Kaçanik do të dalë me kandidat, por pasi që të konsultohen me kryetarin e tyre, Ramush Haradinajn, i cili pritet të kthehet në Kosovë. "E kemi lënë të konsultohemi me të dhe ta marrim mendimin e tij për kandidatin që do ta paraqesim për kryetar të komunës së Kaçanikut", ka deklaruar Ceka. Ndërsa, sekretari i lëvizjes "Vetëvendosje", Dardan Molliqaj, ka thënë se ky subjekt politik është duke

### Heshtje në PDK

Ndërkaq, përfaqësuesit e PDK-së nuk kanë dashur të flasin nëse janë përgatitur ose jo për zgjedhjet e jashtëzakonshme në komunën e Kaçanik ut.

qëndron prapa Bashkësia

## » Palmat në Kaçanik i rezistuan acarit



Palmat e llojit "Bismarckia nobilis" ishin pjesë e projektit "Rregullimi i gjelbërimit në rrugën "Ismail Raka"

**Kaçanik, 24 prill**

Palmat e mbëltuara vjeshtën e kaluar i kanë rezistuar acarit të dimrit që shkoi. Stina e pranverës dhe moti i ngrohtë i ngjallë 23 palmat e mbjella përgjatë rrugës "Ismail Raka". Palmat e llojit "Bismarckia nobilis"...

hedhjen e mbeturinave.

Betim Shala, menaxher i projektit, ka thënë se në fazën e parë, të realizuar vitin e kaluar, përveç palmave, është bërë edhe rregullimi i shiritave të gjelbërimit për mbjelljen e barit slloven të llojit...

LEGJISLATIVI I KAÇANIKUT DO TA SHQYRTOJË REKOMANDIMIN E MINISTRISË SË PUSHTETIT LOKAL

## Pozita dhe opozita bashkë për anulimin e vendimit të tyre

Ekrem Raka



me 6.640 euro për realizmin e këtij projekti", ka th...

## Zvicra e bën Kaçanikun me Plan rregullues urban

Ekrem Raka

KAÇANIK, 16 TETOR - Versioni parafinal i Planit rregullues urban (PRRU) të zonës së parë dhe të një pjese të zonës së dytë të qytetit Kaçanik ka qenë në agjendën e debatit me qytetarë, të martën, ndërsa të pranishmit nuk kanë ngurruar edhe t'i kritikojnë disa aspekte të tij. Është thënë se PRRU-ja dhe debati i organizuar janë frut i punës së përbashkët të projektit për qeverisje lokale e decentralizim LOGOS, që financohet nga Qeveria zvicerane, dhe Komunës të Kaçanikut. "Një vit e gjysmë kemi punuar me Komunën për hartimin e këtij plani që përcakton kahet e zhvillimit të Kaçanikut



18 KOSOVA SOT



## "Caritasi" i Luksemburgut, vegla pune për shkolla

Kjo organizatë nga Luksemburgu e ka ndihmuar arsimin edhe me projektin tjetër për edukim, ku secila shkollë pati përfituar nga 3 mijë euro dhe 68 bursa për nxënësit e klasave të dhjeta

**Kaçanik, 19 prill**

"Caritasi" i Luksemburgut ka ndihmuar të gjitha shkollat e komunës së Kaçanikut me vegla pune. Drejtorët e 12 shkollave fillore dhe 2 të mesme, bashkë me punëtorët teknikë, kanë pranuar donacionin me vegla

# Komuna e Kaçanikut premton transparencë për tenderët e sivjetmë

KAÇANIK, 13 MARS - Zyra e prokurimit e Kuvendit të Komunës të Kaçanikut i ka publikuar tenderët e parë sivjet, ndërsa zyrtarë komunalë kanë premtuar procese tenderues plotësisht transparente. "Ekzekutivi komunal ka marrë vendimin që hapja e ofertave për tenderët të bëhet me teleprezencë", ka theksuar Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës, të martën. Sipas tij, është vendosur që në hapje të ofertave të ftohen edhe gazetarët dhe palët tjera të interesuara. Pohimet e zëdhënësit Dullovi KD-së ia ka ko- menaxher i Zyrës së prokurimit. "Ofertat

SHKURT

## USAID-i investon në Qendrën e Shërbimeve të kaçanikasve

KAÇANIK, 22 NËNTOR - Programi Iniciativa për Komuna Demokratike dhe Efektive (DEMI) i USAID-it i ka alokuar 28.350 euro për Qendrën e Shërbimeve për Qytetarët (QSHQ) të Komunës së Kaçanikut. "Këto mjete janë alokuar për blerjen e pajisjeve të nevojshme teknologjike dhe të inventarit të QSHQ-së (zyra pritëse)", i ka thënë KD-së Hajrush Dullovi, zëdhënës i Komunës, të enjten. Sipas tij, projekti i financuar nga DEMI do të mbështetet edhe me 22.170 euro të buxhetit komunal. Projekti është vlerësuar nga kreu i Komunës, Besim Ilazi. "Projekti synon të rris në mënyrë të dukshme shpejtësinë dhe cilësinë e shërbimeve të ofruara nga QSHQ-ja", ka thënë Ilazi. Në këtë kontekst, Bejtulla Dalloshi, përgjegjës për teknologjinë informative, ka theksuar se nga projekti i sipërpërmendur do të përfitojnë edhe 5 zyrat e vendit në terren. Është thënë se janë duke vazhduar punimet për rinovimin e hapësirave të QSHQ-së me mjete të buxhetit komunal, ndërsa ajo do t'u ofrojë qytetarëve shërbime të llojit "të gjitha në një vend". (E.R.)

e premte • 13 korrik 2012

## Dhjetë zjarre në periudhën njëmbëdhjetë ditore në Kaçanik

Ekrem Raka

KAÇANIK, 12 KORRIK - Temperaturat tropikale që janë duke mbretëruar e kanë shtuar numrin e zjarreve në territorin e Komunës të Kaçanikut, ndërsa zjarrfikësit janë ankuar për mungesë të stafit të mjaftueshëm për t'u përballur efektshëm me flakët. "Nga 1 korriku e deri sot na është kërkuar të intervenojmë për fikjen e 10 zjarreve", ka theksuar Ylber Shehu, shef i Shërbimit të Zjarrfikës dhe Shpëtimit të Kaçanikut, të enjten. Ai ka thënë se zjarret kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme materiale, ndërsa në

"Samakova" të fshatit Kërbliq. "Zjarri e ka djegur tërësisht shtëpinë e Vehbi Samakovës në Kërbliq, ndërsa dëmi i shkaktuar është vlerësuar në rreth 20 mijë euro", ka theksuar Naser Kuka, zyrtar për preventivë dhe hetime i SHZSH-së. Është thënë se në disa raste nga flakët janë përfshirë edhe gardhe, livadhe dhe pyje. "Më 3 dhe 4 korrik, në fshatin Kaçanik i Vjetër janë djegur rreth 30 hektarë me pyje në pronësi publike", ka theksuar shefi i SHZSH-së, Shehu. Ai ka folur për staf të pamjaftueshëm për t'u përballur efektshëm me zjarret e shtuara. "Aktualisht i kemi vetëm nga 3

KRYEMINISTRI I KOSOVËS VIZITOI FERIZAJN DHE KAÇANIKUN

## Thaçi: "Qeveria do t'i përgjigjet çdo kërkese të komunave"

FERIZAJ, 14 SHKURT - Kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, u ka premtuar autoriteteve komunale në Ferizaj se Qeveria do të ofrojë ndihmën e saj për tejkalimin e vështirësive të krijuara nga reshjet e borës. Thaçi së bashku me ministrat Bajram Rexhepi dhe Agim Çeku të martën kanë qëndruar për pak kohë në Komunën e Ferizajt, për t'u njohur nga afër me rrethanat e motit të keq.

"Ne do t'i përgjigjemi si Qeveri e Kosovës çdo kërkese që do të vijë nga autoritetet komunale në rast se ka ndonjë nevojë të re, pra do të kemi një bashkëpunim të ngushtë për hapa të mëtutjeshëm. Shpresojmë në shkrirjen e borës në mënyrë që mos të ketë edhe pasoja nga ndonjë vërshim eventual, pra do të koordinojmë dhe do të punojmë bashkërisht si në të gjitha komunat e Kosovës", ka thënë Thaçi.

Pas takimit me drejtorët e drejtorive komunale, kryeministri Thaçi para medieve ka shprehur falënderime si për institucionet komunale ashtu edhe për qytetarët për, siç tha ai, angazhimin e tyre në pastrimin e



"Çdo kërkese për ndihmë financiare nga Komuna e Kaçanikut dhe komunat e tjera të vendit, Qeveria e Kosovës do t'i përgjigjet në bazë të kushteve dhe mundësive që i ka", ka thënë Thaçi, pas takimit me kryetarin e Komunës së Kaçanikut, Xhabir Zharku

nistrin dhe ministrat i ka njoftuar rreth situatës në Komunën e Ferizajt, përkatësisht për punën që është bërë

e fshatit Burrnik", ka thënë ai.

Kryeministri Thaçi e ka vizituar gjatë ditës së martë edhe Kaçanikun,

takimit me kreun e Komunës, Xhabir Zharku. "Çdo kërkese për ndihmë financiare nga Komuna e

në Dërnagllavë, e bllokuar prej dy javësh, ndërsa, sipas tij, të bllokuara nga bora ende janë fshatrat

e enjte • 31 maj 2012

EKZEKUTIVI I KAÇANIKUT "DORËZOHET" PARA KËRKESËS SË PRONARËVE TË LOKALEVE ME LEJE TË PËRKOHSHME

## Komuna shtyn për 3 muaj afatin për rrënimin e lokaleve

**Burime të KD-së brenda partisë në pushtet (PDK) kanë thënë se reflektimi i ekzekutivit lidhur me këtë çështje ka ardhur për shkak të procesit elektoral**



**Lokalet në rrugën "Emin Duraku", të cilat me afatin e ri pritet të rrënohen më 31 gusht**

Ekrem Raka

KAÇANIK, 30 MAJ - Ekzekutivi ko- ... vendimet për "largimin" e tyre deri më 4 qershor. Ndërkohë pronarët e patën dorëzuar në Komunë një peti-

e hënë • 1 tetor 2012

## 19 kaçanikas të riatdhesuar për gjysmë viti

Ekrem Raka

KAÇANIK, 30 SHTATOR - Nga vendet e Bashkimit Evropian vjet janë kthyer 52 kaçanikas, ndërsa deri në fund të qershorit të sivjetmë 19 sish. Zyrtarë përgjegjës komunalë kanë theksuar se shifrat e tyre mund edhe të mos jenë të sakta.

"Këto shifra mund të mos jenë të sakta për shkak se një numër i të kthyerve mendohet se nuk paraqitet për t'u evidencuar në Zyrën për të riatdhesuarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme që gjendet Aeroportin e Prishtinës dhe në zyrën që unë e drejtoj", ka theksuar Hidajete Guri, koordinatore e Zyrës Komu-... rëse lidhur me kërkesat e të riatdhesuarve", ka thënë Guri. Sipas saj, 6 kërkesat e fundit për ndihmë janë në fazën e shqyrtimit nga ZKIEKK-ja. Koordinatorja Guri ka deklaruar se me kërkesat e të riatdhesuarve ndërkohë është duke u marrë edhe Komisioni komunal për riintegrim. "Edhe këtë komision e drejtoj unë, ndërsa është themeluar me vendim të kreut të Komunës, Besim Ilazi, më 6 gusht", ka thënë ajo. Në paragrafin e dytë të vendimit për themelimin e komisionit të sipërpërmendur thuhet: "Komisioni komunal për riintegrim e ka për detyrë të shqyrtojë dhe të marrë vendime

RESURSET PYJORE TË KOMUNËS SË KAÇANIKUT, PA ROJTARË TË MJAFTUESHËM

## Zvogëlohet numri i rojtarëve për 12 mijë hektarë pyje

Ekrem Raka

KAÇANIK, 25 SHTATOR - Është zvogëluar për tre numri i rojtarëve të pyjeve në Komunën e Kaçanikut ... vepër do të çregullonte fondin për mallra e shërbime nga i cili janë financuar ata deri tashti", ka nënvizuar Vërbani. Më 12 korrik të vitit ... bujqësisë, Pyll- ... Rural ia pati ... të Kaçanikut ... mbrojtjen dhe li- ... publike në terri- ... botë zyrtarë



e martë • 24 prill 2012

## Kaçaniku harxhon 15 për qind të buxhetit në 3 muajt e parë të sivjetmë

Ekrem Raka

KAÇANIK, 23 PRILL - Gjatë periudhës janar-mars Komuna e Kaçanikut e ka shpenzuar 15,2 për qind të buxhetit të sivjetmë, ndërsa është regjistruar përqindje e ulët e arkëtimit të mjeteve nga burimet e hyrjeve vetjake. Kështu thuhet në raportin lidhur me real- ... eurosh ishin realizuar 12.005 euro (30.2%), ndërsa nga ai investimeve kapitale në shumë prej 1.271.384 eurosh ishin realizuar 104.410 euro (8,2%). Për paga dhe mëditje ishin shpenzuar 616.970 euro ose 16,4% e shumës vjetore (3.770.983 euro), për mallra dhe shërbime ishin shpenzuar 95.904 euro ose 22,5% ...

## Kaçaniku i kthen në pronësi pronat e personave inekzistentë juridikë

KAÇANIK, 25 PRILL – Pozita dhe opozita e kanë mbështetur propozimvendimin e ekzekutivit të Kaçanikut për riemërtimin si prona të Komunës të paluajtshmërive të shfrytëzuara nga ajo e të cilat në regjistrat kadastralë vazhdojnë të figurojnë si prona të personave tashmë inekzistentë juridikë. "Me ... cave. Gjatë debatit është thënë se bëhet fjalë për paluajtshmëri të cilat në librat kadastralë vazhdojnë të figurojnë si prona të ish-bashkësive vetëqeverisëse të interesit dhe të personave të tjerë tashmë inekzistentë juridikë. "Është nismë e mirë, por të kihet kujdes që gjatë ridefinimit të titullarit të mos preken

PROGRAMI I CHWB-SË PËR QASJE TË RE NË TRASHËGIMI PROMOVOHET NË QYTETIN JUGOR

# Suedia investon 100 mijë euro në trashëgiminë kulturore të Kaçanikut

KAÇANIK, 22 TETOR – Rreth 100 mijë euro është shuma të cilën do ta përfitojë Komuna e Kaçanikut nga shteti suedez, e të cilat do të investohen në trashëgiminë kulturore. Suedia është përcaktuar për të investuar në trashëgiminë kulturore të 7 komunave të Kosovës, ndërsa e ka përfshirë edhe Kaçanikun në mesin e përfituesve. "Fondacioni suedez Trashëgimia Kulturore pa Kufij …



Ai ka nënvizuar se investimeve do t'i paraprijë hartimi i planeve lokale të trashëgimisë kulturore.

"Në përputhje me dinamikën e projektuar draftimi i PLTK-ve do të ndodhë në periudhën janar-mars të vitit të ardhshëm, kurse në prill investimet në projekte konkrete", ka thënë Bilaci. Sipas tij, programi për qasje të re në trashëgiminë kultur…

# Kaçaniku cakton lokacionin për ndërtime për të pastrehët

KAÇANIK, 13 DHJET… Kaçanikut e ka ca… për ndërtimin e një… apo të objekteve i… nimit për familjet… gjendje të rëndë so… për parcelën kadas… fshatin Kaçanik i V… pronësi të Komun… Bekim Troni, drejt… të enjten. Ai ka th…

# Pacientët kaçanikas me dializë mund të trajtohen në Ferizaj

Ekrem Raka

KAÇANIK/FERIZAJ, 21 MARS - Kreu i Ministrisë së Shëndetësisë, Ferid Agani, gjatë një vizite në fund të javës së kaluar në Ferizaj e ka mbështetur kërkesën e pacientëve kaçanikas në hemodializë për trajtim në Spitalin rajonal të Ferizajt. Prej 12 vjetësh ata vazhdojnë t'i nënshtrohen hemodializës në Spitalin e Gjilanit.

Misim Sopa, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale të KK të Kaçanikut, të shtunën, …

… dur ndonjë afat për krijimin e këtyre kushteve nga ministria, ndërsa personalisht mendoj se kjo punë nuk mund të kryhet para 6 muajsh", ka nënvizuar Hasani. Ai ka deklaruar se menaxhmenti i Spitalit të Ferizajt ka riartikuluar gatishmërinë për pranimin e pacientëve nga Kaçaniku.

"Jo vetëm që kemi pasur dhe kemi disponim për pranimin e tyre, por më duhet të them se edhe më herët ne jemi angazhuar konkretisht që pacientëve kaçanikas t'u mundësohet trajtimi në këtë repart", ka theksuar ai. Prej 12 vjetësh pacientët kaçanikas të sëmurë nga insuficienca kronike e …

… mundësohet hemodializa në S… e Ferizajt", i pati thënë gazetë… Lika (33), paciente në hemod… Ajo pati deklaruar se nuk e kup… për ç'arsye nuk u mundësohet t… në Spitalin e Ferizajt që është s… afër Kaçanikut. "Rruga kthye… kilometërshe Kaçanik-Gjilan … shumë e mundimshme për ne… mos gjatë kthimit për shkak të l… trupore që na e shkakton apar… modializës", që shprehur Lika, … po fliste në oborrin e Qendrës… sore të Mjekësisë Familj… Kaçanikut. Ndërkaq, Bekim T… biri i pacientit Hilmi Tron… deklaruar se pacientët kaç…

e martë • 17 janar 2012 kosovë



Kreu komunal Zharku, me zv.kryeministrin Petroviq, gjatë një takimi në Kaçanik

ZV.KRYEMINISTRI PETROVIQ, NJËHERËSH MINISTËR I MAPL-IT, VIZITOI KAÇANIKUN

# Petroviq i premtoi mbështetje financiare Kaçanikut

Ekrem Raka

KAÇANIK, 16 JANAR - Ministria e …

Mirëpo, ai nuk e ka përmendur shumën e mjeteve që do të investohen në Kaçanik. "Besoj se kryetari dhe bashkëpunëtorët e tij do të jenë …

… e komunave të vendit, përfshirë edhe Kaçanikun, ndërsa është shprehur i kënaqur me gjendjen në këtë rrafsh. "Besoj se viziet do të …

# Ndërrimet në kreun e Kaçanikut i kthejnë donatorët

Ekrem Raka

KAÇANIK, 20 NËNTOR - Pas ndërrimit në krye të Komunës, donatorët qeveritarë dhe joqeveritarë janë duke iu kthyer Kaçanikut me premtime për investime në projekte me interes për qytetarët e kësaj komune.

# Konstituohet Komisioni Komunal i Zgjedhjeve në Kaçanik



Kaç... Komi... do ta... ...ka nisur pastrimi i ...ve. "KQZ-ja është

SHKURT

## Kaçaniku nis procedurat për planin rregullues të zonave turistike

KAÇANIK, 26 SHKURT - Komuna e Kaçanikut i ka nisur procedurat për hartimin e planit rregullues urban për disa zona malore të vlerësuara me potencial për zhvillimin e turizmit. "Nisma për hartimin e këtij plani është e Drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrës dhe Mbrojtjes së Mjedisit", ka theksuar Hajrush Dullovi, zëdhënës i KK të Kaçanikut, të dielën. Sipas tij, hartimi i planit do të nisë me t'u miratuar nga legjislativi komunal propozimvendimi për t'u hartuar nga drejtoria e sipërpërmendur. Ndërkaq, Bekim Troni, drejtor i DUKMM-së, ka thënë se plani rregullues do të hartohet për disa zona në bjeshkët e Sharrit të vlerësuara me potencial për zhvillimin e turizmit

# Opozita ia miraton KK-së raportin e punës së ekzekutivit për 2011

42 • KOHA Ditore kosovë



## KKSB-ja kërkon nga partitë kontribut për zgjedhje të qeta e demokratike

...të të Ar... ...on të jetë

KOHA Ditore • 25

# Kaçaniku e bën gati padinë ndaj Serbisë për krime lufte

Ekrem Raka

KAÇANIK, 1 PRILL - Komisioni ...munal për ushtrimin e padisë n... Serbisë për vrasje të civilëve dhe ... dëmin ekonomik të shkaktuar...

KOMUNA I SHPALL ME INTERES TË VEÇANTË KATËR PARCELA

## Kaçaniku i kërkon AKP-së këmbim tokash ku janë ndërtuar objekte

Ekrem Raka

KAÇANIK, 7 NËNTOR - Komuna e Kaçanikut do të kërkojë nga Agjencia Kosovare e Privatizimit këmbimin e tokave mbi të cilat vite më ... lejon Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale nr.03/L-226. Zyrtarë tjerë komunalë kanë thënë se katër parcelat e kërkuara nga AKP-ja përfshihen në një sipërfaqe prej pak më shumë se 5 hektarësh. "Agjen... tuar objekte publike. "Në parcelën e parë është ndërtuar një objekt administrativ, në të dytën Varrezat e Dëshmorëve, ndërsa në të tretën një shkollë fillore", ka theksuar Troni. Ai ka pohuar se nga AKP-ja do të kërkohet që edhe objekti i Shtëpisë...

# Kaçaniku përfiton 200 mijë euro nga fondi rezervë i Qeverisë së Kosovës

Ekrem Raka

KAÇANIK, 22 NËNTOR - Qeveria e Kosovës ia ka alokuar 200 mijë euro Komunës të Kaçanikut, ndërsa ekzekutivi komunal është përcaktuar që vetëm 20 mijë euro t'i desti-

ventarit për Qendrën e shërbimeve për qytetarët dhe zyrat e vendit në terren. Ky projekt bashkëfinancohet nga Komuna dhe USAID-i", ka thënë Vërbani. Nga shuma e dhuruar, 103.624 euro ishin destinuar

28 • KOHA Ditore kosovë



# Ndërrimet në Këshillin e BIK-ut rëndojnë sigurinë në Kaçanik

NUK ZBATOHET DEKRETI I MINISTRIT FERID AGANI

# Pacientët me hemodializë nga Kaçaniku do të trajtohen edhe 3 muaj në Gjilan

Ekrem Raka

KAÇANIK, 11 SHTATOR - Sivjet, në qershor, ministri i Shëndetësisë, Ferid Agani, e pati urdhëruar Spitalin rajonal të Ferizajt që nga 1 shtatori t'i pranonte për trajtim pacientët kaçanikas që i nënshtrohen hemodializës. Mirëpo ky "dekret" i tij nuk është zbatuar. Prej 12 vjetësh pacientët kaçanikas që vuajnë nga

Spitalit të Ferizajt nuk është duke lëvizur me shpejtësinë e duhur për zbatimin e urdhrit të kreut të MSH-së. Ndërkaq, Gëzim Bajrami, drejtor i Spitalit të Ferizajt, ka thënë se "dekreti" i Aganit nuk është zbatuar nga 1 shtatori për shkak se MSH-ja me vonesë i ka lëshuar mjetet e kërkuara për realizimin e kësaj nisme. "Mjetet për teknikën e nevojshme i kemi marrë, ndërsa ...

kërkuar nga Komuna e Kaçanikut dhe Ministria e Shëndetësisë që t'u mundësohet trajtimi mjekësor në Ferizaj që është vetëm 20 kilometra larg Kaçanikut. Kjo kategori e të sëmurëve kronikë kërkesën e sipërpërmendur e patën artikuluar edhe nëpërmjet një proteste të mbajtur sivjet, më 2 mars. Protestuesit zëshëm patën kërkuar ...

# Kaçaniku ia paguan Zyrës së kryeministrit kopjet e Gazetës Zyrtare

KAÇANIK, 7 MARS - Komuna e ... është në rregull që ...

## Kaçaniku aplikon me 8 projekte në fondin stimulues të USAID-it

